# GAZETA SHQIPTARE








Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com








Viti XXIV - Nr. 7532 E premte 18 Maj 2018 **Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)**


Opinioni i Ditës

Nga ILIR KALEMAJ

## BE në udhëkryq



Bashkimi Evropian është duke u përballur me sfida të shumëfishta për sa i përket konkurrueshmërisë së tij në tregjet globale, marrëdhënien e komplikuar ...

Vijon në faqen 20

Intervista e Ditës

Nga BERND RIEGERT



## Hahn: "Perspektivë e hapur" për Ballkanin Perëndimor

BE ripërtërin në Samitin e Ballkanit në Sofje premtime të vjetra: anëtarësim po të bëhen detyrat. Se kur do të ndodhë kjo, këtë Komisari i zgjerimit ...

Vijon në faqen 21



Thorsten Frei: S'mund të dënohet kush për faj të një familjari

# Audio-përgjimi, PD zbulon dëshmitarin, Veliu: Me Agron Xhafajn trafikonim kokainë

Basha: Po e terrorizojnë, gati ta eliminojnë. Tre zyrtarët e PD s'paraqiten në prokurori. Balla: Regjisori i video-përgjimit kreu i PD

VALENTINA MADANI

Partia Demokratike publikoi dje videodëshminë dhe identitetin e dëshmitarit X, i cili quhet Albert Veliu. Ai rrëfeu se si e ka njohur dhe ka bashkëpunuar me vëllain e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, Agron Xhafaj ...

Në faqet 2-4

## INSTITUTI I SIGURIMEVE: SIGURIMI VULLNETAR, ÇFARE PERFITOJNE PENSIONISTET

# SI TE PERFITONI PENSION KUR S'I KENI VITET E PLOTA

Formula dhe shembujt konkretë sa duhet të paguani dhe sa do të përfitoni. ISSH: Masa e kontributit sipas pagës minimale të miratuar në periudhën kur bëhet pagesa




*(Në foto)* Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Në faqet 10-11

DOKUMENTACIONI QE DUHET

## Ambasada e SHBA: Filloni plotësimin e formularit online, afati i fundit kur mund të shpalleni fitues

Në faqen 12

DOSJA NE HIPOTEKE

## ALUIZNI: 203 pronarët në qarkun e Elbasanit që kanë gati tapitë e shtëpive, emrat

Në faqen 8

NGJARJA NE KORÇE

## 27-vjeçari gjendet i vdekur në paraburgim, familjarët akuza policisë: E vratë në qeli, ka shenja

Në faqen 13

DOKUMENTET

## ATP: Lista me 1800 pronarë dhe vlerësimi financiar për dosjet e plotësuara në vitin '98

Në faqet 16-17

DEKLARATA E PERBASHKET: BALLKANI KA PROBLEME



## Rama, në Samitin e Sofjes përqafime të ngrohta me Juncker dhe Vuçiç, Macron: Jo zgjerim BE-së

Në faqen 5

Besim Hajdarmataj: Disponojmë fakte që e implikojnë ish-ministrin në grupin kriminal 'Habilaj'

# "Tahiri", avokati do lirimin, prokuroria arrest me burg

*Dy akuzat për ish-ministrin, avokati: Apeluam vendimin, nuk kanë prova*

Nga INA ALLKANJARI

Vijon beteja me drejtësinë për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahirin. Ditën e djeshme Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe pala mbrojtëse e Saimir Tahirit, avokati Maks Haxhia depozituan kërkesën



për të apeluar masën e sigurisë "arrest shtëpie" të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve Vijon beteja me drejtësinë për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahirin. Ditën e djeshme Prokuroria e Krimeve ...

Në faqen 6

# ÇESHTJA "XHAFAJ"

## DESHMIA

Ministri shkoi në Kuvend pasi iku opozita, kreu i PD-së: Larg duart nga Albert Veliu

# Basha: Po terrorizohet dëshmitari, Rama e Xhafaj gati ta eliminojnë

## "Do të marrin përgjigjen më të ashpër nga opozita"




Kryedemokrati Lulzim Basha me deputetët Ervin Salianji dhe Enkelejd Alibeaj, dje në konferencën e jashtëzakonshme

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, paralajmëroi dje kryeministrin Edi Rama dhe ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj që të qëndrojnë larg dëshmitarit Albert Veliu, në të kundërt do të marrin përgjigjen më të ashpër nga opozita dhe populli. Në konferencën e jashtëzakonshme nga selia e PD-së doli vetë kryedemokrati Lulzim Basha i ndjekur nga deputetët Ervin Salianji, Enkelejd Alibeaj dhe eksperti ligjor Gazment Bardhi. Sipas kryedemokratit, qeveria ka nisur një skenar të qartë për të eliminuar 'dëshmitarin X'. "Që pas publikimit të provave, Rama dhe Xhafaj në bashkëpunim me prokurorinë, në bashkëpunim me struktura kriminale kanë vënë në lëvizje një skenar kriminal: 1- Moho përgjimin. 2 - Kap, josh ose likuido dëshmitarin dhe familjen e tij. 3 - Shkatërro provat. 4 - Kërcëno opozitën. Ky skenar ka dy qëllime. Qëllimi i parë mbrojta e Agron Xahfajt. Qëllimi i dytë është shpëtimi i Fatmir Xahfajt nga krimi i vëllait të tij, duke mos e larguar nga posti i ministrit. Agron Xhafaj nuk është ndaluar nga policia kufitare. Ai u përcoll për në Itali pasi qëllimi është për të krijuar alibi se pse nuk e arrestojnë dot dhe nuk e procedojnë dot për trafikuan aktual të drogës. Policia e Xhafajt dhe prokuroria po ushtrojnë terror ndaj familjarit X. Presion dhe terror po ushtrojnë edhe figurat e krimit të organizuar dhe ushtarë e bashkëpunëtorë të Xhafajt. Qëllimi është komprometimi dhe shkatërrimi i prevave ndaj Agron Xhafajt", - tha Basha.



**PARLAJMERIMI**

"E paralajmëroj Ramën dhe Xhafajn se për çdo hap që do të ndërmarrë për të rrëmbyer, terrorizuar dhe vënë nën presion Albert Veliun dhe familjarët e tij, do të marrin përgjigjen më të ashpër nga PD, opozita dhe populli. I paralajmëroj të dy, para të gjithë shqiptarëve, larg duart nga presioni dhe terrori shtetëror, ndaj

**SEANCA**

Ministri i Brendshëm nuk ishte në seancën e djeshme plenare, kur kreu i opozitës, Lulzim Basha akuzoi se po i bën terror përmes policisë 'dëshmitarit X', si dëshmi e origjinalitetit të audio-përgjimit të publikuar nga PD. Jo pak i ashpër ishte në akuzat e tij edhe në adresë të kryeprokurores Arta Marku, të cilën nuk hezitoi ta etiketojë sërish si kamikaze të kryeministrit Rama. "Prokuroria e ka për detyrë të hapë hetimin. Kamikazet Marku e Prela nuk veprojnë. Agron Xhafaj përmes Fatmir Xhafajt ka emëruar drejtorët e policisë nga Ard Veliu në shefat e Vlorës. Fatmir Xhafaj ka vendosur në krye të Prokurorisë së Krimeve të rënda, dhe jo rastësisht u bë ditën kur u bë denoncimi i Xhafajt. Deri dje ishte Fatmir Xhafaj që mbronte Agron Xhafajn dhe që dje vëllai i tij mafioz mbron Fatmir Xhafajn. Agron Xhafaj nuk duhej të lejohej të largohej", theksoi z.Basha. Fjalimi i gjatë dhe jashtë rendit të ditës i kushtoi mbylljen e mikrofonit nga kryeparlamentari Ruçi, që e cilësoi një skenar të paramenduar bllokimin e seancës nga ana e opozitës. "Nëse ju doni të vijoni me mesazhin tuaj për t'i thënë Sofjes se këtu s'ka normalitet, s'është lajm i mirë, por do keni përgjegjësitë tuaja", - theksoi z.Basha. Dy herë u ndërpre seanca, por Luzlzim Basha komunikimin e vijoi edhe këtë të enjte nga "Facebook"-u i tij. Të tjera fakte paralajmëroi, ndërsa Edi Ramën e provokoi me shprehjen e tij, që nuk ua kursen demokratëve çdo të enjte nga salla e parlamentit. "Faktet për të nuk do të vonojnë, por sot është dita të dëgjoni përsëri, me zë dhe me figurë, faktet e pakundërshtueshme se jo vetëm që audio-përgjimi është autentik, e nuk mund ta ekspertojë këtë vila e Surrelit, por edhe pse dëshmitë, faktet për rolin e Agron Xhafajt si koka e krimit të organizuar janë të plota dhe të thella. Ajo që keni parë dje dhe pardje është vetëm maja e ajsbergut, edhe ajo që do të shikoni sot është akoma mbi ujë. Nuk doja kurrë ta thosha edhe unë këtë, por fjalët në gjuhën shqipe kaq janë: Edi Rama, Fatmir Xhafaj nuk keni parë asgjë akoma", tha kreu i PD-së. Ministri i Brendshëm erdhi në seancë pas largimit të opozitës, por nuk iu përgjigj akuzave të saj. Sqarimet për to, ai i dha një ditë më parë, në një konference për shtyp, teksa i quajti sajesa me qëllim shantazhimin e tij.

## "Dëshmia e Albert Veliut, me fuqi nukleare"

# Berisha: Rama, kalbësirë që po qelb Shqipërinë dhe Ballkanin

Ish-kryeministri Sali Berisha teksa e cilësoi akt terrorist presionin ndaj 'dëshmitarit X' dhe ftoi dje shqiptarët të ngrihen për të rrëzuar qeverinë. "Harron ky faqezi se zinxhiri i dëshmitarëve është i pafund dhe provat janë autentike. Nuk mbetet gjë tjetër veçse shqiptarët që ky i mashtroi në mënyrë më të paskrupullt ta krehin nga zyra dhe ta hedhin në Lanë si një kalbësirë që po qelb Shqipërinë dhe Ballkanin", deklaroi z.Berisha. Një dëshmi tronditëse me fuqi nukleare e cilësoi ish-kryeministri dëshminë e Albert Veliut, personi i quajtur ndryshe "bashkëpunëtori X" në audio-përgjimin ku përfshihet edhe Agron Xhafaj. Berisha shprehet se pas kësaj dëshmie, kryeministri Edi Rama ka ikur para kohe nga Samiti i Sofjes, ndërsa ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj ka mbyllur telefonin. "Dëshmi me fuqi tronditëse nukleare e dëshmitarit Albert Veliu! Rama ikën para kohe faqenxirë nga samiti i Sofjes, Xhafaj mbyll telefonin dhe zhduket si mi! Të dashur miq, dëshmia me fuqi nukleare e dëshmitarit Albert Veliu ishte një goditje vdekjeprurëse për vete kryekumbar Ramën dhe kumbar Xhafajn. Ata, pasi heshtën 7 ditë me radhë dhe në vend që ta arrestonin, nisën dje në mëngjes forcërisht për në Itali Geron/Agron Xhafën, deklaruan se incizimi i bisedës së këtij të fundit për trafiqe me dëshmitarin ishte e montuar. Ky mashtrim i turpshëm si dhe pengmarrja e dëshmitarit, që nxori në shesh fytyrën e vërtet mafioze të klaneve Rama-Xhafa janë një kushtrim për çdo shqiptar për të shporrur e përmbysur me një furtunë të përgjithshme popullore pushtetin e kryefamiljes mafioze të Shqipërisë dhe Europës", tha z.Berisha.



## SHKURT

### Audio-përgjimi, tre zyrtarët e PD s'paraqiten në prokurori

Pas publikimit të audio përgjimit, prokuroria thirri dje për t'i marrë në pyetje tre zyrtaret demokratë. Deputetët Enkelejd Alibeaj, Ervin Salianji dhe këshilltari ligjor i PD-së, Gazmend Bardhi u thirrën në orën 10:30 në prokurori për t'u pyetur në lidhje me audio përgjimin e publikuar. Por tre zyrtarët demokratë nuk janë paraqitur pasi ishin në seancë parlamentare. Mësohet se ata kanë kërkuar të caktohet një orar tjetër. Të martën, oficeret e policisë gjyqësore morën audio-përgjimin e publikuar dhe kanë nisur hetimet për verifikimin e saj.

### Kryemadhi: Rama s'e lëshoi Xhafajn për të mbrojtur vëllain e vet Olsin

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, tha dje se ishte kryeministri Rama, ai që e ka regjistruar video-përgjimin ku implikohet vëllai i ministrit Xhafaj. Në një prononcim për mediat jashtë Kuvendit, ajo tha se Xhafajn e ruajti edhe pse ia nguli vetë thikën me materialin kompromentues. "Hedhja e Edi Ramës do të vijojë hap pas hapi. Ajo tashmë ka nisur. Sot gjeti Samitin e Bullgarisë dhe shkoi atje, ndërkohë që s'kishte fare arsye të shkonte. Ai ka frikë. Frika e tij, mbrojtja që i bëri ministrit të Brendshëm, nuk ka të bëjë në fakt me ministrin. Ishte ai që e regjistroi Fatmir Xhafajn, ishte ai që ia nguli thikën dhe sot i thotë: Do të të mbaj. Përse? Sepse do të instalojë praktikën që 'edhe unë do të mbaj vëllain tim'", tha Kryemadhi. E pyetur nëse opozita do t'i mbajë apo do t'i djegë mandatet, ajo u shpreh se "Parlamenti ka vdekur dhe ne do vijmë këtu që t'i tregojmë Edi Ramës që ai ka vdekur bashkë me parlamentin".

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Trafiku i drogës, PD zbulon identitetin e dëshmitarit të vëllait të ministrit të Brendshëm

# Veliu: Me Agron Xhafajn trafikuam drogë, nuk kishim frikë nga policia

## "Shefi i Krimit në Vlorë më kërcënoi djalin"

Valentina Madani

Partia Demokratike publikoi dje videodëshminë dhe identitetin e dëshmitarit X, i cili quhet Albert Veliu. Ai rrëfeu se si e ka njohur dhe ka bashkëpunuar me vëllain e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, Agron Xhafaj në trafikun e drogës në Itali. I cilësuar si dëshmitari X, Veliu solli dëshmi të forta kundër vëllait të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafajt, teksa konfirmoi se një zërat është i vëllait të ministrit. Veliu tha se vëllain e Fatmir Xhafajt nuk e përgjoi ai, por është zëri i tij. Sipas Albert Veliut, Agron Xhafaj e braktisi në kohën kur ai vuajti dënimin në 7 vite burg në Itali në vitin 2005 kur u kap me 12 kg kokainë. Dëshmitari tregoi se gjatë takimit që ka pasur me Agron Xhafajn para 4 muajsh në Vlorë i ka kërkuar këtij të fundit një favor për ta vënë në provë. Sipas tij, Agron Xhafajt i kërkoi se donte të bënte një rrugë transporti me kanabis për në Itali dhe Agron Xhafaj e ka drejtuar për tek 'Ermali', i cili thuhet se është shef kufiri. "Quhem Albert Veliu, 51 vjeç. Kam qenë në Itali, kam punuar tërë jetën në det, '93-'99. Në 2000 isha në Itali me grupin e Agron Xhafaj, deri në vitin 2002. Shisja kokainë në Itali. Agron Xhafajn e njoh që në '99-ën që me anë të një mikut tim, me Ardin e Refatit që sot ndodhet brenda, në Brindisi, në Itali",-theksoi ndër të tjera dëshmitari X, që tashmë ka identitet. Ai tha se nuk e kishte kryer trafikimin e drogës drejt Italisë siç flitej në videoregjistrimin me Agron Xhafajn. "Kur rashë në burg nuk më solli një paketë cigare. E takova për t'i kërkuar ndihmë për të çuar hashash në Itali. Agroni më çoi te Ermali. Agroni komandon Vlorën. Atë punë ka bërë, e bën edhe tani. Ka miqtë e tij që hedhin mall në Itali",-tha Albert Veliu duke shtuar se sipas bisedës, ai do të trafikonte për në Itali 100 kg drogë. Veliu tha se pas publikimit të hënën të videopërgjimit me Agron Xhafajn, policia ka bërë presion ndaj familjes së tij. "Shefi i Krimeve i ka shkuar djalit tim në punë 30 minuta pas publikimit të hënën. Emri i dëshmitarit i është treguar policisë nga Agron Xhafaj. I kanë shkuar djalit të puna duke i kanë thënë do të ruajmë babanë. Kam marrë kërcënime",-tha Veliu. Teksa tregoi detaje se si bëhej trafiku i drogës përmes bregdetit të Vlorës, ku si kokën e trafikut akuzon vëllain e Xhafaj, Veliu pohon se rrugët ishin të lira dhe askush nuk kishte frikë nga policia, duke nënkuptuar kështu mbrojtjen që kishte Agron Xhafaj. "Do i blija me lekë borxh për mallin. Ata e kishin gomonen, unë nuk jam padrino, jam hallexhi. Rrugët ishin të zgjidhura, ishin të gjitha të hapura, s'kisha frikë nga policia. Ai më tha se do takosh Ermalin, nuk e di ça ka qenë, shef kufiri",-rrëfeu Albert Veliu.

## RRËFIMI I PLOTË I DËSHMITARIT ALBERT VELIU, NGA AGRON XHAFAJ E "ERMALI", TEK KËRCËNIMI I FAMILJARËVE TË TIJ

**Si quhesh?**
Albert Veliu.
**Sa vjeç je?**
51 vjeç.
**Me se jeton?**
Pa punë, me rrogën e djalit.
**Çfarë ke bërë në jetë?**
Kam qenë në Itali, kam punuar. Kam punuar tërë jetën në det '93-'99. Në 2000-shin u shkëputa në Itali punova bashkë me zotin… me grupin e Agron Xhafajt gjer në 2002-in.
**Çfarë pune?**
Punuam punën e kokainës, të gjitha gjërave.
**Shisnit kokainë? Çfarë bëje?**
Shisnim kokainë në Itali.
**Po në det çfarë pune ke bërë?**
Kam punuar shoqërues gomone, por kam hequr dorë në 2000-shin. Nëëëë….
**Pse hoqe dorë?**
Hoqa dorë se s'e përballoja dot më atë lloj pune. Shpëtova dy herë nga vdekja, do ishim të mbytur.
**Po Agronin si e njeh?**
E njoh që në '99-ën që me anë të një mikut tim, me Ardin e Refatit që sot ndodhet brenda, në Brindisi, në Itali.
**Si e ke njohur, ku e ke njohur?**
Me anë të lidhjeve të punës në Itali.
**Agroni drejtonte punën atje apo ishte pjesë e saj?**
Normale, komandonin punën. Qe një grup që komandonin punën, merrnin mallin dhe ne e shisnim.
**Po pastaj?**
Në 2005-ën, më ndodhi aksident mua në punë dhe kreva një dënim prej 7 vjetësh.
**Me çfarë u kape?**
U kapa për…akuzohesha për kokainë, për 12 kile.
**Ti po i çoje me gomone?**
Jo, jo u kapa në Peskara.
**Po?**
Bëra dënim në Peskara, që më takonte. Në Shkallë të Parë mora 15 vjet, Apeli ma la 8 vjet, një vit mora ulje dhe bëra 7 vjet. Kurse nga Agroni që një mbetqejfje.
Gjatë këtyre kohëve që ne punuam bashkë, kur rashë brenda, mua nuk më solli një paketë cigare, një copë letër si shok, për aq sa kishim bërë për njëri - tjetrin. Kur dal nga burgu, kthehem në Shqipëri, e takoj, më afroi gjoja një nder, një punë për djalin…kamarier.
**Kur, në çfarë viti?**
Në 2007-ën, se në 2006-ën…jo, në 2016-ën për djalin më ka ofruar punë. Për djalin më ka ofruar punë në vitin 2016.
**Sa vjeç është djali?**
Djali është 22 vjeç. Punoi kamerier nja 6 muaj, s'e përballoi dot ekonomia e shtëpisë. E hoqa. Para 6 muajsh, 5 muajsh, nuk e di saktë sa ka 5 muaj, 6 muaj, që të flasim pastër, i kërkova të më bënte një nder. 4 muaj ka, tani më kujtohet. I kërkova të më bënte një nder për të hedhur barishte për Itali.
**Çfarë barishtesh se s'e kuptoj? Çfarë është kjo barishte?**
Hashash.
**Po. Çfarë do t'i bënit hashashit?**
Do ta çonim në Itali. I kërkova një favor më prezantoi me këtë Ermalin.
**Ti ia kërkove vetë favorin që të…?**
Ia kërkova se isha në gjendje të keqe ekonomike. Dhe e vura në provë sa korrekt qe për mua si Albert. Dhe mua më erdhi, që u bë gjithçka gati për t'u bërë rruga. Unë nuk e bëja këtë rrugë se kisha bërë nja 7 vjet dënim dhe dua të jem i pastër në këtë shtet. Po e vërtetova që…
**Po pse nuk e bëje këtë rrugë ti? A shkove i kërkove ti këtë nder?**
I kërkova këtë nder, por nuk e bëja atë rrugë se nuk dua ta vazhdoj më këtë lojë biznesi. Vetëm e vura në provë për ta zhveshur me një fjalë se cili është Agron Xhafaj.
**Pse vajte te Agroni?**
Po vajta se qemë me mbetqejfje, se kur unë rashë brenda në burg në Itali, ai mua nuk më solli një paketë, më ktheu kurrizin.
Po tani ai bën një jetë normale, biznesmen.
Është biznesmen, është mes të gjithave dhe komandon edhe Vlorën.
**Si e komandon Vlorën?**
Po në çdo lloj drejtimi, me biznese, me dyqane, nga porti ta marrësh, në çdo lloj drejtimi.
**Po pra, po ç 'lidhje ka ai me hashashin?**
Po atë punë ka bërë tërë kohën, jo vetëm me mua, por mund ta ketë bërë edhe me shumë të tjerë, që mbase s'ua u di dhe emrat dhe s'mund të shprehem me emra, po me mua më bëri favor, më tha bujrum sille këtë çantë ta hedh matanë!
**Kush të tha ty që mund t'i drejtohesh Agronit? Nga u nise ti?**
Po unë e njihja atë. S'e njihja sot, kisha vite që e njihja.
**Dhe ai nuk ka ndryshuar fare gjatë gjithë kësaj kohe?**
Tani në jetën e tij të brendshme unë nuk futem. Por mua mu përgjigj, u tregua korrekt. Më tha sille.
**Me kë të prezantoi?**
Me Ermalin, me këtë. Nuk e di ça është ai, shef kufiri.
**Nuk ia di as mbiemrin?**
Jo. jo mbiemrin s'ia di. Se nuk mund të pyes për tjetrin për mbiemrin. Flasim gjëra të qena tani.
**E takove Ermalin?**
Po, jam ulur në tavolinë. Edhe kemi folur dhe këto ça thuhen që janë false, të verifikohen, pastaj le të dalë emri im fals. Mund të dalë edhe emri im fals nesër.
**Çfarë të tha Ermali?**
Agroni më tha do vesh te Ermali, do të them unë. E lamë një takim sipas thënieve. Bile atë ditë ka rënë, që do të bënim xhadenë, që unë s'u paraqita, se thashë të shikoj jetën time, të jetoj i pastër, si dikushi. Si vuajta unë dënim, të vuajnë dhe të tjerët.
**Ti s'e more kurajon të ikje me skaf?**
Jo, jo s'i hipja unë në skaf më dhe nuk çoja më mall. Dua të jetoj me djersën e ballit e të ha një copë bukë. Të punoja aty në komunale që të haja një copë bukë. Me të tillë punë s'do të merrem më. Thjesht e vura në provë.
**Ku e dije ti që ai merrej me këtë punë tani?**
E dija se kisha edhe unë informacionet e mia, nga miqtë e mi.
**Ça të thoshin miqtë e tu?**
Që punën e bën, është njeri i saktë, është korrekt.
**Punon, çfarë pune?**
Që të ndihmon të hedhësh mallin në Itali. Ka miqtë e tij që të ndihmon. Mua më dha një drejtim, një rrugë, që do vesh te filani…
**Ça miqsh?**
Ermali. Qe dhe një skafist me nofkën Nake, që unë s'mund ta përmend prapë, se janë dhënë një herë ato që kanë dalë falls nga dikushi që është çik më lartë nga i vëllai i tij, që na qenka dhe ekspert fjale. Edhe unë prapë ia shpreh dhe ia them si të dojë që unë nuk jam për ato lloj rruge. Por unë e vura në provë që ai është një njeri që vazhdon jetën e tij, edhe unë vazhdoj jetën time.
**Pse ia bërë ti këtë vënien në provë atij?**
E bëra vënien në provë, se ashtu më la edhe ai mua në baltë, kur isha brenda, më ktheu kurrizin. Dhe unë tani që e vura në provë, i ktheva kurrizin e s'dua të merrem më me asnjë lloj gjëje. Dua të shikoj familjen time, fëmijët e mi.
**Pse kjo hakmarrje ndaj tij?**
Kështu janë gjërat, siç ia bën një njeriut, ashtu do pësosh. Sot është ai dikushi, unë jam pa bukë në shtëpi…
**Pse nuk iu drejtove dikujt tjetër, po iu drejtove atij?**
Po me atë më kishte lidhur jeta që në 2000-shin, në 2002-shin.
Nga informacionet që ti kishe, kishte lidhje me policinë e Vlorës?
Po, kishte me drejtorin e Vlorës bëhej shumë, dilte shpesh. Kishte me këtë shefin e kufirit.
Ça të them, punët e tyre. Ndoshta edhe punonte edhe në shtet, unë s'di gjë.
**Për sa mall re dakord ti që të çosh?**
Unë do të çoja një 100 -she, por gjallë në botë nuk e…. Do çoja një 100-she.
**100 kile?**
Po. Arrita të bëja 20. Që t'i blija me lekë borxh edhe ato 20 kile po.
Ti do e blije vetë mallin?
Vetë, vetë do ta blija mallin me lekë borxh.
Çfarë do të ofronte ai ty në momentin që ti do t'i blije këtë mall?
Transportin, të gjitha.
**Si? Do të ofronin gomonen?**
Po normale gomonen, se ata e kishin. Se unë s'kisha gomone, s'jam padrino, jam një hallexhi.
Po nuk kishe frikë se mund të ndeshje policinë rrugës?
Ishin të gjitha të zgjidhura, rrugët ishin të gjitha të hapura.
**Çfarë të kishte thënë Ermali ty?**
Jo, Ermali më thaaaa…Agroni më tha, kur të vijë dita do të vesh ta takosh Ermalin. Nuk e di çfarë ka qenë ky shef kufiri a ça ka qenë, nuk e di.
**Si e nise?**
Atë ditë që ne u bëmë gati për të bërë rrugën aty u bë qameti në Vlorë, pati përmbytje dhe deti ka qenë 7-8 ballë. Mos të them më. Edhe u shpërndamë tha është vështirë, kanë ndodh shumë probleme tha dhe s'mund të vazhdojmë më tej. Kështu që u shpërndamë secili në rrugë të tyre.
**U ndatë aty. Prandaj ti e bërë këtë?**
Po unë nuk e hidhja atë mall, thjesht bëra një…
**Pse vendose pastaj ta sjellësh tek Partia Demokratike?**
Unë e solla këtu, sepse këtu është institucioni më i besuar. Si ta çoja në prokurori, si ta çoja kudo janë gjëra që do ishin manipuluar, do të ishin zhdukur, nuk e di. Këtu e solla, sepse këtu kam besim që luftohet gjithçka me drejtësi.
**Nuk kishe frikë se mos bëheshe pjesë e një loje politike?**
Me politikë as s'jam marrë, as merrem kurrë.
**Çfarë ka ndodhur këto ditë që doli përgjimi?**
Mua, tani që doli përgjimi këto ditë, bile që ditën e parë më thotë djali im "baba je bërë figurë e njohur në Vlorë". Isha me miqtë e mi, po pija një kafe, si çdo prind. Vete tek im bir, dëgjon videopërgjimet, i kishte thënë shoku Agronit, i kishte thënë pronarit të djalit tim, brenda gjysmë ore që kishte dalë audiopërgjimi…
**Çfarë i kishte thënë?**
Shiko se babai jot është bërë figurë e njohur në Vlorë. Vete shikoj ato, ça janë ato se s' marr vesh nga telefonat me gishta, ça janë këto youtube, internet, që lexoj. Më tha mua "zëri jot". Si ka mundësi zëri im -i thash unë.
**Kush të tha që është zëri jot?**
Pronari i djalit. Shiko se zëri jot, ia kishte thënë tjetri, shoku i ngushtë i imi dhe i Agronit i kishte thënë që zëri i Babales. Dhe nuk qe zëri i Babales, qe zëri i Agronit që i erdhi informacioni direkt, që i bënin presion Babales. Dhe prapë sot që po flasim, i kishe vajtur djalit te puna shefi i Krimeve.
**Si e ka emrin?**
Alket. I thotë dua të takoj babanë tënd se dua ta kaloj në mbrojtje. Unë s'kam bërë gjë që të kaloj në mbrojtje. Unë jam një fukara, mua më pikon shtëpia. Ai mendon të më mbrojë mua. Mua më mbron Zoti. Dhe veten time e mbroj vetë, s'dua mbrojtje as nga ai dhe as nga shteti.
**S'ke frikë ti?**
Frikë nuk kam se nuk i kam borxh njeriu, s'i kam borxh. Ça borxhi i kam?!
**Ti thua që ata janë njësh me shtetin?**
Le të jenë o, ça kanë në plan, le ta bëjnë. Unë di që jam njeri i drejtë dhe mua të më vijë shefi i Krimeve të më bëjë mbrojtje… Për çfarë të më bëjë mbrojtje mua ai, shefi i Krimeve? Të më thotë për çfarë do më bëjë mbrojtje? Kush e ka urdhëruar të më bëjë mua mbrojtje?
**Po ndoshta ndihesh i kërcënuar?**
Po nga kush? Ku doli ky emri im? Nuk është shpallur emri im. Nga e mësuan këta?!
**Po ndoshta Agroni e mban mend që je ti personi?**
Po mirë o, e shikon që ato thëniet që janë folur, që kanë qenë nëpër përgjim të Agronit a të dikujt tjetër, Agroni është vetë i vetëdijshëm.
**Ke materiale të tjera ti për Agronin?**
Materiale të tjera s'kam ça them unë për Agronin, se ai ka biznesin e tij, jetën e tij dhe mua s'më intereson jeta e tjetrit, mua më intereson…
**Në këtë aventurën tënde që thua se e provove e bëre, ke bërë filmime të tjera?**
Filmime të tjera unë s'kam bërë. Filmimet i ka bërë vetë Agroni, nuk i kam bërë unë dhe aty janë.
**Si i ka bërë?**
Po ku di gjë unë si i ka bërë, me dashje, pa dashje, i di Agroni, jo unë.
**Po ti thua që Agroni ka përgjuar veten?**
Po normale, ku di unë ça i është vënë Agronit dhe akuzon Andonin në anën tjetër. Ato të gjitha janë gjëra që janë fakte reale, si zëri që ne kemi folur. Gjithmonë e ha një fukara, nuk e ha një i pasur.
**E njohin njerëzit zërin e Agronit?**
800 metro larg.
**Çfarë thonë në Vlorë?**
Po zëri i atij thonë, zëri im, zëri i Ermalit dhe zëri i Altinit. Tani po ka ndonjë zë tjetër, pastaj mund të jetë edhe zëri i plakut tim në varreza. Nuk e di mos është ngjall plaku tim.
**D.m.th., ti thua që, të paktën Vlora, qyteti i Vlorës që ju njeh, njerëzit që e njohin janë shumë të bindur për vërtetësinë e zërit që është zëri i Agronit?**
Po, çoje ku të duash, ai zë është.
**Po ti vetë kur e kujtove bisedën, kur pe këto video përgjimet e kujtove bisedën?**
Po normale. Kur unë e pash te djali, te lokali të gjitha këto foljet që u bënë, doli. Të gjitha thëniet që ne kemi bërë, thashë çne këto përgjime ne?!
**Domethënë, ti mendon që Agronin e kanë përgjuar të tjerët?**
Normale unë s'kam lidhje.
**Nuk e ke përgjuar ti?**
Secili ka mbrojtjen e tij ore. Ai tijën, unë timen, po nga ka ardhur kjo, i gjen Agroni, këto përgjime. Këto janë gjërat që po të them unë.
**Kërcënime nga njeri ke marrë këto kohë?**
Po kërcënimi më i bukur që është bërë, t'i vesh djalit te puna, se duam të ruajmë babanë, çne ti, kush je ti që do më ruash mua? Ça kam bërë? Kush të urdhëruar ty, kush të ka dhënë urdhër të vesh tek im bir? Se dikush i madh i ka dhënë urdhër shefit të Krimeve në Vlorë a Rendi ça është…
**Po ai mund të ketë vajtur konform ligjeve, rregullave?**
Po ku? Mua s'më ka ardhur konform ligjeve "arrest shtëpie", të vinte të më kontrollonte në shtëpi shteti. Ç'ne emri im? Ku dihet që jam unë i infiltruar nga shoku Agron a është infiltruar në përgjim? Ça lidhje ka emri im në këtë mes?
**Po a ke qenë ti që ke bërë atë bisedë me Agronin?**
Po, e kam bërë bisedë me Agronin, unë s'e mohoj. I kam bërë ato biseda, siç i kam bërë të gjitha reale, nuk kam ça të mohoj. Por po është përgjuar zotëria, tjetër gjë, unë s'di gjë.
**Mirë, edhe ai është kujtuar dhe ka menduar se e ke përgjuar ti?**
Po unë s'jam, me se të përgjoj, unë jam një hallexhi. Ato i di ai, që merret me shtet.

ÇESHTJA "XHAFAJ"

PARTIA SOCIALISTE

Kreu i Grupit të PS-së: Burg për autorin dhe regjisorin e mashtrimit publik

# Audio-përgjimi, Balla: Basha autor, përdori skema mafioze

## "Dëshmitari X, një mashtrues i rëndomtë, me probleme ligjore"



Në Samitin e Sofjes

Darina Tanushi

Partia Socialiste ka akuzuar Partinë Demokratike se është autore e audio-përgjimit për vëllain e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla tha dje, në një konferencë të posaçme për median se me shfaqjen e dëshmitarit të quajtur "X", PD humbi rëndë arsyen, duke u përfshirë "në një skemë mirëfilli kriminale mafioze". "Sinqerisht, deri dje kemi besuar se interesa të caktuara të grupeve kriminale apo të intrigantëve të ndryshëm, kishin shfrytëzuar interesin legjitim të një opozite, në rastin konkret të PD-së, për të gjetur dhe denoncuar fakte që diskreditojnë qeverinë; kemi menduar se naiviteti i lidershipit të PD-së bëri që kjo parti të përfshihej në një skemë të pastër të shantazhit kundër ministrit përgjegjës për luftën kundër krimit. Ajo çfarë ndodhi sot (dje) me paraqitjen publike të personit që pretendon se ka qenë në bashkëbisedimin e bërë publik nga PD, ndërmjet tij dhe vëllait të ministrit të Brendshëm, është tregues i shndërrimit të një partie politike në një organizatë që përdorë forma mafioze të adresimit të interesave të tyre",-u shpreh Balla. Sipas tij, "rezulton se Lulzim Basha është autor, regjisor dhe aktor i video-përgjimit të montuar, me të cilin shpreson të bllokojë negociatat e Shqipërisë me BE-në". "Nuk ia vlen të debatosh për vërtetësinë e deklarimeve të një njeriu që edhe pa e njohur dhe pa e ditur kush është, si drita e diellit duket qartë që është një mashtrues fare i rëndomtë, i dënuar disa herë dhe për disa lloje veprash penale! Ajo çfarë duhet të sjellim fort në vëmendjen e opinionit publik dhe veçanërisht të institucioneve përgjegjëse shtetërore, është fakti se është e rrezikshme për fatin e demokracisë skema dhe metoda që përdor PD", u shpreh kreu i Grupit të PS-së. "Si mundet një parti politike në një vend të Europës të ketë këtë sjellje me ligjin dhe institucionet?! Si ka mundësi që një parti politike në një vend europian përfshihet në inskenime mafioze?!", ngriti pyetjet Balla. "Partia Socialiste do t'i shkojë deri në fund këtij shantazhi kundër shtetit, duke kërkuar të nisë një hetim penal ndaj këtij mashtrimi politik, të prodhuar në zyrat e SHQUP. Një individ me një skedë të rëndë kriminale, brenda e jashtë vendit, që pranon publikisht se është përdorur nga PD për këtë mashtrim, duhet të përballet me drejtësinë, bashkë me regjisorin e tij. Situata është shumë e rrezikshme! Ky person duhet ose të merret i pandehur, ose me qenë se PD e konsideron dëshmitarin e saj, të merret në mbrojte të posaçme nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Çdo gjë mundet të pritet nga ata që e thirrën për ta përdorur, për të fabrikuar dëshmi të tilla dhe më pas i prenë biletën për ta larguar nga vendi",-tha më tej, Balla. Sipas tij, "ky është një sulm i rrezikshëm kundër institucioneve të shtetit, prandaj prokuroria duhet të veprojë sa më shpejt dhe me sa më shumë vendosmëri për t'i shkuar deri në fund kësaj çështjeje. Jemi përpara një skandali të madh ligjor dhe politik, ndaj prokuroria të ushtrojë të gjitha përgjegjësitë për sa më sipër". Ndërkohë më herët, gjatë seancës parlamentare, Balla tha se "Dritan Demiraj, ministri i Brendshëm i emëruar nga Lulzim Basha pas marrëve-shjes së 17 majit 2017, nuk ekzekutoi asnjë urdhërarresti për Agron Xhafajn, në 5 muaj që qëndroi në detyrë". Ai falënderoi ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj për punën e shkëlqyer në krye të këtij dikasteri, për vetingun në polici dhe zbatimin e operacionit "Forca e ligjit" duke pastruar Shqipërinë nga grupet kriminale.



Kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla

**EDI RAMA**

"Nëse ky është flamuri i aksionit opozitar, atëherë bota nuk është e rrumbullakët, trekëndëshi është katror, Shqipëria ndodhet në Polin e Veriut, Bashkimi Europian është treg fshatar tek "Ali Demi" dhe Lulëzimi është lider..." reagoi dje, Rama.

**FATMIR XHAFAJ**

Ministri Fatmir Xhafaj shkoi dje, në Kuvend, pasi iku opozita nga salla. Ai u takua në hyrje të sallës së Kuvendit me deputetin Sadri Abazi e më pas bisedoi edhe me ministrin Niko Peleshi. Xhafaj kishte dje, edhe ditëlindjen e tij të 59-të dhe u urua nga kolegët e tij ministra e deputetë të PS-së.

'Xhafaj', flet raportuesi për Shqipërinë në Bundestag

## Thorsten Frei: S'mund të dënohet kush për faj të një familjari

Raportuesi për Shqipërinë në Bundestagun gjerman, Thorsten Frei ka komentuar edhe rastin "Xhafaj". Ai ka thënë se nuk mund të dënohet kush për faj të një familjari. Megjithatë, deputeti gjerman ka deklaruar se Berlini po mban në vëzhgim veprimtarinë e ministrit të Brendshëm të Shqipërisë. Në një intervistë për radion Deutche Welle, Raportuesi gjerman tha: "Është e qartë që njerëzit nuk mund të dënohen për faj të një anëtari të familjes, por çdo individ duhet parë më vete. Prandaj edhe sjellja e ministrit të Brendshëm duhet vëzhguar dhe nuk mund të them asgjë. Por ne po e vëzhgojmë me vëmendje edhe rastin e tij". I pyetur



nëse dorëheqja e Saimir Tahirit nga mandati i deputetit erdhi si presion nga Gjermania, ai tha: "Nuk e di. Ky është një vendim që është marrë në Shqipëri, para së gjithash një vendim i tij personal, të paktën kështu e lexoj në shtypin shqiptar. Ne vetëm se e kemi bërë të qartë se do ta shohim me shumë vëmendje, nëse ish-ministri i Brendshëm po trajtohet ndryshe nga ç'do të trajtoheshin të tjerët, në raste të ngjashme. Sa i përket hapjes së negociatave dhe votës së Gjermanisë, Thorsten Frei tha: "Ajo që vërejmë dhe vlerësojmë ne është zhvillimi i jashtëzakonshëm i këtij vendi në këto vite. Kjo është e pamohueshme. Dihet edhe që Bashkimi Evropian në vitin 2003 është deklaruar për një perspektivë të qartë europiane për këto vende, dhe tani duhet parë se a i plotëson Shqipëria që tani kushtet për të hyrë në negociata. Krahas sukseseve kemi edhe disa çështje problematike". "Jam i bindur se Shqipëria ka një perspektivë europiane, e cila varet vetëm nga përparimet e saj",-tha deputeti gjerman.

**EDI PALOKA**

Deputeti i PD-së, Edi Paloka ka reaguar ashpër lidhur me akuzat që kreu i Grupit të PS-së, Taulant Balla. "Rama i suli palaçot, të pafytyrët, lëtyrat. Misioni nuk ndryshon; të mbrohet krimi dhe mafia duke sulmuar dhe denigruar denoncuesit e krimit",-tha Paloka.

**PJERIN NDREU**

Deputeti i Partisë Socialiste, Pjerin Ndreu u shpreh dje, se personi i "dekonspiruar" nga Partia Demokratike, nuk tha asgjë të re dhe se ai është keqpërdorur nga Lulzim Basha. "Drejtësia duhet të verë gjërat në vendin e vet dhe të zbardhë situatën që me videon e sotme më ngjan më shumë me estradën e ushtarit dikur e një kohë! Pa dashur, sot opozita bëri autogol duke treguar partnerët e saj në luftën për pushtet",-tha Ndreu.

**ERION BRAÇE**

Deputeti i PS, Erion Braçe ka reaguar pas shfaqjes së dëshmitarit x, të quajtur Albert Veliu. Në një status të gjatë në FB, Braçe e quan video-dëshminë e Albert Veliut si një inskenim të organizuar nga mafia. "Këtë herë duhet të jetë burgu në mes për cilindo të përfshirë, pa përjashtuar kurrkënd, as Lulzim Bashën, madje me të duhet të nisë",-shkruan Braçe në 'Facebook'.

## PSE propozon statusin e vëzhguesit në PE për PS-në

Vendet e Ballkanit duhet të përparojnë në forcimin e shtetit ligjor dhe stabilitetin social që të nxisin grupimet politike në Parlamentin Evropian të luftojnë për integrimin e tyre. Kështu ka deklaruar në një intervistë ekskluzive për ABC News, kryetari i Grupimit Socialist dhe Demokrat në Parlamentin Evropian, Udo Bullmann. Kreu i ri i grupimit të Socialistëve dhe Demokratëve në Parlamentin Europian, Udo Bullman propozon statusin e vëzhguesit për Partinë Socialiste të Shqipërisë në Parlamentin Europian. Ai thekson se vendet e Ballkanit duhet të përparojnë në forcimin e shtetit ligjor.

Liderët e BE: Ballkani Perëndimor ka probleme, por e ardhmja është në union

# Rama, në Samitin e Sofjes përqafime të ngrohta me kreun e KE e Vuçiç

## Kryeministri francez: Jo zgjerim, pa reformim të BE-së

Darina Tanushi

Ballkani ka probleme, por e ardhmja e tij është në Bashkimin Evropian. Ishte ky konkluzioni i arritur në samitin e mbajtur dje, në Sofje të Bullgarisë mes BE-së dhe liderve të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në këtë samit mori pjesë edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili pati disa takime me lider të shteteve të ndryshme. Fillimisht, kryeministri Rama është pritur nga kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borissov, pritësi i këtij takimi. Më pas, kryeministri Rama ka zhvilluar një takim me presidentin e Komisionit Europian, Donald Tusk. Kryeministri Rama, gjithashtu, është takuar edhe me Presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiç, me të cilin është vënë re një takim mjaft miqësor. E më pas, Rama ka biseduar për disa momente edhe me kryeministrin e Greqisë, Alexis Tsipras. Rama, gjithashtu, është takuar me presidentin e Komisionit Europian Jean Claude Juncker dhe Presidentin e Parlamentit Europian, Antonio Tajani. Në përfundim të këtij samiti, presidenti i Këshillit Europian Donald Tusk e vlerësoi atë të suksesshëm. "Ashtu siç e kam thënë edhe gjatë vizitave të mia në rajon, Bashkimi Europian do të mbetet partneri më i qëndrueshëm për Ballkanin Perëndimor. Për të shmangur çdo konfuzion, më lejoni që të jem shumë i qartë. Nuk shoh të ardhme tjetër për Ballkanin përveç BE-së"- nënvizoi presidenti i Këshillit Europian. Ndërsa gjatë punimeve të samitit Presidenti francez Emmanuel Macron zbehu shpresat e vendeve të Ballkanit Perëndimor për integrimin në BE, kur deklaroi se para zgjerimit duhet një reformim i thellë në union. "Jam në favor që Ballkani t'i bashkëngjitet Europës, por çdo zgjerim i Bashkimit Europian duhet të shihet me shumë kujdes dhe rreptësi. Duhet të ndihmojmë të gjithë vendet që po kryejnë reformat dhe që avancojnë drejt Bashkimit Europian dhe kjo është një zgjedhje gjeostrategjike e imja". "Por, nuk jam në favor të zgjerimit para se të kemi të gjitha bindjet e duhura dhe para se të bëjmë një reformë të vërtetë që mundëson thellimin dhe funksionimin më të mirë të Bashkimit Europian. 15 vitet e fundit kanë treguar një rrugë që e ka dobësuar Europën, duke menduar çdo herë për zgjerimin e saj. Dhe mendoj, se kjo nuk i shërben as vendeve kandidate as neve vetë duke pasur një mekanizëm që nuk ka më rregulla dhe që shkon gjithnjë drejt zgjerimit. Por jam në favor që Ballkanit të ketë një dialog strategjik të përforcuar, një perspektivë dhe që ne të ndjekim nga afër reformat që bëhen dhe t'i inkurajojmë ato pa hiprokrizi",-u shpreh Makron. Megjithatë mesazhi i liderëve europianë ishte i qartë: Është koha për të folur për reforma substanciale dhe jo për data të caktuara.

**DEKLARATA**

Në deklaratën e firmosur në përfundim nga liderët e BE-së dhe 6 vendeve të BE-së thuhet se BE mbështet plotësisht rrugëtimin europian të Ballkanit Perëndimor. Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama dhe ai i Maqedonisë, Zoran Zaev ishin larguar më herët nga samiti dhe e kishin firmosur më përpara deklaratën e përbashkët. Ndërsa bashkë me liderët europianë marrëveshjen e nënshkruan presidenti serb Vuçiç, ai kosovar Thaçi, boshnjaku Izetbegoviç dhe kryeministri malazez Markoviç. Në këtë deklaratë thuhet: "BE-ja është e vendosur të forcojë dhe të intensifikojë angazhimin në të gjitha nivelet për të mbështetur transformimin politik, ekonomik dhe social të rajonit, duke përfshirë një asistencë më të madhe bazuar në një progres të prekshëm lidhur me shtetin e së drejtës, si dhe reformat social-ekonomike nga partnerët e Ballkanit Perëndimor". "BE mirëpret angazhimin e partnerëve të Ballkanit Perëndimor ndaj rëndësisë së demokracisë dhe shtetit të së drejtës, veçanërisht në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, qeverisjes së mirë si dhe respektit për të drejtat e njeriut dhe të drejtave të njerëzve të cilët i përkasin minoriteteve. Zbatimi i suksesshëm i reformave prej tyre qëndron mbi këto themele. Shoqëria civile dhe media e pavarur luajnë një rol vendimtar në procesin e demokratizimit",-vijon deklarata me 10 pika. Po ashtu BE mbështet angazhimin e partnerëve të Ballkanit Perëndimor për të forcuar më shumë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, stabilitetin rajonal dhe bashkëpunimin e ndërsjellë. Kjo përfshin në mënyrë të veçantë gjetjen dhe zbatimin e zgjidhjeve përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe detyruese për konfliktet e tyre dypalëshe me rrënjë në të kaluarën dhe përkushtimin ndaj përpjekjeve shtesë për pajtim.





Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama me Presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiç në Samitin e Sofjes

**EMANUEL MACRON**

"Jam në favor që Ballkani t'i bashkëngjitet Europës, por çdo zgjerim i Bashkimit Europian duhet të shihet me shumë kujdes dhe rreptësi. Duhet të ndihmojmë të gjithë vendet që po kryejnë reformat dhe që avancojnë drejt Bashkimit Europian dhe kjo është një zgjedhje gjeostrategjike e imja". "Por, nuk jam në favor të zgjerimit para se të kemi të gjitha bindjet e duhura dhe para se të bëjmë një reformë të vërtetë që mundëson thellimin dhe funksionimin më të mirë të Bashkimit Europian", tha Macron.

## Kryeministri flet për median gjermane: Anëtarësimi në BE, "çështje jetë a vdekje"

Shqiptarët janë mbështetës entuziastë të BE-së dhe Europa është feja jonë". Kështu deklaroi kryeministri Edi Rama në një intervistë për gazetën gjermane Frankfurter Allgemeine Zeitung, ku foli për procesin e integrimit europian të Shqipërisë. Me anëtarësimin në BE, theksoi Rama, "ne do të ndërtojmë një urë mes të kaluarës dhe të ardhmes sonë". Duke folur për rëndësinë që ka për Shqipërinë integrimi në Bashkimin Europian, Rama tha se "për ne dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor është çështje për jetë a vdekje". "Pas aq shumë e shumë vitesh dhimbjeje dhe ankthi, Europa përcakton të ardhmen tonë. Siç mund të jeni në dijeni, Shqipëria ka pasur regjimin më të frikshëm komunist në Europë dhe jo shumë larg në kohë, ne kemi përjetuar disa prej luftërave më të përgjakshme në Europë gjatë shpërbërjes së ish-Jugosllavisë ose në Kosovë", tha Rama. I pyetur lidhur me "koston" që do të ketë për BE-në anëtarësimi i Serbisë apo Shqipërisë, dhe dyshimet që krijon një hap i tillë kur bëhet një analogji me situatën e krijuar me Greqinë, Rama tha se, "ky nuk është problemi im, por është problem që duhet të zgjidhet nga politikanët gjermanë dhe britanikë". Ndërsa lidhur me avantazhet që



do të ketë për Gjermaninë dhe Bashkimin Europian, anëtarësimi i Shqipërisë në BE, kryeministri Rama u shpreh se "nuk dua të shqetësoj ata që nuk dëshirojnë që Shqipëria të bëhet anëtare e BE-së, pasi është një rrugë e gjatë për ne drejt BE-së". "Duke e thënë me fjalët e presidentit francez, Macron: Europa, së pari, ka nevojë për integrimin përpara se të fillojë zgjerimin e saj. Po, BE-ja ka nevojë për disa reforma. Dhe ne, gjithashtu, duhet të ndërmarrim reforma në vendin tonë. Por, shpresojmë se rrugët tona do të bashkohen një ditë. Shqipëria dhe Ballkani Perëndimor, janë të një rëndësie vendimtare për paqen dhe sigurinë e Europës. Ne jemi një zonë gri në Europë dhe kjo duhet të ndryshojë",-theksoi ai. Reforma jonë gjyqësore, vijoi Rama, duke përfshirë edhe ndryshimet kushtetuese, po transformon pothuajse gjithçka sot.

## Tusk: Ballkani Perëndimor pjesë e Europës, nuk ka një plan 'B'

Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk deklaroi se Ballkani Perëndimor do të jetë pjesë e Europës. Gjithashtu, Tusk theksoi se nuk ka një plan 'B' për procesin e integrimit dhe Bashkimi Europian do të jetë partneri më i madh i Ballkanit Perëndimor. "Unë nuk shoh ndonjë të ardhme tjetër për Ballkanin Perëndimor sesa BE. Nuk ka alternativë, asnjë plan B. Ballkani Perëndimor është pjesë integrale e Evropës dhe ata i përkasin komunitetit tonë" deklaroi Tusk. Pas disa javësh disa nga vendet e Ballkani Perëndimor si: Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova do të përballen me vendimet e 28 vendeve anëtare në Këshillin e Europës për procesin e integrimit. Shqipëria dhe Maqedonia kërkojnë çeljen e negociatave ndërsa Kosova bën hapin e parë integrues për marrëveshjen e stabilizim- asocimit dhe pretendon lëvizjen e lirë dhe pa viza.

## Audio-përgjimi, Vasili: Rama duhet marrë në ndjekje penale

Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili tha dje, se kryeministri Rama duhet të ndiqet penalisht për atë që tha për audiopërgjimin e vëllait të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Vasili u shpreh se deklaratat e djeshme të kryeministrit në lidhje me verifikimin e audio-përgjimit tregon se Rama dhe prokuroria janë një.

"Kush është ky kryeministër? Çfarë verifikon ky? Dihet që audio-përgjimi është sekuestruar nga prokuroria dhe bile janë thirrur edhe deputetët që e kanë bërë publike. Këtë material e ka sekuestruar vetëm prokuroria, si e paska edhe kryeministri?! Prokuroria dhe kryeministri qenkan një që i lejokërka këtij kryeministri të bëjë verifikime, të japë edhe përgjigje të mbyllë dhe proceset", tha ai për Ora News. "Këtu është shqetësimi më madhor që praktikisht ekzekutivi i kryeministrit me ngjyrime shumë të errëta imponon dhe udhëheq punën e prokurorisë, e cila është tashmë e paralizuar, ecën me ritmin e kryeministrit. Çuditërisht një prokurori që në disa momente bëhet shumë e rrufeshme, atje ku merr porosinë nga kryeministri. Për çështje kaq të mëdha është e mefshtë, nuk di të flasë. Vasili tha se dëshmia e publikuar dje, ishte shumë tronditëse, por jo surprizë për deklaratat që u dhanë nga Albert Veliu.

Besim Hajdarmataj: Disponojmë fakte që e implikojnë ish-ministrin në grupin kriminal "Habilaj"

# Çështja "Tahiri", avokati kërkon lirimin, prokuroria këmbëngul për arrest me burg

## *Maks Haxhia: Apeluam vendimin, nuk kanë prova*

Ina Allkanjari

Vijon beteja me drejtësinë për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahirin. Ditën e djeshme Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe pala mbrojtëse e Saimir Tahirit, avokati Maks Haxhia depozituan kërkesën për të apeluar masën e sigurisë "arrest shtëpie" të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda. Haxhia kërkon rrëzimin e vendimit të dhënë të shtunën e kaluar ndaj Tahirit, me pretendimin se prokurorët nuk kanë sjellë asnjë provë të re, duke kërkuar heqjen e arrestit dhe hetimin në gjendje të lirë për ish-ministrin. Nga ana tjetër, organi i akuzës depozitoi në Apel kërkesën për caktimin e masës arrest me burg për ish-zyrtarin e lartë. Sakaq, kërkesa pritet të shqyrtohet brenda 10 ditëve. Mbi Tahirin rëndojnë akuzat për trafik të lëndëve narkotike në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe korrupsionit të zyrtarëve të lartë.

**HETIMI**

Pas dyshimeve për marrje ryshfeti dhe përfshirje në një rrjet të trafikut të drogës, ditën e shtunë Gjykata e Krimeve të Rënda caktoi masën e sigurisë "arrest shtëpie" për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahirin. Prokurorët kërkuan që ndaj Tahirit të vendoset masa "arrest me burg" deri në përfundim të hetimeve, por me vendim gjykate, kjo kërkesë u rrezua. Gjatë seancës së të martës, ku Tahiri u paraqit pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda për verifikimin e masës së sigurisë "arrest shtëpie", avokati mbrojtës i tij, Maks Haxhia i kërkoi trupës gjykuese që ta lërë të lirë ish-ministrin, pasi nuk ka prova që vërtetojnë se ai është përfshirë në trafik droge. Nga ana tjetër, prokurori i çështjes "Tahiri", Besim Hajdarmataj kërkoi shtrëngimin e masës për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri, por jo vetëm. Hajdarmataj hodhi dyshime të forta edhe për një përgjim të mundshëm të prokurorëve nga ish-ministri, apo njerëz të lidhur më të, duke thënë se Tahiri informohet paraprakisht për provat që prokuroria disponon. "Para se të jenë provat në tavolinën e punës sime, ato janë në duart e Saimir Tahirit. Ai ndërhyn dhe merr vesh para meje se kë do thërras nesër dëshmitar", - është shprehur Hajdarmataj. Ndërkohë, gjatë seancës ish-ministri i Brendshëm, replikoi me prokurorët, madje ai i ka akuzuar këto të fundit se kanë abuzuar me faktet, duke shkruar gënjeshtra. Prokurori i çështjes, Besim Hajdarmataj, tha se do i drejtohen Gjykatës së Apelit me kërkesën për arrestimin e Tahirit, për të cilin disponojnë prova që e implikojnë në grupin kriminal të drejtuar nga Moisi Habilaj. Gjatë seancës, ish-ministri replikoi me gjykatësen duke u shprehur se për të ishte e njëjta gjë si masa arrest me burg, ashtu edhe arrest shtëpie. "Për mua është njësoj si arresti me burg, si arresti i shtëpisë. Unë nuk kam ndërmend të largohem nga vendi. Këtu do jem për të pritur drejtësinë", - ka thënë ish-ministri. Kujtojmë se pas caktimit të masës "arrest shtëpie" për Tahirin, Ambasada e SHBA në Shqipëri përshëndeti vendimin, duke thënë në një deklaratë se, "ky rast i rëndësishëm korrupsioni do të vendoset në mënyrë të drejtë dhe transparente në gjykatë".



Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri dhe avokati Maks Haxhia

**AKUZA**

> "Prokuroria e Krimeve të Rënda ka ngritur dy akuza ndaj Saimir Tahirit, "Trafikimin e narkotikëve" të kryer në bashkëpunim, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal, si edhe "Korrupsionin pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë".

**HAXHIA**

Pala mbrojtëse e Saimir Tahirit, avokati Maks Haxhia depozitoi ditën e djeshme kërkesën për të apeluar masën e sigurisë "arrest shtëpie" të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda. Haxhia kërkon rrëzimin e vendimit të dhënë të shtunën e kaluar ndaj Tahirit, me pretendimin se prokurorët nuk kanë sjellë asnjë provë të re, duke kërkuar heqjen e arrestit dhe hetimin në gjendje të lirë për ish-ministrin e Brendshëm. Kërkesa pritet të shqyrtohet brenda 10 ditëve.



**HAJDARMATAJ**

Organi i akuzës depozitoi ditën e djeshme në Apel kërkesën për caktimin e masës "arrest me burg" për ish-zyrtarin e lartë, Saimir Tahirin. Sipas prokurorit të çështjes, Besim Hajdarmataj, ndaj ish-ministrit disponohen prova që e implikojnë në grupin kriminal të drejtuar nga Moisi Habilaj. Më herët Hajdarmataj hodhi dyshime të forta edhe për një përgjim të mundshëm të prokurorëve nga ish-ministri, apo njerëz të lidhur më të, duke thënë se Tahiri informohet paraprakisht për provat që prokuroria disponon.



Rinis procesi për atentatin e pretenduar ndaj deputetit

# Nën akuzë për kallëzim të rremë, prokuroria kërkon shoqërimin me forcë të Doshit dhe Bamit

Në kuadër të çështjes gjyqësore për të cilën deputeti Tom Doshi, ish-deputeti Mark Frroku dhe Durim Bami po gjykohen për dëshmi të rremë, ditën e djeshme procesi ndaj tyre ka rinisur nga e para. Sipas prokurorisë, tre të pandehurit e kësaj dosjeje në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë krijuar prova të rreme, me qëllim për të ushtruar ndjekje penale ndaj Presidentit Ilir Meta. Çështja në fjalë ka të bëjë me pretendimet e Tom Doshit se Meta kishte urdhëruar vrasjen e tij bashkë me ish-deputetin e PD-së, Mhill Fufi dhe se këtë gjë ia kishte rrëfyer miku i tij, Mark Frroku. Por, prokuroria pas hetimeve arriti në konkluzionin se gjithçka ishte e sajuar dhe i mori të pandehur. Çështja e tyre kaloi në të gjitha gjykatat, nga ajo e Larta, në Kushtetuese, pastaj tek Krimet e Rënda e në fund u rikthye në Gjykatën e Tiranës. Durim Bami u arrestua në 2 mars 2015 në pikën e kalimit kufitar të Hanit të Hotit, në rrethin e Malësisë së Madhe. Shkak u bënë deklaratat publike të deputetit Tom Doshi, se Bami ishte "rekrutuar" për eliminimin fizik të tij dhe të deputetit tjetër, Mhill Fufi. Pas arrestimit, ai mohoi të kishte marrë porosi për vrasjen dhe pretendoi se ishte kërcënuar nga deputeti për t'u regjistruar duke folur për "skenarin" e eliminimit të tij. Pas tri vitesh qëndrimi në arrest shtëpie për atentatin e supozuar, Durim Bami doli në liri të plotë. Ndërkohë, ditën e djeshme ata nuk janë paraqitur në seancën e sotme gjyqësore, ndërkohë mësohet se prokuroria ka kërkuar marrjen me forcë të Doshit dhe Bamit, por gjykata e ka rrëzuar një kërkesë të tillë. Për Mark Frrokun, prokurori i çështjes ka deklaruar se do t'i dërgojë sërish një fletëthirrjeje, pasi të parën ia dërguan në burgun e Fierit, nga i cili ai u la i lirë pak ditë më parë. Sakaq, mësohet se avokatët mbrojtës do të kërkojë gjykim të shkurtuar dhe seanca e radhës do të mbahet më 5 qershor.

**AKUZA**

Sipas prokurorisë, tre të pandehurit e kësaj dosjeje, në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë krijuar prova të rreme, me qëllim për të ushtruar ndjekje penale ndaj Presidentit Ilir Meta. Çështja në fjalë ka të bëjë me pretendimet e Tom Doshit se Meta kishte urdhëruar vrasjen e tij bashkë me ish-deputetin e PD-së, Mhill Fufi dhe se këtë gjë ia kishte rrëfyer miku i tij, Mark Frroku.



Tom Doshi


**SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k**
Adresa: Rr." Demokracia" Pll.1, Kt.1, Vore, Tirane. .
Web: www.3-h.al; Email: shpgj_3h@yahoo.com Tel/Fax +355(0) 44532482

Njofton shpalljen e ankadit nga **dt.17.05.2018 deri ne dt. 25.05.2018** per: sende të luajtshme mjeti me targe AA 957 GX Nissan Atleon 140, Vit prodhimi 2000, karburant-nafte, per skrap ne pronesi te Subjektit "Harizi Co" me Nipt K82122503F

**Çmimi fillestar eshte 78,400.00 (shtatedhjete e tetemije e katerqind) Leke Ankandi zhvillohet ne zyren permbarimore ne daten 25.05.2018 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00.**

## Bashkim Nikolla: Klienti im është dënuar në mungesë

# Dosja 'Hajdari', avokati i Izet Haxhisë dorëzon kërkesën për rihapjen e çështjes

**TIRANE**- Pas ekstradimit nga Turqia për në Shqipëri, Izet Haxhia, ish-truproja i Sali Berishës, i akuzuar për vrasjen e Azem Hajdarit ka pajtuar avokat të ri. Nëpërmjet një prononcimi, avokati Bashkim Nikolla ka thënë se ka paraqitur kërkesën në gjykatë për rihapjen e dosjes 'Hajdari', pasi klienti i tij është dënuar në mungesë. "Paraqita kërkesën për rihapjen e dosjes. Dosja 'Hajdari' duhet të rihapet, pasi klienti im, Izet Haxhia është dënuar në mungesë. Klienti im të dëgjohet përpara një gjykate. Izet Haxhia s'u paraqit për arsye madhore. Do flasim në kohën e duhur për këtë çështje"- ka thënë avokati i Izet Haxhisë, Bashkim Nikolla. Kujtojmë se Haxhia, është vetëdorëzuar në policinë turke, me qëllim ekstradimin më pas drejt Shqipërisë. Ka qenë vet Haxhia që ka bërë të ditur vendimin e tij përmes një statusi në 'Facebook'. "Meqë nuk erdhën të më marrin, u dorëzova vetë në policinë turke", shkruan Haxhia. Më tej përmes një lidhje telefonike për 'News24' Haxhia tha se nuk kishte asnjë lloj pritshmërie nga drejtësia në Shqipëri. "Drejtësi nuk ka për të bërë asnjëherë në Shqipëri. Por nuk mund të rri këtu si një njeri pa atdhe, pa asnjë dokument, duke pritur të më arrestojnë kur t'u teket këtyre sipas marrëveshjeve ndërshtetërore të dy qeverive për interesa të tyre. Më mirë të dorëzohem vetë se të më arrestojnë. Kam dy orë që jam dorëzuar, pres të dal në gjykatë për vendimin. Nuk kam asnjë lloj pritshmërie nga drejtësia në Shqipëri",-tha Izet Haxhia. Izet Haxhia më datë 29.04.2002 u dënua nga gjykata e Tiranës me 25 vjet burg për vrasje e Azem Hajdarit në 12 shator 1998. Në vitin 2006 ai u arrestua nga policia turke ku edhe kërkoi azil politik, por që nuk iu miratua asnjëherë. Ai përfitoi një leje qëndrimi me kushtin që të mos dilte nga Turqia. 12 vjet më pas, gjykata turke pranoi kërkesën për ekstradim të shtetit shqiptar dhe Ministria turke e Drejtësisë e miratoi disa ditë më parë. Ai akuzohet për veprat penale "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese e kryer në bashkëpunim", Vrasje me paramendim e kryer në bashkëpunim" dhe "Vrasje me paramendim e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim".

25

**25 VJET BURG**

Izet Haxhia më datë 29.04.2002 u dënua nga gjykata e Tiranës me 25 vjet burg për vrasje e Azem Hajdarit në 12 shator 1998. Në vitin 2006 ai u arrestua nga policia turke ku edhe kërkoi azil politik, por që nuk iu miratua asnjëherë. Ai përfitoi një leje qëndrimi me kushtin që të mos dilte nga Turqia.



## Hetimet të përqendruara në dy pista: Për shkak të një lidhje me një femër ose për konflikte pronësie

# U gjet i djegur në Fushë-Krujë, del ekspertiza: Xhafer Osmanin e torturuan dhe i vunë flakën

## "Në fillim i janë bllokuar rrugët e frymëmarrjes"

Ina Allkanjari

**FUSHE-KRUJE**

Trupi i gjetur i djegur në një makinë dy javë më parë në Fushë-Krujë është i shtetasit Xhafer Osmani, nga Pestova e Mitrovicës, në Kosovë. Konfirmimi është dhënë nga mjekësia ligjore pas analizës së ADN-së se mbetjeve të trupit të djegur në makinë dhe krahasimit të saj me ADN-në e të afërmve të tij. Gjithashtu, nga ekspertiza mjeko-ligjore vërtetohet se Osmani është djegur i gjallë. Autorët e kanë lidhur me litar dhe e lyen me benzine 57-vjeçarin dhe me pas e dogjën. Në trupin e tij janë gjetur mbetje litarësh dhe teli. Osmani ka vdekur pak minuta pasi iu vu flaka dhe në fillim i janë bllokuar rrugët e frymëmarrjes. Sakaq mësohet se policia po heton në dy pista. Ajo e vrasjes për shkak të një lidhje me një femër në Shqipëri si dhe në pistën tjetër për shkak të konflikteve të pronësisë për një biznes.

**NGJARJA**

Automjeti me pronar Xhaferr Osmanin, kishte hyrë nga Kosova drejt Shqipërisë përmes pikës doganore të Morinës më 29 prill, ndërsa në zonën e Fushë-Krujës mjeti ka hyrë rreth orës 10 të paradites së të shtunës së 5 majit. Ndërkohë u bë me dije se automjeti në të cilën u gjet trupi i pajetë i vrarë dhe më pas i djegur, është fiksuar nga kamerat e sigurisë së një karburanti 250 metra larg vendit të ngjarjes. Sipas të dhënave nga policia, mjeti tip "Volkswagen Touran" me targa 02960SN rezulton të jetë futur në rrugicën pranë karburantit në orën 10:00, ndërsa sinjalizimi për zjarrin është dhënë në orën 13:05 minuta. Mësohet se mjeti ishte i pajisur me xhama të zinj në dyert e pasme, ndërsa kamerat kanë arritur të fiksojnë vetëm shoferin, një person rreth 30 - 35 vjeç. Ndërsa viktima dyshohet se ka qenë i lidhur në pjesën e pasme të automjetit. Pasi kanë vajtur në fund të një are të mbjellë me grurë dhe pa dalje, autorët e kanë fshehur makinën në kallamishte për të mos u dukur. Autorët e kanë mbajtur viktimën për rreth tri orë në të njëjtin vend dhe më pas kanë vendosur ta djegin. Dyshimet janë se ndaj viktimës mund të jetë ushtruar dhunë apo tortura të ndryshme me qëllim nxjerrjen e ndonjë të dhëne që ju ka interesuar autorëve, të cilët më pas e kanë vrarë dhe i kanë vënë zjarrin makinës për të humbur gjurmët. Pas ekspertizës mjeko-ligjore u vërtetua se Osmani është djegur i gjallë. Autorët e kanë lidhur me litar dhe e lyen me benzine 57-vjeçarin dhe me pas e dogjën. Gjithashtu, u bë me dije se viktima është gjendur i karbonizuar me pak pjesë biologjike të mbetura në pjesën e pasme të makinës. Sakaq policia ka shoqëruar disa persona, si të dyshuar për ngjarjen. Po ashtu po hetohet itinerari i lëvizjes së mjetit. Ngjarja e rëndë u raportua në datë 5 maj rreth orës 14:00. Ka qenë një person, banor në fshatin Borizanë ai që ka parë makinën teksa digjej. Pak minuta më pas në vendngjarje kanë shkuar zjarrfikësit e policia. Pasi janë shuar flakët, brenda saj është konstatuar kufoma e shkrumbuar e një personi të seksit mashkull. Ndërkohë policia jonë po bashkëpunon dhe me policinë lokale të Mitrovicës për të mësuar më shumë lidhur me profilin e personit që mendohet se mund të jetë viktima. Drejtoria e përgjithshme e Policisë së Shtetit ka vënë në dispozicion të komisariatit të Fushë-Krujës të gjithë asetet e nevojshme për zbulimin e kësaj ngjarje.



Viktima Xhafer Osmani



Vendi ku ndodhi krimi

**HETIMI**

Nga ekspertiza mjeko-ligjore vërtetohet se Osmani është djegur i gjallë. Autorët e kanë lidhur me litar dhe e lyen me benzine 57-vjeçarin dhe me pas e dogjën. Në trupin e tij janë gjetur mbetje litarësh dhe teli. Osmani ka vdekur pak minuta pasi iu vu flaka dhe në fillim i janë bllokuar rrugët e frymëmarrjes. Sakaq mësohet se policia po heton në dy pista. Ajo e vrasjes për shkak të një lidhje me një femër në Shqipëri, si dhe në pistën tjetër për shkak të konflikteve të pronësisë për një biznes.

**VLORË**

### Plagosën 30-vjeçarin brenda në një lokal, identifikohen dhe shpallen në kërkim 3 autorët

Policia e Vlorës ka identifikuar dhe ka shpallur në kërkim tre persona, të cilët paraditen e së mërkurës plagosën me armë 30-vjeçarin Eraldo Danaj. Ngjarja në fjalë ndodhi në ambientet e një lokali në lagjen "Pavarësia" të këtij qyteti. Burime zyrtare nga policia vendore dje bënë me dije se autorët e kësaj ngjarjeje janë shtetasit N.Ç.,(T)., 34 vjeç, banues në Tiranë; G.GJ., 28 vjeç, banues në Radhimë dhe M.A., 25 vjeç, banues në Babicë e Madhe. Ndërkohë, prangave nuk i ka shpëtuar as Eraldo Danaj nga fshati Llakatund. Sipas bluve, i riu i cili mbeti i plagosur me një plumb në këmbë u arrestua pasi gjatë kontrollit në makinën e tij "Range Rover", u gjetën dhe u sekuestruan 200 fara bimore kanabisi. Policia sekuestroi në total një gëzhojë arme zjarri, 200 fara bimë narkotike kanabisi dhe 2 automjete "Porsche" e "Range Rover". Ndërsa, vijojnë hetimet për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje.

Lista e qytetarëve sipas lejeve të legalizimeve dhe VKM-së për parcelat ndërtimore

Ornela Manjani

# Hipoteka, 203 pronarët që kanë gati tapitë e shtëpive

## *Përfituesit e certifikatave të pronësisë në qarkun e Elbasanit*

Hipoteka e Elbasanit ka gati certifikatat e pronës për shtëpitë dhe parcelat ndërtimore të 203 personave, të cilët kanë ndërtuar pa leje. Lista e aplikuesve të pajisur me certifikata pronësie sipas lejeve të legalizimeve dhe VKM për parcelat ndërtimore bëhet e ditur nga burime zyrtare pranë hipotekës, sipas të cilave mësohet se kanë përfunduar të gjitha procedurat për pajisjen me tapi të 203 pronarëve në qarkun e Elbasanit. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë me përfituesit.

**LIGJI**

Sipas ligjit në fuqi, personat që kanë ndërtuar pa leje nuk janë të detyruar të tërheqin lejet e legalizimeve dhe më pas të regjistrojnë pronën në hipotekë. Kjo procedurë realizohet nga ALUIZNI. Qytetarët çlirohen nga tarifa 5 mijë lekë dhe certifikatat e pronësisë do t'u shkojnë në shpi. Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare, hyn në fuqi sot dhe parashikon që personat që kanë ndërtuar pa leje, që kanë vetëdeklaruar dhe kanë paguar faturën për parcelën ndërtimore do të marrin tapitë e shtëpive nga ALUIZNI. Afati për pajisjen me certifikatën e pronësisë shkurtohet në 10 ditë nga data e miratimit të lejes së legalizimit. Personat që janë në proces legalizimi dhe kanë paguar rregullisht faturën energjisë elektrike gjatë gjithë vitit të fundit përfitojnë 10% zbritje nga fatura për pagesën e truallit. Këto janë ndryshimet kryesore të miratuara në mbledhjen e fundit të Këshillit të Ministrave. Në vendim përcaktohet se kërkesa për shërbimin e regjistrimit të lejes së legalizimit dhe për lëshimin e certifikatës së pronësisë, për pasurinë e legalizuar, paraqitet nga ALUIZNI në emër të përfituesit të lejes, sipas formularit të kërkesës, të miratuar nga ZRPP-ja.

### LISTA E APLIKUESVE TE PAJISUR ME CERTIFIKATE PRONESIE SIPAS LEJES SE LEGALIZIMIT DHE VKM PER PARCELAT NDERTIMORE

1-FLAMUR BIBA
2-FAIK QAMILMETA
3-KLODIAN MYQELEFI
4-ARDIAN MURAT LLESHI
5-AGRON ABEDINI
6-FITNETE SHTYLLA
7-PETRIT CERMA
8-HIQMET LENA
9-ARDJAN LLESHI
10-AGRON SHABAN BAJRAMI
11-XHEVAHRI RIZA SHARRA
12-ALBERT ISAT MUSTA
13-PERIKLI DEMO DURRO
14-GEZIM ZEQO ELEZI
15-GJERGJI SHEBRIT XHRA
16-KISHA ORTH AUTOQEFALE
17-ARDIAN PRENI SHQAU
18-NAZMI IDRIS HOXHA
19-ALI JONUS SALIU
20-ARTJAN SHEFQET HOXHOLLI
21-ASTRIT FATMIR CALA
22-GENTIAN SHABAN NASUFI
23-REFIT SHERIF MIRAKA
24-FATMIR ISMAIL DOLENGA
25-ISMAIL SHAQIR HYSA
26-PETRIT FERIT TABAKU
27-BESIM QEMAL KURTI
28-SHKELQIM QEMAL KURTI
29-MIHAL PETER QOSJA
30-ANDREA RUZHDI KASA
31-DESTAN ELMAZ SHEHI
32-SERVET ALI ZACJA
33-MARTIN DEMIRALI SHULI
34-REXHEP HALIT HANKO
35-XHEVIT SHANO ISA
36-BASHKIM FANI QOSJA
37-BEHAR BAJRAM KABASHI
38-KOVI VENEMIN SINANI
39-ISMET ASLLAN DYRMA
40-BEQIR SHAHIN META
41-DHULQIF RAMADAN BELULI
42-MELI SEIT DAUTLLARI
43-HAVA MEHMET PISHA
44-ISUF TEMO KAMBERAJ
45-FIDAHI REXHEP SHARRA
46-HIQMET DAIL CERENI
47-FLORENC NEVRUZ BOCI
48-BEXHET JEMIN CERRIKU
49-SHPETIM MUSA PRECI
50-ISMAIL NEXHIP BALLA
51-SERVETE SHAHIN GURAKUQI
52-HANIFE SELIM DUSHKU
53-BASHKIM ZENEL HOXHAJ
54-ASTRIT QERIM SHTOGU
55-TAULAND QERIM DERVISHI
56-PELLUMB HALIT SINA
57-KUJTIM DASHAMIR BRANESHI
58-JEMIN QEMAL URUCI
59-BLEDAR AGIM DERVISHI
60-KASTRIOT SOTIR PANXHI
61-JULIAN SULO AVDIU
62-EDUART HAKI HOXHA
63-HASAN SALI LILA
64-XHEVDET NEFAIL GJONA
65-DALLANDYSHE BAFTJAR CELA
66-DAVID HYSEN KULLAU
67-DHIMITER NASKA
68-HEKURAN MEHMET ZEKTHI
69-MIRELA RUZHDI STAMBOLLXHIU
70-ASTRIT CEHU
71-FERIT KOCI
72-SERVET DAUTI
73-AGRON DYLBER SADE
74-OSMAN KOMSHIU
75-SERVET XHIKA
76-ARJAN GORI PETOVA
78-SKENDER KASEM CARKU
79-DYLAVER METHASA
80-TOMORR LAMCJA
81-BASHKIM SULEJMAN BAJRAMI
82-VENEMIN PREN QOSJA
83-FATMIR ISMAIL DOLENGA
84-ARTUR REXHEP KABILO
85-ZENEPE ISUF ALLA
86-XHEVAHIR SULEJMAN KARAJ
87-AVNI ISUF LUGA
88-TEFIK ETHEM SPAHIU
89-ARTAN HASAN MIRAKA
90-SHAQIR MEHMET DIKA
91-SALI AQIF KOLECI
92-RAMAZAN RIZA QEFA
93-HIQMET SELMAN DELIU
94-FUAT DERVISH SADAJ
95-ILIR HIQMET BALA
96-XHAFERR SABRI GOSTIMA
97-HYQMET BAJRAM KUSI
98-VALTER ZEQIR HOXHA
99-DERVISH ISAT HAZIZOLLI
100-LAVDIMIR SKENDER KURANI
101-TOMORR SALI KOLECI
102-RIZA RIZA NIPOLLI
103-ALBERT LIMAN BICA
104-RIZA FETA KORANI
105-DILAVER KADRI DISHANI
106-PETRIT ALI CEKINI
107-XHAVIT SULE CAPJA
108-HALIL ISMAIL PLAKU
109-QEMAL BILAL KLLOGJERI
110-ELTON NEFAIL BIBA
111-SEFEDIN IDRIZ PEPA
112-SKENDER IBRAHIM GJATA
113-MUSTAFA POKA
114-HYSNI DURAKU
115-ASLLAN CELA
116-HAVA ADEM STAFA
117-NAZIF RIZA HASANLLARI
118-TAHIR METAN HYSA
119-FISNIK ISMAIL ZORBA
120-SHPETIM ADEM DYLGJERI
121-SELMAN SEJDIN KUMURIA
122-LLAZAR JORGJI SOTIRI
123-GEZIM VANGJEL OGA
124-HABIB HASAN DUKA
125-YLBER PETER TERZIU
126-JULIAN NEFAIL BIBA
127-BELUL ABDYL FERO
128-BASHKIM KADRI BAXHAKU
129-AGRON IBRAHIM SAMURRI
130-ADRIATIK FAIK LARAJ
131-SELIM SELIM ISUFI
132-LULEZIM PETRIT ZENUNI
133-EDMOND XHEMAL SARACI
134-BARDHYLE ILMI ZALOSHNJA
135-XHOXHI VASIL KENACO
136-ALKETA ALI QATJA
137-MUHARREM VAHIT SINANAJ
138-VULLNET HALIT DEBROVA
139-DURIM AHMET ISMAILI
140-RAZIJE SELMAN KOPLIKU
141-BESIM QERIM MAMALLA
142-NOSI DHIMITER RANXHA
143-ARDIAN ZENUN RUDA
144-AVRAM IRAKLI SKENDERI
145-TELHA SHYQYRI BENGASI
146-BUJAR XHAVIT BALLA
147-HASAN REXHEP GACE
148-NIKOLL MERKUR HAZIZI
149-SONILA ALI VRAPI
150-LEONIDHA HAMIT BALLIU
151-FATMIR QAMIL MYQELEFI
152-KUJTIM YMER KOBURJA
153-AGRON QAZIM FILJA
154-JANI SIMON DOKA
155-DHIMITER RUSHAN HYKO
156-ENDRI GANI BAJA
157-BAJRAM TAHIR SLLAMI
158-ALBANA XHEVIT BUJARI
159-ALBERT XHAVIT NURI
160-PETRIT XHEMALI SOLLAKU
161-ENEA AGIM MUSHI
162-ARTUR REXHEP KABILO
163-LUMTURI TURABI
164-ASLLAN CELA
165-AKPER QATIPI
166-KOSTANDIN TAVANXHIU
167-BARDHUL SALLIU
168-GAZMIR RIZA XIBRRAKU
169-DRITAN ARIF ALLKO
170-DHURATA XHEMALI TOPALLI
171-DHIMITER MEHMET GJOKA
172-NAIM DEMIR HOXHA
173-RAMADAN QANI ROCI
174-JEMIN SHERIF PRECI
175-LLAZAR VANGJEL BEZHANI
176-XHEVAHIR HASNA HASA
177-MITHAT DAUT MUCA
178-FATOS FATMIR XHELILI
179-NADIRE ISMAIL KASA
180-QAMIL YZEIR METUSHI
181-LEONARD TOMORR XHERRI
182-DYZNIJE ESTREF DISHA
183-FATOS HALIM HOXHOLLI
184-ZIKE SHEFQET BANUSHI
185-SALI IBRAHIM GAVA
186-RAMAZAN ZENEL GJYLA
187-AGIM JACE TABAKU
188-KASTRIOT DERVISH LLAHA
189-ARTAN HALIT SHABANI
190-FATMIR ISA BICI
191-BEIQR ALI META
192-KOSTANDIN NAUN TOPI
193-NDRICIM MURAT LIKRAMA
194-HALIT IBRAHIM MUCA
195-NAZMI DAUT VASKA
196-RAMAZAN CECO BORA
197-ASLLAN XHEMAL BITRA
198-SEJDIN SHERIF BAJRAMI
199-AGIM GEGA
200-HANIFE XHEMAL MALOKU
201-SOKOL SAIP BIBA
202-SALI AHMET PESHKU
203-QAZIM AHMET PESHKU

SIGURIMI I KURSIMEVE



## Fondi i ASD arrin në 5.34% të depozitave të siguruara

Fondi i sigurimit të depozitave arriti në 35 miliardë lekë në fund të vitit 2017. Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, Genc Mamani, tha gjatë raportimit në Kuvendin e Shqipërisë se raporti i mbulimit të depozitave bankare nga fondi i agjencisë arriti në 5.34%, nga 5.11% që kishte qenë një vit më parë. Ky është niveli më i lartë i mbulimit i regjistruar deri më sot. Të ardhurat në fondin e sigurimit të depozitave sigurohen nga kontributet e bankave dhe shoqërive të kursim-kreditit, si edhe nga investimi i këtyre kontributeve në instrumente financiare. Vitin e kaluar, në skemën e sigurimit të depozitave u përfshinë edhe shoqëritë e kursim kreditit dhe depozitat e bizneseve. Në total, depozitat e sigurueshme sipas ligjit arritën në 1074 miliardë lekë, ose 96% e totalit të depozitave në sistemin financiar. Nga këto, vlera e depozitave që kalojnë nivelin maksimal të mbulimit dhe që sigurohen pjesërisht është 667 miliardë lekë. Sipas ASD, 6% e depozituesve zotërojnë 62% të totalit të depozitave bankare.

### Deeuroizimi, guvernatori: Plani i masave fillon në 6-mujorin e dytë të 2018-ës

# E ardhmja e ekonomisë, Sejko: Çelësi, konkurrenca e ndershme dhe Bursa

## "Plani në afatmesëm, rritje e punësimit dhe e pagave"

Ornela Manjani

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko tha dje se rritja më e lartë ekonomike do të kërkojë përmirësim të klimës së biznesit dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve financiare. Guvernatori përsëriti optimizmin se në vitet në vazhdim, përmirësimi i kërkesës do të nxisë një rritje më të lartë të prodhimit, punësimit dhe pagave në ekonomi. Por, sipas tij, në një horizont më afatgjatë është e domosdoshme që klima e biznesit të përmirësohet, sidomos në drejtim të garantimit të konkurrencës së ndershme. Ai vuri theks të veçantë në nevojën për të zgjeruar tregjet financiare. Nëse deri më sot kreditimi është mbështetur pothuajse tërësisht te sistemi bankar, rritja dhe dinamizmi i mëtejshëm i ekonomisë do të kërkojë domosdoshmërish zhvillimin e tregjeve të kapitalit dhe instrumenteve të Bursës.

**DEEUROIZIMI**

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko ka prezantuar dje në Kuvend Raportin e Politikës Monetare. Në prezantimin e analizës, guvernatori raportoi se ekonomia shqiptare vijon të ruajë një trend pozitiv zhvillimi. "Viti që lamë pas ka qenë vit progresi. Vëllimi ekonomik u rrit me 3.8%. Nga këndvështrimi i kërkesës agregate, rritja ekonomike u mbështet nga rritja e konsumit, investimeve dhe eksportit. Zgjerimi ndihmoi rritjen në sektorin e shërbimeve dhe në degë të caktuara të sektorit të industrisë. U krijuan 79 mijë vende të reja pune dhe punësimi u nxit kryesisht nga sektori i shërbimeve", - tha Sejko gjatë fjalës së tij. Pavarësisht rritjes dhe zgjerimit, guvernatori shtoi se ekonomia po përballet me sfida. "Inflacioni erdhi në rritje, duke shënuar një nivel 2% nga 1.3% që ishte një vit më parë. Megjithatë, ky tregues vijon të mbetet nën objektiv, ndikuar edhe nga kursi i këmbimit, referoi Sejko. Deficiti i llogarisë korrente u ul dhe përmirësimi i tij reflektoi rritjen e aktivitetit turistik. Për sa u përket tregjeve financiare, treguesit e sistemit bankar erdhën në përmirësim. Veprimtaria ka qenë e qëndrueshme, ndërsa raporti i kredive me probleme ishte 13.2%. Politika monetare dhe mbikëqyrja e sistemit bankar vazhdojnë të mbeten dy instrumentet kryesore të Bankës së Shqipërisë. Stimuli i ekonomisë u mundësua nëpërmjet normave të ulëta të interesit, të cilat kanë qenë në nivelin më të ulët historik. Ambienti financiar me interesa të ulëta ka ndihmuar njësitë ekonomike në kreditim. Shkalla e lartë e euroizimit ekspozon ekonominë ndaj rreziqeve të kursit të këmbimit dhe përdoruesit nga luhatjet. Nënshkruam memorandum, ku palët janë angazhuar në uljen e përdorimit të euros. Banka ndërmori një sërë planesh, që hyjnë në fuqi në gjysmën e dytë të 2018. Ky plan masash synon nxitjen e përdorimit të monedhës kombëtare. Banka e Shqipërisë ka vijuar me planin kombëtar për uljen e kredive me probleme. Në drejtim të stabilitetit, Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për mbikëqyrjen e kujdesshme dhe proaktive. Ekzaminimet treguan se sistemi bankar është përmirësuar. Përmirësimi ciklik, i nxitur nga kushtet e favorshme pritet të vazhdojë në afatmesëm", tha Sejko.



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, dje në parlament

**PUNËSIMI**

Në afatmesëm pritet rritje e punësimit dhe e pagave. Sejko shtoi se, "bashkërendimi i politikave është jetik për sigurimin e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike. BSH ka punë për të bërë për forcimin e rritjes ekonomike dhe rritjes së rezistencës nga goditjet e mundshme. Në gjykimin tonë, reformat strukturore duhet të adresojnë në përmirësimin e klimës së biznesit, uljen e informalitetit, përmirësimin e kuadrit ligjor, funksionimin e administratës publike, zgjerimin e tregjeve për produkte shqiptare, rritjen e eficenës së ekonomisë shqiptare, përmirësimin e standardeve të administrimit të biznesit. Një ekonomi më rezistente përballon më lehtë goditjet".

### Zbardhet relacioni i projektligjit

## Shtyhet me dy vjet afati për bonot e privatizimit



Qeveria shqiptare ndërmori shtyrjen e afatit ligjor të vlefshmërisë së bonove të privatizimit deri në fund të vitit 2020. Kjo është shtyrja e 7 e afatit të përdorimit të tyre. Në nismën e depozituar në Kuvend, qeveria jep arsyet duke shpjeguar domosdoshmërinë e marrjes së një vendimi të tillë. "Meqenëse në procesin e privatizimit të pronës shtetërore vazhdon të mos jenë përfshirë ende një numër i konsiderueshëm objektesh, kryesisht në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural apo dhe të organeve të pushtetit vendor etj., si dhe duke gjykuar se shumë prej këtyre objekteve shtrihen në pronat e ish-pronarëve të njohur apo kthyer me vendime të kthimit dhe kompensimit të pronave, mendohet se duhet të vazhdojnë lehtësirat për ish-pronarët, duke e likuiduar një pjesë të vlerës së këtyre objekteve në rast parablerjeje me bono privatizimi (lekë privatizimi). Llogaritja e aksioneve për punonjësit në shoqëritë aksionare, ku punonjësit e këtyre shoqërive përfitojnë aksione në këmbim të bonove të privatizimit e bën të domosdoshme shtyrjen e afatit të përdorimit të bonove të privatizimit (lekë privatizimi)", - thuhet në relacion. "Përdorimi i bonove të privatizimit dhe i lekëve të privatizimit në procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje nëpërmjet ALUIZNI-t, ndërkohë që ky proces është në vazhdimësi dhe vazhdojnë të jenë në proces legalizimi një numër i konsiderueshëm objektesh apo banesash, gjykohet se edhe ky proces e bën të domosdoshëm shtyrjen e afatit të përdorimit të bonove të privatizimit dhe lekëve të privatizimit", shkruhet në relacion. Më tej, relacioni evidenton se gjatë tri viteve të fundit, në procesin e privatizimit të pronës shtetërore me të drejtën e parablerjes për ish-pronarët e truallit dhe për subjektet me kontratë enfiteoze apo qiraje, rezulton të jenë arkëtuar rreth 705 000 000 lekë bono privatizimi.

## SIGURIMI VULLNETAR
### PËRFITIMET

ISSH: Si mund të merrni më shumë të ardhura, kufijtë e pagesës që mund të kryeni

# Sigurimi vullnetar, ja çfarë mund të përfitojnë pensionistët

*"Rritjet e masës së pensionit, zbritjet për parapagimet"*

Voltiza Duro




Të gjithë pensionistët që nuk i kanë plotë suar vitet e përcaktuara të punës me kontribute mund të aplikojnë sigurimin vullnetar, në mënyrë që të marrin pension apo masë më të lartë të tij. "Gazeta Shqiptare" publikon sot kriteret që duhet të përmbushin të interesuarit për këtë lloj sigurimi, ku në skemë përfshihen shtetasit shqiptarë që jetojnë në Shqipëri si dhe shqiptarët që jetojnë jashtë vendit.

**KRITERET**

Në skemën e sigurimit vullnetar përfshihen të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe akoma nuk u ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sigurimit të detyruar. Ata që për një kohë dhe shkaqe të caktuara nuk mund të sigurohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm, si dhe personat që janë të siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm dhe kërkojnë që nëpërmjet sigurimit vullnetar të rrisin të ardhurat e tyre. Sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore, edhe personat që nuk janë pjesëmarrës në skemën e të vetëpunësuarve në bujqësi ose në rastet kur individi i interesuar ka lënë shtetësinë shqiptare, mund të bëjë sigurim vullnetar vetëm për periudhën nga 1.1.1994 deri në datën që ka lënë shtetësinë shqiptare.

"Personi që ka paguar kontribut për sigurim vullnetar, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në Ligjin nr. 7703, është përfitues, sipas rastit, i: pensionit të plotë të pleqërisë, pensionit të pjesshëm të pleqërisë, pensionit të reduktuar të pleqërisë, pensionit të invaliditetit, pensionit të pjesshëm të invaliditetit", - thekson ISSH.

Ndërkaq, në sigurimin vullnetar, sipas ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", bën pjesë edhe pensioni familjar. Kontributi vullnetar llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe paguhet nga personi i siguruar në shumën dhe afatin e përcaktuar në kontratën e sigurimit vullnetar. Nëpërmjet sigurimit vullnetar mbulohen katër fusha të kësaj skeme që janë: sigurim vullnetar për vitin korrent, sigurim vullnetar për periudha të kaluara, sigurim vullnetar për më shumë të ardhura si dhe sigurim vullnetar për degët e tjera të sigurimit.



**SIGURIMI VULLNETAR PËR MË SHUMË TË ARDHURA**

Ky sigurim bëhet vetëm për vitin korrent në kufijtë e pagave minimale dhe maksimale, 24 000 dhe 105 850 lekë (qytetari ka të drejtë të zgjedhë një pagë brenda këtij kufiri).

**Sa duhet të paguhet për sigurim vullnetar për më shumë të ardhura?**

- Personat e vetëpunësuar sigurohen me pagë minimale mujore 24 000 lekë. Mbi këtë pagë çdo person ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e pagës maksimale 105 850 lekë.
- Punëmarrësit që sigurohen në bazë të kontratës së nënshkruar me punëdhënësin kanë të drejtë të sigurohen vullnetarisht për më shumë të ardhura mbi pagën që ata marrin deri në nivelin e pagës maksimale 105 850 lekë.
- Çdo punëdhënës që sigurohet nën nivelin e pagës maksimale ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e kësaj page.
- Çdo kontribuues vullnetar për vitin korrent ka të drejtë të sigurohet për më shumë të ardhura.

**ZBRITJET**

Nëse do të parapaguani për vitin në vijim në fillim të periudhave, do të ketë zbritje: - 6% mbi shumën për një pagesë vjetore - 3% mbi shumën për një pagesë 6-mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 6-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar); - 1.5% mbi shumën për një pagesë 3 mujore, - theksohet në faqen zyrtare të ISSH-së.

**SIGURIM VULLNETAR PËR VITIN KORRENT**

Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën me dije se masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurimin vullnetar për vitin korrent nga personi i interesuar është e barabartë me masën që paguhet për degën e pensioneve, sipas pagës minimale të miratuar në periudhën kur bëhet pagesa. "Kuota mujore e sigurimit vullnetar për vitin 2017 është 5 184 lekë, që i korrespondon pagës minimale mujore: 24 000 lekë x 21.6%. Për pagesat paradhënie, aplikohen zbritje në varësi të kohës kur kryhet pagesa. Kështu, nëse do të parapaguani për vitin në vijim në fillim të periudhave, do të ketë zbritje: - 6% mbi shumën për një pagesë vjetore (me kusht që pagesat të realizohen brenda muajit janar); - 3% mbi shumën për një pagesë 6-mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 6-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar); - 1.5% mbi shumën për një pagesë 3 mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 3-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar)", - theksohet në faqen zyrtare të ISSH-së. Gjithsesi, pagesat e vitit korrent mund të bëhen edhe me shumëfishin e kuotës minimale mujore, 5 184 lekë, deri në kufi të pagës maksimale.

**SIGURIM VULLNETAR PËR PERIUDHA TË KALUARA**

Sigurimin vullnetar për periudhat e kaluara mund ta paguajnë të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe që nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar si dhe shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhën e studimeve universitare, pasi periudha pasunivesitare është me pagesë. Ndërkohë, ky sigurim për periudhat e kaluara mund të bëhet edhe nga shtetasit shqiptarë, që kanë periudha të pambuluara nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm dhe dëshirojnë t'i plotësojnë ato nëpërmjet sigurimit vullnetar si dhe personat që kanë lënë shtetësinë. Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për periudhat e kaluara përcaktohet nga koha kur bëhet pagesa. Pagesa aktuale për të mbuluar periudha të kaluara bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 5 184 lekë për një muaj sigurim vullnetar, por në këto pagesa nuk aplikohen zbritje.

**SIGURIM VULLNETAR PËR MË SHUMË TË ARDHURA**

Sigurim vullnetar për më shumë të ardhura mund të paguajnë të gjithë personat ekonomikisht aktivë të vetëpunësuar, të punësuar dhe punëdhënësit, të cilët duhet të jenë të siguruar si të tillë në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Ky sigurim bëhet vetëm për vitin korrent në kufijtë e pagave minimale dhe maksimale, 24 000 dhe 105 850 lekë (qytetari ka të drejtë të zgjedhë një pagë brenda këtij kufiri). ISSH bën me dije se personat e vetëpunësuar sigurohen me pagë minimale mujore 24 000 lekë e mbi këtë pagë çdo person ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e pagës maksimale 105 850 lekë. Ndërkohë, punëmarrësit që sigurohen në bazë të kontratës të nënshkruar me punëdhënësin kanë të drejtë të sigurohen vullnetarisht për më shumë të ardhura mbi pagën që ata marrin deri në nivelin e pagës maksimale 105 850 lekë. Çdo punëdhënës që sigurohet nën nivelin e pagës maksimale ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e kësaj page, ndërsa çdo kontribuues vullnetar për vitin korrent ka të drejtë të sigurohet për më shumë të ardhura.

**SIGURIM VULLNETAR PËR DEGËT E TJERA TË SIGURIMIT**

Sigurim vullnetar për degë të tjera sigurimi mund të bëjnë të vetëpunësuarit, që nuk mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm. Ky sigurim bëhet nga të vetëpunësuarit vetëm për vitin korrent. Periudha e përfitimit për paaftësi të përkohshme në punë fillon në ditën e 15 të raportit mjekësor dhe zgjat jo më shumë se 6 muaj nga data e fillimit të pagesës. Pagesat e kontributeve për këto degë bëhen sipas afateve të përcaktuara për pagesat e sigurimit të detyrueshëm (çdo tremujor), vetëm për vitin korrent.



Voltiza Duro

### Shembuj konkretë, sa është masa që duhet të paguani çdo muaj, si bëhet llogaritja

# Si të merrni pension kur keni më pak se 15 vite punë

## "ISSH: Ja si bëhet pagesa e sigurimit vullnetar

Për të përfituar një pension të plotë, të moshuarit duhet të plotësojnë dy kushte kryesore, që janë mosha dhe vjetërsia në punë. Kjo kategori mund të sigurohet për vitet e mbetura për të marrë përfitim të pjesshëm apo të plotë, sipas rastit. Aktualisht ka shumë shtetas që janë në prag përfitimi, por që u mungojnë 1 ose disa vite sigurimi. Në këto kushte, edhe periudhat e mbuluara humbasin. "Mjafton që personat t'i mbulojnë me sigurim vullnetar këto vite të munguara e të plotësojnë deri në 15 vjet sigurime për të përfituar një pension të pjesshëm. Shumë persona mund ta kenë plotësuar vjetërsinë për 15 vjet pune për të marrë një pension të pjesshëm, por është më me interes të plotësojnë 35 vjet pune për të marrë një pension të plotë pleqërie", - thekson ISSH. Edhe këta individë mund "të blejnë vitet e punës" menjëherë për t'u shtuar vitet e siguruara. Për të gjithë emigrantët, me interes do të ishte edhe njohja me vazhdimësinë e sigurimit vullnetar, duke paguar kontribute çdo vit. Është në interes të të gjithë personave, që skema iu ofron këtë shërbim të njihen me mundësinë e pagesave dyfish, trefish, deri në pesëfish të kontributit minimal, sipas mundësive financiare për të përfituar deri në pension maksimal të pleqërisë.

### PAGESA E SIGURIMIT VULLNETAR

Personi i interesuar paraqitet në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore të vendit ku ai banon dhe merr kontakt me inspektorin e sigurimit vullnetar. Ai duhet të ketë me vete këto dokumente: fotokopje të librezës së punës, ku pasqyrohen periudhat e sigurimit; fotokopje të librezës së kontributeve, në rast se e disponon; fotokopje të letërnjoftimit elektronik/kartës së identitetit. Nëse personi i interesuar bie dakord për t'u siguruar vullnetarisht, do të marrë dokumentin tip "Urdhër veprimi", i cili plotësohet nga inspektori i sigurimit vullnetar të Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore.

### SHEMBUJ KONKRETË

Një person që është në prag të mbushjes së moshës, ose e ka mbushur moshën që të jetë në kushte përfitimi, minimalisht duhet të ketë 15 vjet periudhë kontribuuese të siguruar. Në rast se personi ka 12 vjet periudhë kontribuuese, ka të drejtë të plotësojë 15 vitet e nevojshme, duke blerë 3 vjet sigurim nëpërmjet skemës vullnetare. Masa e kontributit që do të paguhet nga shtetasi do të jetë e barabartë me pagesën aktuale mujore për sigurim vullnetar, e cila aplikohet e tillë për gjithë periudhën trevjeçare. Masa kontribuuese që do të derdhë qytetari për këtë periudhë është 5 184 lekë për një muaj. Në rastin kur qytetari nuk e ka mbushur moshën, ai mund të blejë periudhë kontribuuese sa të dëshirojë. Në rastet kur blihen periudha të kaluara, nuk aplikohet zbritje. Ndërkohë, nëse një qytetar i datëlindjes 1949 i ka shkëputur marrëdhëniet e punës në 30.09.2006. Gjithsej ka 32 vite e 6 muaj vjetërsi pune. Sa duhet të paguajë për të përfituar një pension të plotë pleqërie? Në përgjigje të pyetjes së qytetarit sqarojmë se për të përfituar një pension të plotë pleqërie duhen 35 vite sigurim, pra atij i nevojiten edhe 2 vite e 6 muaj për ta përfituar këtë pension. Nëse personi, duke filluar pas datës 30.09.2006 e në vazhdim ka periudha të pambuluara me sigurim, atëherë ai mund të bëjë sigurim vullnetar për këtë periudhë duke paguar: 30 muaj * 4,752 lekë/muaj = 142,560 lekë.

### EMIGRANTËT JASHTË SHQIPËRISË

- Nëse qytetari ka 13 vite e 3 muaj të siguruara, atëherë atij i duhen edhe 1 vit e 9 muaj të bëjë sigurim vullnetar për të përfituar pension të pjesshëm.
- Nëse qytetari do të plotësojë vitet për pension të plotë pleqërie, atij duhen edhe 21 vite e 9 muaj për të siguruar.
- Duke qenë se qytetari nuk ka librezë pune, ai duhet të drejtohet pranë zyrave të arkivës në DRSSH, ku ai ka gjendjen civile për të marrë prej andej dokumentin e duhur.
- Për të marrë pension të pjesshëm, nëse do të mbulojë periudha të kaluara me sigurim vullnetar, ai duhet të paguajë me masën aktuale të sigurimit vullnetar, që është në fuqi 4,752 lekë për një muaj, kështu që 21 muaj* 4,752 lekë /muaj = 99,792 lekë gjithsej.
- Nëse ai dëshiron të plotësojë 35 vite për një pension të plotë pleqërie, atëherë ka të drejtë të mbulojë me sigurim vullnetar me masën aktuale nga 01.10.1993, të gjitha vitet deri sa të plotësojë vjetërsinë e nevojshme. Vazhdimi i sigurimit mund të bëhet duke parapaguar për vitin korrent, duke përfituar kështu dhe zbritjet përkatëse.


bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT
implemented by giz

OPEN CALL FOR TENDER

PREQUALIFICATION

1. GENERAL CONDITIONS

1.1. **Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej, No. 21/1.
1.2. **Profile:** German Development Cooperation, Office in Tirana supports Albania on its path to European integration and development through projects implemented in : Economic development, Economic legal reform, Vocational education and training, Reform of the water sector, Rural development, and some other areas.
1.3 **Subject:** The GIZ Office Tirana invites qualified design companies to "Provide Design Stabilisation (Composting) Plant at Vumblo Transfer Station, Himara Municipality.

2. **Companies should fulfill the following requirements:**

2.1 The Companies have to be licensed as an engineering designer.
2.2 The Companies have to be experienced in the designing of the common design works.
2.3 The Companies have to fulfill the complete design and cost estimated for the future civil works of construction.

All legal entities interested in application process should ask for an application form to the address: giz-albanien@giz.de

3. The **due date** for submitting the application is **25 May 2018**. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification of Design Stabilisation (Composting) Plant at Vumblo Transfer Station, Himara Municipality", addressed to:

**German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana,**
**Rr. Skenderbeg, No. 21/1**
**Tirane**

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.



EPSA enforcement private service

**SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"**
**SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:**

1. **Are** me nr.33/26, e ndodhur ne Karpen, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099,vol.11, fq.202, me sip.2,000 m2, cmimi që do të shitet është **3.548.664** lekë.
2. **Are** dhe truall me **nr.1/88**, e ndodhur ne Qerret, Kavaje, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.9, fq.34, me sip.1,770 m2 cmimi që do të shitet është **8.793.590** lekë.
3. **Are** me nr.33/27, e ndodhur ne Karpen. Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099, vol.1, fq.203, me sip.4,050 m2 cmimi që do të shitet është **7.186.045** lekë.
4. **Are** me nr.70/9, e ndodhur ne Qerret, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.2, fq.106, me sip.6,460 m2 cmimi që do të shitet është **4.584.875** lekë.
5. **Njësi** me nr.15/22+1-N1 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 14/69, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.116 m2 vlerësohet me vlerën e **9.056.191** lekë.
6. **Njësi** me nr.15/22+1-N2 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 14/70, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.91 m2 vlerësohet me vlerën e **7.104.426** lekë.
7. **Njësi** me nr.15/22+1-N3 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551,nr.rregjistri hipotekor 15/71, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.95 m2 vlerësohet me vlerën e **7.416.708** lekë.
8. **Njësi** me nr.15/22+1-N4 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551,nr.rregjistri hipotekor 15/72, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.211 m2 vlerësohet me vlerën e **16.472.899** lekë.
9. **Bodrum** me nr.15/22+1-B e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 130/176, vl.2005-2007, datë 24.09.2007 me sip.609 m2 vlerësohet me vlerën e **13.261.358** lekë.Te gjitha pasurite e sipërcituara jane hipotekuar në favor te **Banka Raiffeisen sha.** Prsh Casa Nostra.

Ankandi zhvillohet ne **datë 11.06.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane. Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

Çfarë duhet të keni parasysh para intervistës, dokumentacioni që kërkohet

# Lotaria Amerikane, ambasada: Plotësoni formularin DS-260

## *Afati i fundit kur mund të shpalleni fitues*

**PERZGJEDHJA**

Ndërkohë më tej ekspertët e ambasadës bëjnë me dije se aplikuesit duhet ta kontrollojnë statusin e tyre nga 15 maji 2018 deri më 30 shtator 2019. Kontrolli i Statusit të të Regjistruarit do të jetë e vetmja mënyrë informimi mbi përzgjedhjen për Lotarinë DV-2019, duke dhënë udhëzime se si aplikantët të vazhdojnë më tej me aplikimin

Voltiza Duro

Duke filluar nga 15 maji i këtij viti, të gjithë ata që aplikuan për Lotarinë Amerikane mund të kontrollojnë nëse janë përzgjedhur fitues për DV-2019. Ditën e djeshme ambasada amerikane në Tiranë ka njoftuar se kandidatët fitues duhet të ndjekin të gjitha udhëzimet e së pari, të bëjnë online plotësimin e formularit DS-260. “Urime të përzgjedhurve të programit të lotarisë DV! Ju lutemi, sigurohuni që të ndiqni të gjitha udhëzimet tona përgjatë procesit të aplikimit. Hapi juaj në vazhdim është plotësimi i formularit DS-260 online tek https://ceac.state.gov/iv/”,-theksohet në njoftim. Ndërkohë më tej ekspertët e ambasadës bëjnë me dije se aplikuesit duhet ta kontrollojnë statusin e tyre nga 15 maji 2018 deri më 30 shtator 2019. Kontrolli i Statusit të të Regjistruarit do të jetë e vetmja mënyrë informimi mbi përzgjedhjen për Lotarinë DV-2019, duke dhënë udhëzime se si aplikantët të vazhdojnë më tej me aplikimin dhe duke njoftuar mbi takimin për vizë emigrimi. Nëse kandidatët rezultojnë të përzgjedhur, duhet të vazhdojnë me plotësimin e formularit DS-260.

Për të parë nëse jane përzgjedhur, të regjistruarit e DV-2019 do të mund të përdorin numrin e tyre unik të konfirmimit të dhënë në regjistrim duke kontrolluar online Kontrollin e Statusit të të Regjistruarve në faqen zyrtare të E-DV. Kontrolli i Statusit të Regjistruarve do të informojë pjesëmarrësit e përzgjedhur se si të aplikojnë për vizën e lotarisë për veten dhe anëtarët e tyre të familjes. Departamenti, gjithashtu, do t’u konfirmojë të përzgjedhurve datat e tyre të intervistave për vizë nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistruarve. Në rastet kur fituesi gjatë plotësimit të formularit DS-260 ka probleme pasi nuk i pranohet adresa e banesës aktuale, atëherë duhet të bëjë kujdes pasi, nëse nuk pranohet del një mesazh me ngjyrë të kuqe ku tregon se cila nga shenjat pranohet e cila jo.



Ambasada amerikane në Tiranë

**GARANCIA**

Nëse fituesi nuk e ka marrë akoma Garancinë Financiare dhe taksat nga sponsori në SHBA, ai mund t'i sjellë ato së bashku me vizitën mjekësore në ditën e intervistës. Dështimi për të siguruar qoftë edhe një nga dokumentet e kërkuara më poshtë do të rezultojë në moskryerjen e intervistës në ditën e caktuar dhe vonesa të gjata.

### INTERVISTA

Pasi Qendra Konsullore Kentucky (KÇ) të ketë njoftuar të përzgjedhurin për datën e takimit për intervistë, ai duhet të përgatisë dokumentacionin e kërkuar, të regjistrojë datën e takimit dhe t’i dërgojë dokumentet rreth dy javë përpara intervistës në Seksionin Konsullor të ambasadës amerikane në Tiranë me anë të një shërbimi postar të shpejtë. “Ju duhet të bëni çdo përpjekje që t’i dërgoni dokumentet e mëposhtme në Seksionin Konsullor me postë të shpejtë dy javë përpara datës suaj të takimit (duke përfshirë dëftesën origjinale të shkollës së mesme dhe vërtetim notash të lëshuar kohët e fundit e të përkthyer në Anglisht, si dhe diplomën e shkollës së lartë nëse e keni mbaruar)”,-thuhet në faqen zyrtare të Ambasadës Amerikane. Nëse fituesi nuk e ka marrë akoma Garancinë Financiare dhe taksat nga sponsori në SHBA, ai mund t’i sjellë ato së bashku me vizitën mjekësore në ditën e intervistës. Dështimi për të siguruar qoftë edhe një nga dokumentet e kërkuara më poshtë do të rezultojë në moskryerjen e intervistës në ditën e caktuar dhe vonesa të gjata. Një datë e re interviste do të caktohet vetëm pasi i përzgjedhuri për intervistë t’i ketë sjellë të gjitha dokumentet e kërkuara (nëse do të ketë numra vizash në dispozicion). Vizat në dispozicion të Lotarisë Amerikane (DV) janë subjekt i kufizimeve numerike. Aplikantët e Lotarisë, të cilët dëshirojnë të marrin vizë duhet të jenë të përgatitur që të veprojnë me shpejtësi duke i dorëzuar të gjitha dokumentet në ditën e intervistës. Nëse një aplikanti lotarie nuk i është lëshuar një vizë në muajin në të cilin atij i ishte caktuar intervista nga KÇ, vizat e vëna në dispozicion të aplikantëve të Lotarisë mund të mos jenë të garantuara për ta. Aplikantët që kërkojnë nga Seksioni Konsullor ricaktim të datës së intervistës së tyre në muaj të mëvonshëm rrezikojnë seriozisht shansin për të marrë vizë. Gjithashtu, aplikantët që paraqiten në intervistë pa i patur të gjitha dokumentet dhe formularët e kërkuar dhe që i dorëzojnë dokumentet e kërkuara në një muaj të mëvonshëm, mund të përballen me faktin që të mos ketë më numra vizash në dispozicion për ta. Numrat e vizave të Lotarisë DV për disa rajone dhe shtete mund të mbarojnë edhe më përpara afatit të fundit të Programit, pra përpara datës 30 Shtator.

### TARIFA E APLIKIMIT

“Ju do të kryeni pagesën në ditën e intervistës tek arkëtari i Seksionit Konsullor. Pagesa kryhet vetëm me para në dorë tek arkëtari i Konsullatës në dollarë amerikanë ose lekë dhe është e pakthyeshme. Duke filluar nga data 13 prill 2012, ju duhet të paguani 330 dollarë ose ekuivalentin në lekë për çdo person, pavarësisht nga mosha. Kjo pagesë kryhet vetëm tek arkëtari i Seksionit Konsullor të ambasadës amerikane në Tiranë.”-thotë ambasada amerikane. Këto tarifa janë subjekt i një ndryshimi të mundshëm me kohë, ndaj informacioni më i përditësuar për pagesën ndodhet në faqen e Internetit (në Anglisht) të Departamentit Amerikan të Shtetit Byrosë së Çështjeve Konsullore “Tarifat për Shërbimet e Vizave”. Pas intervistës me Oficerin Konsullor, nëse dosja është e plotë dhe aplikanti gjendet i kualifikuar, viza e tij do të lëshohet dhe do ti dërgohet së bashku me paketën e vizës me anë të shërbimit postar DHL në zyrën që fituesi ka zgjedhur kur u regjistrua për këtë shërbim.



EMBASSY OF THE UNITED STATES
TIRANA • ALBANIA

VIZAT E SHUMËLLOJSHMËRISË – (LOTARIA AMERIKANE)
[Dokumentacioni i Kërkuar për Aplikantët e Vizës së Shumëllojshmërisë]

LISTA E DOKUMENTACIONIT

Pasi Qendra Konsullore Kentucky (KCC) t'ju ketë njoftuar datën tuaj të takimit për intervistë, ju duhet të përgatisni dokumentet e mëposhtme, të regjistroni datën e takimit tuaj dhe t'i dërgoni dokumentet rreth dy javë përpara intervistës në Seksionin Konsullor të Ambasadës Amerikane në Tiranë me anë të një shërbimi postar të shpejtë.

**SHËNIM**: Ju duhet të bëni çdo përpjekje që t'i dërgoni dokumentet e mëposhtme në Seksionin Konsullor me postë të shpejtë dy javë përpara datës suaj të takimit (duke përfshirë **dëftesën origjinale të shkollës së mesme dhe vërtetim notash të lëshuar kohët e fundit e të përkthyer në Anglisht**, si dhe diplomën e shkollës së lartë nëse e keni mbaruar). Nëse ju nuk e keni marrë akoma Garancinë Financiare dhe taksat nga sponsori në SHBA, ju mund t'i sillni ato së bashku me vizitën mjekësore në ditën e intervistës. Dështimi për të siguruar qoftë edhe një nga dokumentet e kërkuara më poshtë do të rezultojë në moskryerjen e intervistës në ditën e caktuar dhe vonesa të gjata. Një datë e re interviste do të caktohet vetëm pasi t'i keni sjellë të gjitha dokumentet e kërkuara *(nëse do të ketë numra vizash në dispozicion)*.

Vizat në dispozicion të Lotarisë Amerikane (DV) janë subjekt i kufizimeve numerike. Aplikantët e Lotarisë të cilët dëshirojnë të marrin vizë duhet të jenë të përgatitur që të veprojnë me shpejtësi duke i dorëzuar të GJITHA dokumentet në ditën e intervistës. Nëse një aplikanti Lotarie nuk i është lëshuar një vizë në muajin në të cilin atij i ishte caktuar intervista nga KCC, vizat e vëna në dispozicion të aplikantëve të Lotarisë mund të mos jenë të garantuara për ta. Aplikantët që kërkojnë nga Seksioni Konsullor ricaktim të datës së intervistës së tyre në muaj të mëvonshëm rrezikojnë seriozisht shansin për të marrë vizë. Gjithashtu, aplikantët që paraqiten në intervistë pa i patur të gjitha dokumentet dhe formularët e kërkuar dhe që i dorëzojnë dokumentet e kërkuara në një muaj të mëvonshëm, mund të përballen me faktin që të mos ketë më numra vizash në dispozicion për ta. Numrat e vizave të Lotarisë DV për disa rajone dhe shtete mund të mbarojnë edhe më përpara afatit të fundit të Programit, pra përpara datës 30 Shtator.

**Dokumentacioni i Kërkuar:**

- [ ] **KËTË LISTË:** Vendosni një kryq (X) në kutinë përkatëse për secilin dokument që do të dorëzoni.
- [ ] Nëse zgjidhni t'i dërgoni dokumentet me DHL në Seksionin Konsullor, **tregojini një kopje të këtij udhëzimi agjentit të DHL-së që t'ju pranohet dërgimi i dokumentacionit nga DHL-ja.**
- [ ] **DËFTESA E PJEKURISË (Vetëm për aplikantin kryesor):**

**Aplikanti kryesor duhet të sjellë:**

- Dëftesën Origjinale të Shkollës së Mesme dhe një fotokopje të saj të përkthyer në anglisht; ose në mungesë të dëftesës së pjekurisë, vërtetim notash të përkthyer në anglisht dhe fotokopje të saj, ose vërtetim nga Arkivi i Shtetit të përkthyer në anglisht me lëndët e studiuara dhe fotokopje të saj;
- Për dëftesat e pjekurisë të shkollës së mesme të lëshuara përpara vitit 1990: sillni dëftesën origjinale **dhe vërtetim notash të lëshuar kohët e fundit** dhe një fotokopje të tij të përkthyer në anglisht; dhe
- Nëse keni kryer arsimin e lartë, përveç dëftesës së shkollës së mesme do të sillni edhe Diplomën e Shkollës së Lartë dhe një fotokopje e saj. Përkthimi dhe noterizimi i diplomës së shkollës së lartë kërkohet vetëm nëse keni kryer studimet jashtë

Faksimile e listës së dokumentave

> Ju duhet të paguani 330 dollarë ose ekuivalentin në lekë për çdo person, pavarësisht nga mosha. Kjo pagesë kryhet vetëm tek arkëtari i Seksionit Konsullor

Shoqëria përmbarimore **“STRATI BAILIFFS SERVICE” Sh.p.k.**, njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

-“Apartament”, me sipërfaqe 243.30 $m^2$, ndodhur në Fier, me Nr. 4/892+1-2 Pasurie, Zona Kadastrale 8533, volumi 22, faqe 228, rregjistruar në pronësi të Z. Adif Llakaj. Çmimi fillestar i ankandit është 54,880 Euro.
Ankandi për pasurinë e mësipërme zhvillohet në datë 23.05.2018.
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore “Strati Bailiff’s Service”, Rruga “Jordan Misja”, Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Shoqëria përmbarimore **“STRATI BAILIFFS SERVICE” Sh.p.k.**, njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

- Nr. Pasurie Nr. 6/36, Vol. 3, Faqe 137, Zona Kadastrale 1441, Arë me sipërfaqe 2400 m2, me vendndodhje ne Damjan - Tiranë, regjistruar në bashkëpronësi të Z. Ymer Tresa, Zj. Pranvera Tresa, Z. Florenc Tresa, Zj. Laerta Hakcani (Tresa). Çmimi fillestar i ankandit është 2.000.000 Lekë.
Ankandi për pasurinë e mësipërme zhvillohet në datë 23.05.2018.
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

**ZYRA PËRMBARIMORE PRIVATE ENIRJETA ZISI**

**Permbaruese gjyqesore private Enirjeta Zisi z**hvillon ankandin per shitjen e pasurise se paluajtshme "Apartamenti" me siperfaqe 92.1m2, ZK.3866, Nr.Pasurie.300/143+1-7,Vol.83,Fq.186,Indeksi i Hartes K-34-100, te ndodhur ne Tirane, Yzberisht prane rruges “Joklin Persi “, kati i 3 ,shk.1 ap.7 Tirane,per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit Yzeir Llanaj,

Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është ne shumen 4.778.400 (kater miljon e shtateqind e shtatedhjete e tete mije e katerqind) leke. e percaktuar ne vendimin gjyqesor.

**Ankandi zhvillohet ne date 20.04.2018, ora 16.00 ne zyren e Permbarueses gjyqesore private Enirjeta Zisi, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Pallati “Gora”Kulla.2,Kati i 2, Tirane Nr.Tel. 0694799000, email:enirjeta.zisi@gmail.com**

Vdekja e babait të 3 fëmijëve, policia: Në trup s'ka shenja dhune, ishte përdorues droge

# 27-vjeçari gjendet i vdekur në paraburgim, familjarët akuza policisë: E vratë në qeli

## "Djalin e dhunuan pas arrestimit në komisariat, ka shenja dhune në fytyrë dhe në kokë"

KORÇË

Një 27-vjeçar nga Korça, i cili ishte arrestuar katër ditë më parë për vjedhje me dhunë është gjetur i pajetë në ambientet e paraburgimit të këtij qyteti. Bëhet fjalë për Enea Ftojn, baba i tre fëmijëve. Mësohet se i riu pritej që dje do të dilte në sallën e gjyqit për t'u njohur me masën e sigurisë, ndërkohë që është gjetur i pajetë në qeli. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së këtij qarku bënë me dije se "Më datë 17.05.2018, jemi njoftuar se në dhomat e sigurisë në Komisariatin e Policisë Korçë ka vdekur shtetasi Enea Ftoj, i arrestuar në datë 14.05.2018, për veprën penale 'Vjedhja me dhunë'. Nga këqyerja e trupit nuk janë konstatuar shenja dhune dhe nga informacionet paraprake dyshohet se viktima ka qenë përdorues i lëndëve narkotike. U ngrit grupi hetimor nën drejtimin e prokurorit, për të përcaktuar shkaqet e vdekjes, si edhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale". Lajmi për vdekjen e 27-vjeçarit ka shokuar familjarët e tij, të cilët akuzojnë policinë se kanë ushtruar dhunë mbi djalin e tyre. Tejet të tronditur, ata kanë protestuar para komisariatit të policisë, duke kërkuar që të zbardhet sa më shpejt e vërteta e kësaj ngjarjeje. Ndryshe nga blutë që thanë se Ena Ftoj ishte përdorues i drogave të forta dhe se në trupin e tij nuk janë gjetur shenja dhune, të afërmit e viktimës u shprehën se ai është dhunuar pas arrestimit në flagrancë në pazarin e qytetit të Korçës (i ka vjedhur me dhunë varësen e floririt një qytetareje). "Policia la tre fëmijë jetimë, pasi u mbyti babain", pohuan pjesëtarë të familjes Ftoj. Pas reagimit të familjarëve, Prokuroria e Korçës ka nisur hetimet për zbardhjen e shkaqeve të vdekjes së Enea Ftojt brenda në qelitë e komisariatit. Mësohet se është caktuar një prokuror dhe dy oficerë të policisë gjyqësore për të vijuar hetimet dhe kryerjen e veprimeve të ngutshme procedurale. Gjithashtu, prokuroria ka sekuestruar kamerat e ambienteve të komisariatit dhe dhomave të sigurisë, ndërsa janë marrë në pyetje efektivët e policisë, që kanë qenë në detyrë gjatë mbrëmjes së të mërkurës dhe mëngjesin e të enjtes. Sakaq, ekspertiza mjeko-ligjore pritet të kryhet nga dy ekspertë, njëri i pavarur dhe një tjetër nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, e cila do të zbulojë shkakun e vdekjes se 27-vjeçarit Enea Ftoj.

**AKUZAT E FAMILJARËVE**

Detaje tronditëse janë publikuar pas ngjarjes së rëndë të ndodhur ditën e djeshme në qytetin e Korçës. Familjarët e 27-vjeçarit Enea Ftoj, i cili u gjet i vdekur në Komisariatin e Policisë në Korçë, kanë mundur të fotografojnë trupin e pajetë të djalit të tyre, i cili po i nënshtrohej autopsisë. Sapo kanë mësuar ngjarjen e rëndë, ata i janë drejtuar morgut të spitalit të Korçës, në pritje të përgjigjes së ekspertizës. Në foton që kanë mundur të sigurojnë familjarët e viktimës, dallohen shenja dhunë në fytyrën dhe kokën e të riut. Shenja të dukshme dhune vërehen në pjesën e syrit dhe mbi vetull. Ndërkohë që një shenjë tjetër dallohet në pjesën e kafkës. Gjithashtu, familjaret e thanë që policia nuk i kishte njoftuar për vdekjen e Eneas. "Ne kemi folur në telefon me Enean dhe ai na tha që ishte në gjendje të rënduar shëndetësore. Na e vrau djalin policia. Nuk ishte i sëmurë, ishte përdorues heroine, policia na tha që ishte mirë. Njoftimin për vdekjen e tij e morëm nga gjykata sot (dje), pasi ishte seanca për masën e sigurisë", u shprehën ata.



27- vjeçari Enea Ftoj




Shenjat e dhunës në kokën e të riut

**ARRESTIMI**

Të martën në një njoftim për mediat, policia e Korçës tha se e kishte arrestuar 27-vjeçarin Enea Ftojn "pasi më datë 14.05.2018, ky shtetas në lagjen nr. 17 në Korçë, i ka vjedhur me dhunë varësen e floririt shtetases F.L, 60 vjeçe, banuese në Korçë". Pas vdekjes së babait të tre fëmijëve, është caktuar një prokuror dhe dy oficerë të policisë gjyqësore për të vijuar hetimet dhe kryerjen e veprimeve të ngutshme procedurale.

**AKUZAT**

Lajmi për vdekjen e 27-vjeçarit ka shokuar familjarët e tij, të cilët akuzojnë policinë se kanë ushtruar dhunë mbi djalin e tyre. Tejet të tronditur ata kanë protestuar para komisariatit të policisë, duke kërkuar që të zbardhet sa më shpejt e vërteta e kësaj ngjarjeje. Ndryshe nga blutë që thanë se Ena Ftoj ishte përdorues i drogave të forta dhe se në trupin e tij nuk janë gjetur shenja dhune, të afërmit e viktimës u shprehën se ai është dhunuar pas arrestimit në flagrancë në pazarin e qytetit të Korçës (i ka vjedhur me dhunë varësen e floririt një qytetareje).

**DHUNA**

Sapo kanë mësuar ngjarjen e rëndë, ata i janë drejtuar morgut të spitalit të Korçës, në pritje të përgjigjes së ekspertizës. Në foton që kanë mundur të sigurojnë familjarët e viktimës, dallohen shenja dhunë në fytyrën dhe kokën e të riut. Shenja të dukshme dhune vërehen në pjesën e syrit dhe mbi vetull, ndërkohë që një shenjë tjetër dallohet në pjesën e kafkës.



**EKSPERTIZA**

Prokuroria ka sekuestruar kamerat e ambienteve të komisariatit dhe dhomave të sigurisë, ndërsa janë marrë në pyetje efektivët e policisë, që kanë qenë në detyrë gjatë mbrëmjes së të mërkurës dhe mëngjesin e të enjtes. Sakaq, ekspertiza mjeko-ligjore pritet të kryhet nga dy ekspertë, njëri i pavarur dhe një tjetër nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, e cila do të zbulojë shkakun e vdekjes se 27-vjeçarit Enea Ftoj.



## Goditi makinën e policisë dhe ishte në arrest shtëpie, kapet duke lëvizur me armë

**ELBASAN** - Një 36-vjeçar, i cili ishte lënë në "Arrest shtëpie" nga Gjykata e Krimeve të Rënda u arrestua mbrëmjen e së mërkurës nga policia e Elbasanit, pasi iu gjet një pistoletë pa leje dhe 15 fishekë. Bëhet fjalë për Kelmend Xhaferrin, që u kap në lagjen "5 Maj" të këtij qyteti. Xhaferri është një nga personat që u arrestua më 18 shtator të vitit të kaluar pas incidentit të rëndë me policinë te tregu agroushqimor në lagjen "Dyli Haxhire", ku u godit nga një automjet i blinduar makina e Gjergji Oshafit, zv.drejtorit të Policisë së Elbasanit. Ai ishte personi që drejtonte makinën luksoze "Ranger Rover" me targa AA 040 OJ me vlerë 100.000 euro, bllokimi i së cilës u bë shkas për përplasjen me policinë. Po ashtu, rreth 7 muaj më parë, gjatë kontrollit të banesës së ushtruar nga efektivat e policisë, grupi hetimor ka gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një pushkë sportive pa leje. Ai akuzohet për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive".

**XHAFERRI**

Xhaferri është një nga personat që u arrestua më 18 shtator të vitit të kaluar pas incidentit të rëndë me policinë te tregu agroushqimor në lagjen "Dyli Haxhire"

### Policia e Kurbinit nuk bëri asgjë për djalin tim

# Zhdukja e tregtarit të perdeve, nëna: E ka vrarë shoku i tij për lekët e kazinosë



29-vjeçari i zhdukur, Fatjon Fejzillari

**TIRANË** - Që prej 20 ditësh djali i saj është zhdukur pa lënë gjurmë. Nëna e Fatjon Fejzillarit, i cili ka humbur kontaktet me familjen që prej 29 prillit në Laç, është bërë dje pjesë e emisionit 'Me zemër të hapur' në 'Neës24', Fatime Fejzillari tregoi se si e mori vesh lajmin për zhdukjen e djalit të saj, i cili kishte shkuar bashkë me shokun e tij, Aleksandër Fadili në Laç për të shitur perde. Teksa bëri një kronologji të ngjarjes në fjalë, bazuar edhe tek dëshmitë e banorëve të asaj zone, nëna e të riut të zhdukur lëshon akuza të forta për shokun e djalit të saj. Ajo dyshon se dy të rinjtë mund të jenë zënë për lekët që mund të kenë lënë në kazino e më pas Aleksandri e ka vrarë. Ky i fundit u ndalua dy ditë më parë nga policia e Kurbinit, pasi dyshohet se mund të ketë lidhje me zhdukjen e 29-vjeçarit.

"Me djalin fola dy ditë më parë, por shumë pak. Shoku i tij më tha se djali im i kishte xhaxhait të tij 1 milion lekë, por kjo nuk është e vërtetë, pasi ia kishte dhënë lekët. Më datë 22 prill djali ka ikur, në datë 27 kam folur. Në datë 30 më erdhi lajmi se ai ishte zhdukur. Më telefonoi xhaxhai i Aleksandrit për lajmin. Ai më tha që të merrja në telefon nusen e djalit tim që ta pyesja, pasi Aleksandri (shoku i tij) ishte në polici. Aleksandri nuk më njoftoi. Ai thotë se ishin ndarë me Fatjonin afër spitalit të Laçit. Policia nuk më ka ndihmuar, kurse unë kam bërë kërkime me shokët e tij. Kemi shkuar nga Peqini në Laç. Ata ishin ndarë në Laç, pasi do shisnin veç e veç. Ai tregoi se në orën 20:00 të darkës, ata duhej të takoheshin, por djali im nuk kishte shkuar. Kam pyetur shumë persona për djalin, por më thanë se e kishin parë në orën 11:00. Pasi më solli ato perdet në shtëpi, e mori makinën e djalit dhe e çoi në lavazho e lau. Policia e Kurbinit nuk bëri asgjë për djalin tim, nuk e kërkuan. Mendoj se ata janë zënë me njëri-tjetrin, pasi mund të kenë luajtur në kazino, sepse luanin shpesh. Pas orës 15:00 ai nuk u bë më i gjallë. Ata të dy ishin shokë që prej 15 vitesh. Dyshimin e kam tek Aleksandri, pasi pretendonte se lekët ia ka dhënë Fatjonit. Pse mos të shkonte në polici 2-3 orë në vonë, por priti disa orë më vonë. Pse lajmëroi vetëm njerëzit e vet, dhe mua jo. Telefonin e djalit tim e kishte Aleksandri. Ai telefon ishte i saktë",-tha nëna e dëshpëruar.

### Historia e "Monalizës" nga Manëza, ja si e mashtroi 30-vjeçarin Barush Ahmeti

# I zhvati 60 mln lekë drejtorit të postës, prokuroria kërkon 5 vjet burg për 27-vjeçaren

## *Enertila Beqja përdorte 30 profile në 'Facebook' me foto modelesh e artistesh, i premtoi dhe martesë*

Klodjana Haxhiaj

**DURRES**

Prokuroria e Durrësit ka kërkuar dënimin me 5 vite burg për Enertila Beqjan, e cila akuzohet se përmes mashtrimit i zhvati 6 milionë lekë të reja përgjegjësit të postës në Manëz. Në seancën e djeshme që u zhvillua në Gjykatën e Shkallës së Parë të Durrësit ishin të pranishëm prindërit e 27-vjeçares, të cilët gjatë gjithë kohës kanë kërkuar lirimin e vajzës së tyre të vetme. Gjatë fjalës së tij, prokurori i çështjes, Drini Pali tha se nga ana e organit të akuzës janë marrë parasysh disa fakte, duke nisur nga rrezikshmëria e personit, gjendja ekonomike e sociale dhe fakti që nuk ka shprehur pendesë dhe nuk e ka pranuar fillimisht ngjarjen. "Kërkojmë pesë vjet heqje lirie, por me aplikimin e uljes së 1/3 së vendimit me pranimin e fajit të dënohet 3.4 vjet heqje lirie", tha Pali. Sipas, tij, hetimet për këtë ngjarje kanë zgjatur 7 muaj dhe u konstatua se vajza nga Manza kishte përdorur 30 profile në 'Facebook' me foto artistësh dhe modelesh të huaja. Kështu ajo arriti që t'i prishë mendjen përgjegjësit të postës së Manëzës, Barush Ahmatit, duke i premtuar martesë me të. Ajo arriti të përfitojë prej tij të mira materiale si veshje, materiale ndërtimi, elektroshtëpiake etj. me vlerë 6 milionë lekë (të rinj). Ndërkaq, avokatja mbrojtëse i kërkoi gjykatës të thirret në gjyq edhe Barush Ahmati, i cili e denoncoi 27-vjeçaren për zhvatje me anë të mashtrimit të 6 milionë lekëve. Gjykatësi i çështjes, Petraq Curri e hodhi poshtë kërkesën e mbrojtjes, duke thënë se Ahmati pas marrjes në pyetje nga gjykatësi ka thënë se nuk ka dëshirë të paraqitet në sallën e gjyqit. "Mbetet në dëshirë të tij dhe aspak me urdhër gjykate",-tha relatori Curri. Pritet që në seancën e radhës të jepet edhe vendimi për 27-vjeçaren, e cila në internet përdorte mbi 30 adresa 'Facebook' dhe kishte shfaqur personalitete të shumëfishta dhe herë pretendonte se do lindte një fëmijë, e herë që do martohej në muajin gusht.



Enertila Beqja, në gjykatën e Durrësit



Një nga profilet e Beqjas në 'Facebook'

**MASHTRIMI**

Në shtator të vitit që shkoi, "GSH" ishte në shtëpinë e familjes Beqja në Manëz. Në dhomën e saj u gjet dhe një fustan nusërie i sapo blerë, një krevat fëmije dhe rrobat e një bebeje mashkull. 27-vjeçarja pretendonte se ishte shtatzënë dhe do të martohej me Alban Stafën, personazhi imagjinar i saj, për të cilin foli edhe në gjykatë pas arrestimit. Enertila Beqja i paraqitej drejtorit të postës, Barush Ahmati në 'Facebook' me emrin Elona Gjoka dhe me këtë profil i ka zhvatur për një periudhë gati tri-vjeçare shumën e madhe të lekëve dhe të dhuratave. Në atë kohë, prokuroria deklaroi se disponontе prova e fakte që prej vitit 2015-2017 ku profili me emrin Elona Gjoka kishte zënë miqësi me Barush Ahmetin. Pasi zuri miqësi më 30-vjeçarin, ajo i tha që ishte nga Manëza dhe jetonte me familjen në Milano të Italisë. Fillimisht Elona (Enertila Beqja) i kërkoi Barushit një palë kolltukë që t'ia çonte tezes në fshatin Manëz, meqë ishte në gjendje të keqe ekonomike. Barushi në celularin e tij si provë për prokurorinë ka paraqitur foto nga kolltukët si dhe faturën e tyre. Më pas vijuan dhuratat me blerjen e dy televizorëve plazmë, aparat dixhitalbi, lavastovilje, sobë druri, pistës vrapit për palestër, bizhuteri të florinjta nga më të ndryshmet, dy ipohne 6 dhe 7 plus. Dhurata këto të cilat ishin të fotografuara dhe të dërguara tek adresa me emrin Elona Gjoka, ku kjo e fundit jepte aprovimin nëse i duheshin ato dhurata me atë x stil apo dhe ngjyrën përkatëse dhe nuk nguronte që të referonte se çfarë i pëlqente. Ndërkohë, një dhuratë ishte blerja e motorit dhe targimi në emër të Myrteza Beqjas, babait të vajzës. Sipas organit të akuzës, Enertila i kishte dërguar me "Facebook" fotografinë e kartës së identitetit të Myrezajt dhe Barushi, i cili pasi kishte blerë motorin e kishte targuar dhe regjistruar në emër të babait të saj. Vajza pretendonte se ishte e fejuar me një person në Itali, ndërsa edhe në rrjetet sociale mbante mbiemrin e tij. Po kështu Enertila Beqja kishte krijuar një rreth familjar të imagjinar me bashkëshortin e ardhshëm imagjinar, një rrjet shoqëror po kështu imagjinar, për të cilin kishte hapur edhe adresat false në 'Facebook', e për më tepër të gjitha menaxhoheshin prej saj dhe komentoheshin po prej saj në çdo rast.

### Tentuan të përdhunojnë 13-vjeçaren, gjykata lë në burg 3 të rinjtë

**FIER** - Gjykata e Fierit dje ka vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj tre të rinjve, të cilët tri ditë më parë tentuan të përdhunojnë një 13-vjeçare në një shtëpi në ndërtim e sipër, në fshatin Arapaj të Roskovecit. Fatmirësisht, e mitura shpëtoi nga duart e rrëmbyesve, falë ndihmës së prindërve të saj. Tre të arrestuarit janë: Redion Tereziu, 22 vjeç, Jorges Dosti, 24 vjeç nga fshati Arapaj dhe Redion Tereziu e Marjus Çalameni, 24 vjeç, banues në fshatin Vlosh, Roskovec. Ndërkohë, dje të afërm të Çalamenit thanë se djali i tyre është i pafajshëm. Ndërsa babai i Marjusit u shpreh në gjykatë se djali ka qenë në punë. "Djali im ka qenë në punë, i kanë marrë biçikletën dhe i kanë thënë hajde merre pikërisht pranë shtëpisë ku ishin dy djemtë e tjerë dhe vajza. Ka dëshmitarë që djali im ka qenë në punë. Është ngritur fshati për të folur se djali im nuk ka lidhje me ngjarjen," tha Izet Çalameni në Gjykatën e Fierit.

Mogherini bën të mundur takimin e krerëve të Serbisë e Kosovës në Sofje

# Samiti BE-Ballkani Perëndimor, Thaçi: Asnjë nga palët s'do të fitojë

## Vuçiç: Askush s'po e kërcënon vendin tim e as mua

Ditën e djeshme në Sofje të Bullgarisë është zhvilluar samiti BE-Ballkani Perëndimor. Pritet që BE t'u japë një shtytje proceseve integruese, por samitin e ka komplikuar refuzimi i Spanjës që të ulet në një tavolinë me krerët e Kosovës. Kosova po prezantohet në këtë samit nga presidenti i vendit, Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj dhe ministri i Jashtëm Behgjet Pacolli, ndërsa delegacionin e Shqipërisë e prin kryeministri Edi Rama. Vëmendjen kryesore e ka zgjuar raporti mes Kosovës dhe Serbisë si dhe refuzimi i kryeministrit të Spanjës, Rajoy, që të ulet në një tavolinë me krerët e Kosovës. Presidenti Hashim Thaçi është takuar dje në Sofje me ndërmjetësimin e përfaqësueses së BE, Federica Mogherini me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiç.

**ALEKSANDËR VUÇIÇ**
"Askush nuk po e kërcënon Serbinë e as mua. Ka pasur presion ndaj Serbisë për pesë vite, sepse Perëndimi po e dëshiron pavarësinë e Kosovës. Ne nuk e duam. A na obligon kjo? Jo. A është pozita jonë e lehtë? Jo. Nëse do të pranoja diçka që do t'i përshtatej opinionit serb, do të dilja para popullit, por kam pranuar vetëm shenja", tha Vuçiç.


Samiti BE - Ballkani Perëndimor

**INSISTIMET PËR MARRËVESHJE TË SHPEJTË**

Autoritetet ndërkombëtare evropiane, por edhe amerikane kanë intensifikuar kohët e fundit angazhimet për një marrëveshje të shpejtë për normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë. Presidenti Vuçiç dhe ai Thaçi flasin se marrëveshja përfundimtare do të jetë e "dhimbshme për të dyja palët", pra për Kosovën dhe Serbinë, por asnjëri prej tyre ende nuk e ka konfirmuar se cilat janë kërkesat konkrete të autoriteteve ndërkombëtare dhe cilat janë ato elemente të dhimbshme me të cilat do të përballen palët. Presidenti Thaçi tha se Kosova do të paraqitet në këtë samit e barabartë me shtetet e tjera pjesëmarrëse. Por, për shkak të Kosovës do të përdoret modeli 'Gimnih', sipas të cilit pjesëmarrësit nuk do të kenë simbole të shtetit. Kështu të paktën kanë paralajmëruar organizatorët, pra Bullgaria si kryesuese e radhës e KE, por edhe autoritetet e tjera, të cilat kanë përgatitur draftin e deklaratës përfundimtare. Në këtë deklaratë thuhet se të gjitha 28 vendet e tanishme të BE, pra edhe Britania e Madhe, e mbështesin perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Por mësohet se në dokument evitohet të përmendet anëtarësimi i këtyre vendeve në BE apo zgjerimi i BE-së. Dokumenti përfundimtar ku flitet për ndërlidhje dhe partneritet duhet të miratohet në fund të samitit. Merret vesh se edhe Spanja do të mbështetë dokumentin, ndonëse nuk do të ketë përfaqësuesit e saj në takim.

**FALËNDERIMET PËR BORISOVIN**

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka falënderuar jo vetëm autoritetet evropiane, por edhe kryeministrin e Bullgarisë, Boiko Borisov për përkushtimin e tij që Kosova të marrë pjesë në këtë samit, njëjtë sikur shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. "Me këtë pjesëmarrje Kosova e fuqizon subjektivitetin e vet evropian", thotë Thaçi. Refuzimin e pjesëmarrjes së Spanjës në samit, ai e sheh si pasojë të çështjeve të brendshme të pazgjidhura në këtë vend. Ndërsa sa u përket raporteve me Serbinë, ai tha se pret që këto të zgjidhen brenda nëntë muajve, kur mund të arrihet një marrëveshje historike". Por ky moment kërkon, sipas tij, një mobilizim të të gjitha forcave politike për gjetjen e zgjidhjes më të mirë për Kosovën.

**HASHIM THAÇI**
"Me këtë pjesëmarrje Kosova e fuqizon subjektivitetin e vet evropian. Për sa u përket raporteve me Serbinë, pres që këto të zgjidhen brenda nëntë muajve, kur mund të arrihet një marrëveshje historike" thotë presidenti Thaçi.

**SERBIA NUK ËSHTË E KËRCËNUAR**

Presidenti i Serbisë tha se vendi i tij është nën presion, por askush nuk mund ta cenojë atë. "Askush nuk po e kërcënon Serbinë e as mua. Ka pasur presion ndaj Serbisë për pesë vite, sepse Perëndimi po e dëshiron pavarësinë e Kosovës. Ne nuk e duam. A na obligon kjo? Jo. A është pozita jonë e lehtë? Jo. Nëse do të pranoja diçka që do t'i përshtatej opinionit serb, do të dilja para popullit, por kam pranuar vetëm shenja", tha Vuçiç. "Ne kemi një plan të caktuar, por nuk jam i kënaqur me detaje të caktuara. Jemi në kërkim të një zgjidhjeje kompromisi që kërkon marrjen në konsideratë të interesave të serbëve në Kosovë, por edhe të Republikës së Kosovës", ka përfunduar ai.

**VAZHDIMI I DIALOGUT**

Në takimin e mbajtur me ndërmjetësimin e Mogherinit, presidentët Thaçi dhe Vuçiç kanë rënë dakord që të vazhdojnë dialogun, të cilin kërkojnë shtetet e BE por edhe SHBA. Ky dialog po futet në fazën përfundimtare, kur palët duhet të nënshkruajnë edhe një marrëveshje të obligueshme juridike, për normalizimin e raporteve. Presidenti i Serbisë, Vuçiç ka përsëritur shumë herë kohët e fundit se Serbia nuk mund të jetë humbësi i vetëm i këtij dialogu dhe se ai do të insistojë në mbrojtjen e interesave të shtetit të tij. Ndërkohë që edhe Thaçi tha se "procesi nuk do të jetë i lehtë për Kosovën, por as për Serbinë" dhe se "nuk do të ketë fitore 100% për askënd".

---

Zaev e Cipras takohen në Sofje, ja ç'pritet të ndodhë

## Hahn: Optimist se Maqedonia dhe Greqia do ta zgjidhin çështjen e emrit

Ditën e djeshme ka nisur edhe samiti i Sofjes, ku ndër të tjera është bërë takimi midis kryeministrit Zoran Zaev dhe homologut të tij grek Aleksis Cipras, ku në fokus të bisedimeve është çështja e emrit. Palët e përfshira në këtë proces thanë se dialogu po zhvillohet rreth vazhdimit të procesit, duke tentuar që të përafrojnë qëndrimet në raport me çështjet kontestuese si dhe çështjet e hapura për të cilat më shumë kërkesa ka pala greke. Takimi mes Zaev dhe Cipras është paralajmëruar si tejet i rëndësishëm dhe kyç në procesin e gjetjes së zgjidhjes finale për emrin. Nga ana tjetër, komisioneri europian për Zgjerimin dhe Fqinjësinë e Mirë, Johannes Hahn në kuadër të samitit BE-Ballkani Perëndimor, shfaqi optimizëm se Maqedonia dhe Greqia do ta zgjidhnin kontestin për emrin. Por, ai nuk dëshiroi të japë parashikime për kornizën kohore eventuale. "Gjithmonë jam optimist. Dhe do të mbetem optimist. Të dy kryeministrat janë në rrugë të mbarë", tha Hahn duke komentuar takimin midis kryeministrave Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras. Lidhur me mundësinë që zgjidhja të gjendet deri në samitin e qershorit të BE-së, ai tha se deri atëherë ka një muaj dhe se gjithçka është e mundur.

**JOHANNES HAHN**
"Gjithmonë jam optimist dhe do të mbetem i tillë. Të dy kryeministrat janë në rrugë të mbarë. Për sa i përket zgjidhjes së emrit të Maqedonisë, deri në samitin e qershorit ka një muaj kohë dhe gjithçka është e mundur", tha Hahn.

---

SHKURT

### Tmerr në Pakistan, donte të martohej i nxjerrin sytë me lugë

Një ngjarje e tmerrshme ka ndodhur në Pakistan ku një djali që donte të martohej me vajzën që dashuronte, i janë nxjerrë sytë me lugë nga babai dhe vëllezërit e tij. Abdul Baqi nga fshati Nasirabad në Pakistan i kërkoi familjes së tij që të shkonin për t'i kërkuar dorën për fejesë të dashurës së tij. Por kërkesa 'tërboi' babin e tij 70-vjeçar, Dost Muhammadin dhe katër vëllezërit, Abdul Ghani, Abdul Sattar, Abdul Rehman e Abdul Karim. Ata e mbyllën 22-vjeçarin në një dhomë dhe i nxorën sytë. Gjithashtu mbyllën edhe nënën e tij në një dhomë tjetër që ajo të mos kishte mundësi për të ndërhyrë. Më pas me anë të një luge dhe thike kryen aktin e tmerrshëm. Abdul Baqi është shtruar në spital. Fqinjët informuan disa prej vëllezërve të 22-vjeçarit pas incidentit, të cilët e dërguan në spital. Mjekët thanë se ai kurrë nuk do të jetë në gjendje të shohë përsëri. Incidenti është raportuar në polici. Babai i tij dhe dy prej vëllezërve janë arrestuar. Ndërsa dy vëllezërit e tjerë janë ende në arrati, raportojnë mediat lokale.

### Konflikti në Gaza, përplasen presidentët Erdogan e Netanyahu

Konflikti në Rripin e Gazës mes palestinezëve dhe ushtrisë izraelite, që shkaktoi mbi 60 viktima dhe rreth 2700 të plagosur provokoi një përplasje të fortë mes Benjamin Netanjahut dhe Rexhep Taip Erdoanit. Presidenti turk akuzoi Netanjahun se është kryeministri i një shteti racist dhe represiv që ka pushtuar për më shumë se 60 vjet tokën e njerëzve të pambrojtur. "Ai i ka duart të mbushura me gjakun e palestinezëve", sulmoi Erdoan. E menjëhershme ishte kundërpërgjigja e kryeministrit izraelit, që tha se nuk pranon moral nga presidenti turk. "Si një mbështetës i madh i Hamasit, Erdoan e kupton shumë mirë se çfarë është terrorizmi", tha Netanjahu. Erdoan thirri një samit të jashtëzakonshëm të organizatës së vendeve islamike, ku bën pjesë edhe Shqipëria, për të mbajtur në bllok një qëndrim kundër Izraelit. Presidenti turk paralajmëroi se nuk do të lejojë kurrë që Jerusalemi t'u vidhet palestinezëve. Dy ditë më parë, Turqia ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Izraelin, duke urdhëruar largimin e ambasadorit të këtij vendi. Ankaraja fajësoi Kombet e Bashkuara se kanë dështuar në parandalimin e masakrës në Gaza dhe SHBA-të se kanë humbur rolin e ndërmjetësuesit në Lindjen e Mesme.

Përfituesit duhet të dorëzojnë dokumentet për të marrë 20% të vlerës së pronës në para dhe 80% kompensim fizik

# ATP: Lista me 1800 dosjet e vitit '98, vlerësimi për çdo pronar

## Pronarët, gjashtë muaj kohë për të plotësuar dokumentet

Agjencia e Trajtimit të Pronat ka vlerësim et financiare për ish-pronarët që kanë dorëzuar kërkesën për kompensim në vitin 1998. Agjencia bën të ditur se në përfundim të procesit të verifikimit të vendimeve të administruara pranë arkivës së ATP-së, u identifikuan rreth 1800 vendime të vitit 1998, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, vlerësimi financiar përkatës apo mangësitë në dokumentacion dhe problematikat në vlerësim jepen të detajuara për çdo dosje.

**APLIKIMI PËR KOMPENSIM**

Pronarët që janë dakord me vlerësimin e ATP-së kanë gjashtë muaj kohë për të plotësuar dokumentet. Përfituesit duhet të dorëzojnë në ATP nëntë dokumente për të marrë 20% të vlerës së pronës në para dhe 80% kompensim fizik. Shifrat janë bërë të ditura nga burime zyrtare pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave, sipas të cilave mësohet se të gjithë pronarët, për dosjet e të cilëve është dhënë një vlerësim duhet të paraqiten në 'Agjenci' për të dorëzuar kërkesën për kompensim, konfirmimin nga ZVRPP përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës, që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablerjes (nëse është njohur në vendim); dëshmi trashëgimie, prokurë, deklaratë noteriale e nënshkruar nga subjekti i shpronësuar, vërtetim për numrin e llogarisë bankare, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Ndërkohë, pronarët që nuk janë dakord me vlerësimin duhet që brenda 30 ditëve nga data e publikimit të listës të ankimojnë vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit.

**DOKUMENTET**

1. Kërkesë për kompensim.
2. Konfirmimin nga ZVRPP përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablerjes (nëse është njohur në vendim).
3. Dëshmi trashëgimie nëse ka ndryshuar rrethi i trashëgimtarëve.
4. Prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare në emër të tyre.
5. Deklaratë noteriale të nënshkruar nga subjekti i shpronësuar/përfaqësuesi me prokurë i të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar, përmes së cilës subjektet vetëdeklarojnë nëse vendimi përfundimtar i kompensimit apo vlerësimi i tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore, si dhe nëse këto subjekte kanë qenë apo jo të paditur apo persona të tretë në proceset, për të cilët ata aplikojnë për kompensim, janë kundërshtuar apo jo gjyqësisht nga ana e tyre, si dhe nëse këto subjekte kanë qenë të paditur apo persona të tretë në proceset gjyqësore me objekt ankimin e vendimit për të cilin ata aplikojnë.
6. Vërtetim për numrin e llogarisë bankare.
7. Dokument identifikimi.
8. Mandatpagese.



Formulari-tip

| Nr/ Dosje | Data/ Dosje | Qarku | Emri (*Subjekti Kerkues*) | Atesia | Mbiemri (*Subjekti Kerkues*) | VLERESIMI | SHENIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 97 | 01-01-1998 | Kukës | Ahmet Sadri Jakupi | | | | |
| 119 | 18-10-1996 | Shkodër | Kole Gjergji | | | | 0 |
| 109 | 28-06-1996 | Shkodër | Prenge Gjergj Gjeta | | | | 0 |
| 18 | 01-01-1901 | Shkodër | Halit Dini | | | | 109,528 |
| 969 | 30-07-1998 | Fier | Vangjel Gjini | | | | 3,674,659 |
| 29 | 23-12-1994 | Fier | Agushe Shperdheja | | | | 1,053,593 |
| 98 | 01-01-1996 | Elbasan | KIMETE REXHEPI | | | | 741,967 |
| 106 | 28-06-1996 | Durrës | Ismail Daci | | | | 661,999 |
| 129 | 21-08-1996 | Durrës | | | | | |
| 116 | 28-06-1996 | Durrës | Shyqyri Veseli | | | | 1,315,698 |
| 175 | 22-03-1994 | Durrës | Idriz Vogli | | | | 40,110 |
| 177 | 22-03-1994 | Durrës | Hasan Meta(Hoxha) | | | | -2,962,989 |
| 443 | 01-01-1996 | Elbasan | DILAVER SHPATA | | | | 84,445 |
| 102 | 01-01-1994 | Elbasan | MERSIN KOKONOZI | | | | |
| 61 | 01-01-1998 | Kukës | Ibish Shpend Ponari | | | | 286,418 |
| 64 | 28-04-1998 | Berat | Polikseni Staver Taçi | | | | 1,841,578 |
| 12Q | 03-08-1998 | Shkodër | Kisha Provinca Franceskane Shqipetare | | | | 8,715,264 |
| 11 | 10-05-1998 | Berat | Shaban Polovina | | | | 73,880 |
| 123 | 03-08-1998 | Berat | Vajvara Goxhomani(Lako) | | | | 168,890 |
| 110 | 17-06-1998 | Berat | Dhimitër Laçka | | | | 363,540 |
| 114 | 26-06-1998 | Berat | Kostaq Vito | | | | 719,895 |
| 124 | 03-08-1998 | Berat | Fatmir Neshat Zhopi | | | | 2,918,027 |
| 22 | 01-01-1998 | Berat | Idajet Nazmi Qalliu | | | | |
| 298 | 31-08-1994 | Durrës | Dylaver Qesja | | | | |
| 18 | 22-06-1998 | Berat | Vangjel Pambuku | | | | 1,002,083 |
| 261 | 18-08-1994 | Durrës | Hava Godina | | | | |
| 227 | 01-01-1996 | Korçë | Petro Luarasi | | | | 505,326 |
| 64 | 01-01-1996 | Korçë | Feta Ypi | | | | 2,053,740 |
| 307 | 01-01-1996 | Korçë | Hysen Shaka | | | | 337,781 |
| 321 | 20-07-1998 | Korçë | Jani Papandile | | | | 1,914,795 |
| 254 | 20-01-1995 | Berat | Xhevahir Karemani | | | | 617,388 |
| 254 | 20-01-1995 | Berat | Xhevahir Karemani | | | | 1,251,040 |
| 255 | 28-06-1997 | Berat | | | | | 394,781 |
| 255 | 28-06-1997 | Berat | | | | | |
| 256 | 12-03-1996 | Berat | Haki Sanxhaku | | | | 5,302,408 |
| 166 | 01-01-1996 | Gjirokastër | Afroviti Shana | | | | 795,036 |
| 53 | 01-01-1901 | Gjirokastër | Apostol Adhami | | | | 207,829 |
| 250 | 01-01-1996 | Gjirokastër | Foti Jani | | | | 98,895 |
| 301 | 01-01-1996 | Gjirokastër | Sabri Rapo | | | | 113,360 |
| 49 | 01-01-1901 | Gjirokastër | Ylmi Mersini | | | | 242,389 |
| 172 | 01-01-1996 | Gjirokastër | Kleanthi Naçe | | | | 75,625 |
| 72 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Elefteri Ballabani | | | | 397,141 |
| 3 | 01-01-1994 | Gjirokastër | Kalam Teta | | | | 505,889 |
| 18 | 01-01-1995 | Gjirokastër | Niko Zhaka | | | | 43,474 |
| 73 | 01-01-1996 | Gjirokastër | Adhurim Male | | | | 5,824,000 |
| 259 | 01-01-1996 | Gjirokastër | Mahide Sado | | | | 727,167 |
| 344 | 01-01-1996 | Gjirokastër | Shpresa Morreku | | | | 2,766,049 |
| 31 | 01-01-1901 | Gjirokastër | Ibrahim Abazi | | | | 416,909 |
| 22 | 01-01-1901 | Gjirokastër | Vangjeli Thomollari | | | | 280,396 |
| 164 | 01-01-1996 | Gjirokastër | Kolica Ballabani | | | | 35,292 |
| 253 | 12-03-1997 | Durrës | Dhimitër Beshiri | | | | 512,109 |
| 881 | 05-04-1994 | Durrës | Ibrahim Gustina | | | | |
| 830 | 28-03-1994 | Durrës | Nexhmedin Kau | | | | 5,824,312 |
| 29 | 01-01-1996 | Fier | Astrit Dinaj | | | | 918,342 |
| 22(7) | 26-12-1997 | Berat | Sazan Hysni Behari | | | | 1,492,316 |
| 125 | 10-08-1998 | Berat | Hekuran Abas Sulejmani | | | | 2,530,072 |
| 126 | 12-08-1998 | Berat | | | | | 2,672,079 |
| 127 | 11-08-1998 | Berat | Xhemil Hekuran Jahollari | | | | 503,200 |
| 90 | 30-04-1998 | Berat | Ëngjëllushe Maska | | | | 1,606,423 |
| 135 | 18-08-1995 | Lezhë | Albert Marku | | | | 4,017,192 |
| 60 | 23-05-1996 | Lezhë | Sandër Mark Skandaj | | | | |
| 149 | 01-01-1996 | Elbasan | FATOS PALLUQI | | | | 3,504,476 |
| 97 | 18-09-1996 | Lezhë | Seit Kolaj | | | | 373,367 |
| 163 | 02-07-1996 | Lezhë | Preng Geg Nikolli | | | | 1,882,815 |
| 84 | 01-01-1996 | Berat | Refat Oboni | | | | 2,686,233 |
| 86 | 01-01-1996 | Berat | Faik Oboni | | | | 1,316,407 |
| 514 | 05-02-1996 | Shkodër | Ndue Ndoc Curri | | | | |
| 1101 | 22-08-1994 | Shkodër | Berhan Pacrami | | | | 7,149,240 |
| 914 | 01-01-1901 | Fier | Lili Ikonomi | | | | 2,863,662 |
| 134 | 01-01-1996 | Korçë | Ferdan Mema | | | | 1,967,307 |
| 28 | 15-02-1996 | Shkodër | Sali Brucaj | | | | 1,904,708 |
| 91 | 01-01-1998 | Vlorë | Hekuran Besho | | | | -11,901,000 |
| 485 | 01-01-1998 | Vlorë | Kostandin Koço | | | | 53,334 |
| 5184 | 30-12-2014 | Gjirokastër | Bekim Zace | | | | -3,748,000 |
| 268 | 01-01-1996 | Korçë | Margarita Angjo | | | | 136,135 |
| 198 | 26-09-1996 | Korçë | Petraq Pojanaku | | | | |
| 55 | 01-01-1996 | Korçë | Joan Ilo | | | | 52,863 |
| 350 | 31-08-1994 | Korçë | Sotiraq Mile | | | | 103,386 |
| 84 | 22-06-1996 | Korçë | Durim Çorbaxhi | | | | 156,912 |
| 64 | 01-01-1901 | Lezhë | Javer Hoti | | | | 10,287,375 |
| 401 | 28-06-1996 | Tiranë | Hafsa Cara | | | | 1,383,447 |
| 39 | 01-01-1997 | Korçë | Spiro Bice | | | | 194,734 |
| 82 | 28-08-1998 | Dibër | ZENEL SPAHIU | | | | |
| 42 | 06-12-1995 | Dibër | PRENG TOSKU | | | | 4,239,531 |
| 318 | 27-08-1998 | Dibër | Lirim Llanaj | | | | 886,675 |
| 44 | 31-08-1994 | Elbasan | AGIM HOXHA | | | | 1,040,365 |
| 516 | 31-08-1998 | Elbasan | SELMAN MERZHEKU | | | | 783,151 |
| 368 | 31-08-1994 | Elbasan | | | | | 715,595 |
| 532 | 31-08-1994 | Elbasan | SERVET MATO | | | | 150,125 |
| 40 | 01-01-1993 | Fier | Rrapo Hazizaj | | | | 487,859 |
| 45 | 01-01-1996 | Fier | Dine hazizaj | | | | 1,100,954 |
| 43 | 01-01-1998 | Fier | Rapo Hazizaj | | | | 750,624 |
| 1813 (13 | 18-05-1998 | Durrës | Liri Palloshka | | | | |
| 257 | 21-05-1994 | Berat | ISMAIL ZENOLLARI | | | | 713,792 |
| 257 | 21-05-1994 | Berat | ISMAIL ZENOLLARI | | | | 3,699,603 |
| 259 | 10-04-1996 | Berat | Astrit Fejzo | | | | 305,140 |
| 258 | 04-04-1997 | Berat | | | | | 32,996 |
| 43 | 01-01-1999 | Kukës | Zoje Zeqir Mulaj | | | | 581,084 |
| 81 | 01-01-1998 | Kukës | Sherif Mustaf Rrustemaj | | | | 18,474 |
| 61 | 01-01-1998 | Kukës | Ibish Shpend Ponari | | | | 285,220 |
| 61 | 01-01-1998 | Kukës | Ibish Shpend Ponari | | | | 184,949 |
| 61 | 01-01-1998 | Kukës | Ibish Shpend Ponari | | | | 252,232 |
| 61 | 01-01-1998 | Kukës | Ibish Shpend Ponari | | | | 38,414 |
| 61 | 01-01-1998 | Kukës | Ibish Shpend Ponari | | | | 285,220 |
| 61 | 01-01-1998 | Kukës | Ibish Shpend Ponari | | | | 252,232 |
| 15 | 24-01-1996 | Shkodër | Ymer Velia | | | | 1,316,441 |
| 422 | 26-09-1996 | Shkodër | Dan Hasani | | | | 519,054 |
| 517 | 01-07-1998 | Shkodër | Pjeter Prelush Preka | | | | |
| 485 | 06-10-1996 | Shkodër | Palok Marku | | | | 3,953,948 |
| 435 | 27-09-1996 | Shkodër | Ulan Aga Dedia | | | | 1,001,358 |
| 131 | 27-08-1998 | Berat | Hyda Abedin Mançe | | | | 3,038,187 |
| 107 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Faik Haki Veizi | | | | 227,464 |
| 106 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Zana Beqiri | | | | 2,317,013 |
| 128 | 20-08-1998 | Berat | Tomorr Thoma Kumaraku | | | | 1,794,306 |
| 129 | 24-08-1998 | Berat | Lili Kristo Koraqe | | | | 863,240 |
| 258 | 27-06-1996 | Shkodër | Ujkan Smajl Bruci | | | | 1,294,860 |
| 937 | 05-04-1994 | Durrës | Xhavit Rama | | | | 10,871,211 |
| 261 | 15-03-1996 | Berat | | | | | 345,296 |
| 261 | 15-03-1996 | Berat | | | | | 353,774 |
| 260 | 16-06-1995 | Berat | Qerim Gogo | | | | 20,810 |
| 39 | 12-08-1996 | Dibër | ALEKSANDER BODINI | | | | 856,827 |
| 205 | 12-07-1996 | Berat | Hetem Duçellari | | | | 380,381 |
| 434 | 25-06-1996 | Korçë | Skender Avdyllari | | | | 981,370 |
| 436 | 26-06-1996 | Korçë | Nasi Strati | | | | 627,915 |
| 1614 | 27-02-1997 | Korçë | Spiro Orgocka | | | | 550,000 |
| 236 | 03-04-1996 | Korçë | Pandeli Mano | | | | 1,081,208 |
| 98 | 01-01-1993 | Tiranë | ZYDI SARAÇI | | | | 237,237 |
| 80 | 18-03-1996 | Tiranë | FETAH KRUTANI | | | | |
| 79 | 15-02-1996 | Tiranë | MYRJE SHEHI | | | | 1,786,629 |
| 295 | 01-01-1901 | Korçë | Dhimitra Nikolla | | | | 587,890 |
| 205 | 25-03-1996 | Korçë | Muarem Keci | | | | 19,987 |
| 270 | 25-04-1996 | Korçë | Elsa Postoli | | | | 220,126 |
| 430 | 25-06-1996 | Korçë | Ilo Kuneshka | | | | 768,308 |
| 229 | 02-04-1996 | Korçë | Mamudi Plasa | | | | 80,929 |
| 266 | 22-04-1996 | Korçë | Lumturie Mullaymeri | | | | 844,412 |
| 514 | 28-06-1996 | Korçë | Nuri Toska | | | | 235,110 |
| 269 | 01-01-1996 | Gjirokastër | Avdul Zaimi | | | | 1,180,001 |
| 110 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Hajri Cacaj | | | | 2,803,989 |
| 109 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Foto Kapaj | | | | 2,892,625 |
| 204 | 01-01-1996 | Durrës | Shaqir Alushi | | | | |
| 256 | 01-04-1998 | Durrës | Bihane Llaftiu | | | | 1,610,250 |
| 1711 | 08-11-1996 | Durrës | Bejte Mesuti | | | | |
| 108 | 01-01-1901 | Gjirokastër | Hito Lopaj | | | | 282,856 |
| 739 | 20-10-1993 | Elbasan | | | | | |
| 723 | 10-09-1993 | Elbasan | ISUF KOCI | | | | |
| 116 | 19-01-1996 | Berat | Ibrahim Haznedari | | | | 1,022,970 |
| 386 | 20-06-1996 | Korçë | Ymerli Nurçelli | | | | 4,760,000 |
| 392 | 21-06-1996 | Korçë | Dhimitraq Postoli | | | | 1,261,308 |
| 388 | 20-06-1996 | Korçë | Ali Kodra | | | | 388,805 |
| 395 | 21-06-1996 | Korçë | Rexhep Kodra | | | | 1,675,000 |
| 394 | 21-06-1996 | Korçë | Xhafer Qose | | | | 1,363,434 |
| 384 | 20-06-1996 | Korçë | Bashkim Islami | | | | 361,588 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1477 | 20-03-1996 | Korçë | | 1,530,000 |
| 1335 | 13-12-1994 | Korçë | Hysni Cenolli | 680,000 |
| 387 | 20-06-1996 | Korçë | Nikoleta Zguro | 2,571,686 |
| 1578 | 19-06-1998 | Korçë | Shaban Demirllari | -76,500 |
| 86 | 01-01-1995 | Tiranë | HYSEN , EMINE ÇEKA | |
| 171 | 11-03-1996 | Tiranë | SHIRE DOMA | 1,128,378 |
| 65/14 | 01-01-1998 | Vlorë | Vasil dhe Filip Mërkuri | |
| 36 | 01-01-1998 | Fier | Shahin Muça | 31,668,000 |
| 57 | 01-01-1998 | Fier | Behar Dybeli | 18,200,000 |
| 38 | 01-01-1998 | Fier | Vangjel Ndoni | 6,521,055 |
| 35 | 01-01-1998 | Fier | Ylvi Lecini | 25,480,000 |
| 80 | 01-01-1998 | Fier | Agim Rredhi | 13,880,048 |
| 111 | 01-01-1998 | Gjirokastër | | 179,785 |
| 113 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Kastriot Agaraj | 9,925,719 |
| 112 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Llukan Kuri | 230,994 |
| 114 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Sulo HYSENI | 4,296,623 |
| 82 | 01-01-1998 | Kukës | Sabrie Mustaf Haxhiaj | 27,076 |
| 37 | 01-01-1998 | Fier | Rita Nko | 40,768,000 |
| 195/1 (48 | 19-06-1995 | Shkodër | Sabri Shah Abdullai | 0 |
| 84 | 01-01-1994 | Durrës | Petrit Koçi | -754,884 |
| 490 | 30-08-1994 | Elbasan | SEFEDIN TRUNGU | 71,230 |
| 263 | 26-02-1996 | Berat | Hysen Keli | 1,144,564 |
| 265 | 22-04-1997 | Berat | Qerim Hoxha | 44,395 |
| 265 | 22-04-1997 | Berat | Qerim Hoxha | 1,621,530 |
| 163 | 18-06-1996 | Berat | Islam Levenishti | 2,872,431 |
| 163 | 18-06-1996 | Berat | Islam Levenishti | |
| 224 | 01-01-1996 | Korçë | Bukurije Zeka | |
| 11 | 01-01-1998 | Korçë | | 0 |
| 22 | 01-01-1994 | Korçë | Bardhyl Filip Papajani | 7,941,687 |
| 76 | 24-03-1994 | Lezhë | Shyqyri Todhja | 1,148,985 |
| 115 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Shyqyri Veizaj | 8,902,163 |
| 117 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Salin Manaj | 412,875 |
| 6 | 20-10-1993 | Lezhë | Hasan Myrteza Dema | 4,851,270 |
| 323 | 07-12-1996 | Durrës | Idriz Kuta | 191,220 |
| 116 | 01-01-1901 | Gjirokastër | Ylli Likaj | 187,323 |
| 68 | 27-06-1996 | Durrës | Shefqet Ajazi | 4,126,762 |
| 171 | 12-08-1998 | Durrës | | 669,011 |
| 225 | 13-06-1994 | Durrës | Rexhep Hoxha | -10,167,337 |
| 118 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Halim Shehaj | 2,011,349 |
| 119 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Zilo Balili | 291,374 |
| 398 | 21-06-1996 | Korçë | Koço Ropi | 750,479 |
| 399 | 21-06-1996 | Korçë | Mbarime Koshena | 334,506 |
| 638 | 28-06-1996 | Korçë | KOSTIKA CYFEKU | 944,414 |
| 643 | 28-06-1996 | Korçë | | 57,344 |
| 967 | 07-08-1998 | Korçë | Ilia Teneqexhiu | 0 |
| 22 | 08-01-2009 | Korçë | Vangjel andoni | -40,339,600 |
| 1454 | 28-08-1996 | Korçë | | -29,479,500 |
| 127 | 28-12-1994 | Lezhë | Vicens Pjeter Cali | 216,581 |
| 123 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Cane Lamaj | 274,295 |
| 66 | 01-01-1996 | Fier | Muco Shehu | 916,163 |
| 95 | 01-01-1996 | Fier | Luan Nuhaj | 1,316,874 |
| 124 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Myftar Sefer Mati | 313,387 |
| 121 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Hano Mullaraj | 107,042 |
| 122 | 01-01-1998 | Gjirokastër | | 3,855,285 |
| 176 | 18-01-1996 | Lezhë | Ndrek Prendi | 1,065,485 |
| 235 | 17-04-1998 | Lezhë | Leonard Biba | 2,577,388 |
| 277 | 31-08-1994 | Elbasan | Demir Kala | |
| 65/15 | 01-01-1998 | Vlorë | Kadri Xhafa | |
| 125 | 01-01-1996 | Berat | Qerime Hasani | 372,735 |
| 103 | 01-01-1901 | Gjirokastër | Stefanaq Joanidhi | 70,342 |
| 7 | 01-01-1994 | Gjirokastër | Nonda Buxhuku | 669,011 |
| 264 | 01-01-1996 | Gjirokastër | Luan Lushnja | 160,880 |
| 242 | 01-01-1996 | Gjirokastër | Dhimitraq Shyti | 448,885 |
| 127 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Muhamet Llaka | 2,809,230 |
| 125 | 01-01-1998 | Gjirokastër | | 439,636 |
| 126 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Mehmet Rexhaj | 12,768,000 |
| 200 | 01-01-1996 | Durrës | Emin Gjeci | 3,167,996 |
| 205 | 25-04-1996 | Lezhë | Bardhok Gega | 710,000 |
| 156/a | 01-01-1993 | Gjirokastër | Areti Pananjoti | |
| 270/A | 01-01-1994 | Gjirokastër | Eftalia Cabeli | |
| 294 | 01-01-1993 | Gjirokastër | Vadit Shupo | |
| 207 | 01-01-1993 | Gjirokastër | Hiqmet Xheko | |
| 130 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Daut Dautaj | 300,274 |
| 132 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Shaze Barjamaj | 203,042 |
| 131 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Refat Qazim Lamaj | 324,105 |
| 129 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Tefik Hyseni | 2,171,565 |
| 5197 | 30-12-2014 | Gjirokastër | Andrea Mati | 4,316,000 |
| 39 | 12-01-1994 | Lezhë | Ilvi Dervishi | 1,009,575 |
| 717 | 13-09-1996 | Korçë | Robert Ngjela | 131,456 |
| 408 | 24-06-1996 | Korçë | Kosta Kovaçi | 356,217 |
| 404 | 24-06-1996 | Korçë | Ollga Gjoni | 504,841 |
| 1429 | 30-07-1996 | Korçë | | -17,211,000 |
| 1502 | 25-09-1996 | Korçë | | -13,420,750 |
| 409 | 24-06-1996 | Korçë | Koci Prifti | 405,942 |
| 415 | 25-06-1996 | Korçë | Hasan Kodra | 3,837,416 |
| 505 | 28-06-1996 | Korçë | Sotiraq Mato | 56,503 |
| 407 | 24-06-1996 | Korçë | Vançi Marko | 1,258,534 |
| 135 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Myrto BARKAJ | 2,075,625 |
| 134 | 01-01-1998 | Gjirokastër | | 720,565 |
| 133 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Bato Kananaj | 972,776 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1133 | 01-01-1996 | Vlorë | Shezai Kondaj | 219,248 |
| 1165 | 01-01-1996 | Vlorë | Kostandin Sadikaj | 399,412 |
| 449 | 01-01-1996 | Vlorë | Qemal Çobani | 6,297,594 |
| 215 | 01-01-1996 | Vlorë | Avni Veshi | 276,443 |
| 425 | 07-06-1996 | Vlorë | Delo Meçaj | 84,839 |
| 104 | 01-01-1996 | Vlorë | Daut Shtino | 5,539,766 |
| 545 | 01-01-1996 | Vlorë | Llazi Rungaja | 2,818,330 |
| 544 | 01-01-1996 | Vlorë | Themi Doko | 2,164,985 |
| 477 | 01-01-1996 | Vlorë | Pandeli Koçi | 3,100,584 |
| 1182 | 01-01-1996 | Vlorë | Janul Çuka | 2,876,663 |
| 313 | 01-01-1997 | Vlorë | Mezin Gllava | 477,394 |
| 1123 | 01-01-1996 | Vlorë | Ferjat Telharaj | 1,858,991 |
| 1151 | 01-01-1996 | Vlorë | Remzi Mataj | 2,085,330 |
| 454 | 01-01-1996 | Vlorë | Enver Galloshi | 88,652 |
| 401 | 01-01-1996 | Vlorë | Nako Jovani | 141,081 |
| 1134 | 01-01-1996 | Vlorë | | 565,969 |
| 1638 | 01-01-1996 | Vlorë | Ferjat Llanaj | 730,436 |
| 152 | 01-01-1996 | Vlorë | Janaq Saraci | 320,846 |
| 166 | 01-01-1996 | Vlorë | Emrulla Nivica | 5,775,496 |
| 138 | 01-01-1996 | Vlorë | Ismet Manaj | 354,932 |
| 321 | 01-01-1997 | Vlorë | Qani Aliaj | 3,170,094 |
| 814 | 01-01-1996 | Vlorë | Aqif Thomaraj | 14,299 |
| 1472 | 01-01-1901 | Vlorë | Lirim Abazaj | 55,289 |
| 58 | 01-01-1996 | Vlorë | | 276,443 |
| 116 | 01-01-1996 | Vlorë | Bektash Brahimi | 820,753 |
| 115 | 01-01-1996 | Vlorë | Teki Aliaj | 322,445 |
| 1316 | 01-01-1996 | Vlorë | Hamdi Hasani | 1,258,385 |
| 371 | 01-01-1996 | Vlorë | Ibrahim Gorgaj | 2,195,728 |
| 447 | 01-01-1996 | Vlorë | Lefter Hitaj | 2,475,375 |
| 226 | 12-05-1996 | Vlorë | Paskal Doko | 530,960 |
| 1183 | 01-01-1996 | Vlorë | Perlat Hoxha | 138,221 |
| 146 | 01-01-1996 | Vlorë | Teme Celaj | 4,667,850 |
| 622 | 01-01-1996 | Vlorë | Minella Mërkuri | 113,435 |
| 111 | 01-01-1996 | Vlorë | Vanthia Varfi | 151,751 |
| 1195 | 01-01-1996 | Vlorë | Vasil Gjikondi | 742,603 |
| 420 | 01-01-1996 | Vlorë | Xhevo Rrokaj | 1,546,418 |
| 889 | 01-01-1996 | Vlorë | Ariz Tahiraj | 296,123 |
| 608 | 01-01-1996 | Vlorë | Hasan Bonjaku | 3,736,125 |
| 716 | 12-04-1996 | Vlorë | Zyk Laze | 697,410 |
| 469 | 01-01-1996 | Vlorë | Liljana Maliqi | 2,356,557 |
| 171 | 01-01-1996 | Vlorë | Skënder Demiraj | 155,380 |
| 304 | 01-01-1996 | Vlorë | Piro Rexhepi | 2,152,869 |
| 1169 | 01-01-1996 | Vlorë | Razzie Agaj | 103,904 |
| 1624 | 01-01-1996 | Vlorë | Arjan Mehmetaj | 2,339,880 |
| 1610 | 01-01-1996 | Vlorë | Kaleme Nelaj | 138,068 |
| 1173 | 01-01-1996 | Vlorë | Sofi Ndrenika | 246,769 |
| 774 | 12-06-1996 | Vlorë | Elpiniqi Konomi | 173,061 |
| 1413 | 01-01-1997 | Vlorë | | 254,994 |
| 1189 | 01-01-1996 | Vlorë | Pellumb Bimo | 6,406,347 |
| 179 | 01-01-1996 | Vlorë | Ksenofon Bala | 141,152 |
| 38 | 07-07-1994 | Elbasan | NAUN DOKA | |
| 39 | 01-01-1998 | Fier | Reshat Mebelli | 52,780,000 |
| 41 | 01-01-1998 | Fier | Themi Mehillka | 6,552,000 |
| 40 | 01-01-1998 | Fier | Aleksandra Daja | 54,236,000 |
| 137 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Sulo Hasanbega | 891,273 |
| 138 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Sulo Meta | 1,618,988 |
| 136 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Servet Shehu | 1,019,978 |
| 503 | 13-02-1997 | Shkodër | Tahir Haxhi Dergjini | 559,650 |
| 688 | 09-03-1994 | Shkodër | Luigj Marku | 30,128,940 |
| 139 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Sabri Nuraj | 2,453,666 |
| 140 | 01-01-1998 | Gjirokastër | | 60,055 |
| 82 | 04-09-1994 | Shkodër | Pal Mark Gjopjetri | 0 |
| 102 | 07-02-1996 | Shkodër | Ndue Marku | 0 |
| 105 | 18-04-1996 | Shkodër | Gjon Prel Luta | 1,376,085 |
| 446 | 26-06-1996 | Korçë | Ramadan Kocibelli | 998,145 |
| 439 | 26-06-1996 | Korçë | Petraq Minka | 682,625 |
| 360 | 17-06-1996 | Korçë | Çelike Myrtollari | 724,540 |
| 437 | 26-06-1996 | Korçë | Jorgjia Strati | 46,471 |
| 1541 | 23-10-1996 | Korçë | | 850,000 |
| 450 | 26-06-1996 | Korçë | Sotiraq Premti | 253,088 |
| 441 | 26-06-1996 | Korçë | Avni Cenolli | 95,752 |
| 1253 | 01-09-1994 | Durrës | Nihat Kurti | 0 |
| 989 | 01-01-1901 | Fier | Bajram Tona | 10,193,568 |
| 141 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Shpetim Spahiaj | 4,098,975 |
| 31 | 17-04-1998 | Korçë | Ferit Nake | 0 |
| 144 | 01-01-1901 | Gjirokastër | Haseni Xhaka | 552,455 |
| 142 | 01-01-1901 | Gjirokastër | Pasho Durmish Lisi | 585,326 |
| 8 | 22-11-1997 | Berat | File Ramadan Çela | 4,731,964 |
| 134 | 13-10-1998 | Berat | Xhevahir Tofik Merdari | 1,452,938 |
| 85 | 30-04-1998 | Berat | | 2,697,698 |
| 133 | 12-10-1998 | Berat | Fitim Dervish Bega | 6,684,229 |
| 130 | 25-08-1998 | Berat | Ilir Vangjel Naska | 493,538 |
| 146 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Remzi Lici | 4,704,000 |
| 82 | 01-01-1998 | Kukës | Sabrie Mustaf Haxhiaj | 29,875 |
| 145 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Hasim Hadaj | 400,596 |
| 88 | 30-04-1998 | Berat | Llambi Mitro Kerri | 1,920,513 |
| dddd | 30-04-1996 | Dibër | BAJRAM KUCKA | -9,793,110 |
| 206 | 01-01-1998 | Dibër | LIRIM KABXHIU (KAPXHIU) | 1,567,020 |
| 191 | 01-01-1997 | Durrës | Mustafa Kërtalli | 440,200 |
| 631 | 01-01-1998 | Vlorë | Godiva Shyti | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 453 | 26-06-1996 | Korçë | Julian Emanuel | 3,674,318 |
| 780 | 24-09-1996 | Korçë | | 508,528 |
| 461 | 26-06-1996 | Korçë | | 30,504 |
| 456 | 26-06-1996 | Korçë | | 456,029 |
| 586 | 28-06-1996 | Korçë | Nasibi Asim Agolli | 380,024 |
| 454 | 26-06-1996 | Korçë | Bajram Arif Kroi | 3,551,625 |
| 1573 | 17-10-1998 | Korçë | Vangjel Luarasi | |
| 1528 | 01-10-1996 | Korçë | Gjinovefa Viso | |
| 1670 | 04-08-1998 | Korçë | Ilir Burbuqi | -67,470,800 |
| 455 | 26-06-1996 | Korçë | Stavri Qirjako | 302,180 |
| 464 | 27-06-1996 | Korçë | Irakli Petri | 978,849 |
| 457 | 26-06-1996 | Korçë | Ilia Llahmani | 562,725 |
| 271 | 20-06-1996 | Berat | Muço Jaçe | 3,130,043 |
| 270 | 08-06-1996 | Berat | Shaban Caka | |
| 270 | 08-06-1996 | Berat | Shaban Caka | 332,315 |
| 266 | 04-04-1996 | Berat | Tahir Mersini | 43,588 |
| 269 | 11-03-1996 | Berat | Riza Kushova | 405,131 |
| 268 | 27-06-1996 | Berat | Shpresa Shamo | 559,343 |
| 272 | 11-08-1996 | Berat | Ali Cufe | 253,349 |
| 4 | 13-06-1996 | Tiranë | BUKURIJE TARJA | 842,400 |
| 121 | 21-04-1994 | Kukës | Bislim Cena | 2,977,996 |
| 122 | 13-07-1997 | Kukës | Asllan Alimeti | 258,300 |
| 256 | 20-10-1998 | Lezhë | Dila Bardhi | |
| 132 | 21-08-1998 | Shkodër | Trashigimtaret Malevija | 810,000 |
| 14 | 21-08-1998 | Shkodër | Jonuz Malevija | -32,154,000 |
| 518 | 30-09-1998 | Shkodër | Hasan Hysa | 172,754 |
| 332 | 11-03-1996 | Durrës | Bajram Goci | |
| 344 | 11-06-1996 | Korçë | Gaqo Muli | 1,610,800 |
| 434 | 25-06-1996 | Korçë | Skender Avdyllari | 326,274 |
| 1604 | 30-12-1996 | Korçë | Yllson Arifi | -31,186,900 |
| 1426 | 25-07-1996 | Korçë | | 100,000 |
| 345 | 23-09-1998 | Tiranë | ATEM SEFA (SUFA) | |
| 20 | 01-01-1997 | Durrës | Nexhmedin Kau | 1,748,978 |
| 642 | 15-02-1994 | Durrës | Gezim Kikrri | 7,049,040 |
| 474 | 27-06-1996 | Korçë | Rosel Dodona | 1,790,280 |
| 274 | 26-06-1996 | Berat | Sefer Paja | 531,783 |
| 132 | 01-09-1998 | Berat | Fitim Mimani | 260,340 |
| 138 | 22-10-1998 | Berat | Shahsivar Nuri | 993,394 |
| 98 | 25-05-1998 | Berat | Jaho Sherif Pire | 5,823,743 |
| 137 | 16-10-1998 | Berat | Tefik Hekuran Meçka | 3,507,922 |
| 249 | 15-11-1996 | Lezhë | Dan Mema | 851,100 |
| 155 | 03-09-1998 | Dibër | BUSH HALIT MURRA | 1,912,896 |
| 221 | 23-08-1996 | Dibër | MEHMET XHEPA | 137,503 |
| 227 | 22-10-1998 | Dibër | HAKIK KOLA | 369,000 |
| 187 | 21-02-1996 | Lezhë | Hilmi Hafizi | 861,000 |
| 469 | 21-03-1996 | Elbasan | Makbule Xhanaku | 1,004,449 |
| 473 | 01-01-1998 | Elbasan | GURALI BOZHA | |
| 468 | 01-01-1998 | Korçë | Misioni Shenjtor Eleonor | 185,070 |
| 593 | 22-10-1998 | Shkodër | Lac Osman Hysa | |
| 1510 | 29-11-1996 | Shkodër | Arjana Bekteshi | 1,319,205 |
| 55 | 01-01-1901 | Tiranë | ZOJE SHPRESA | -142,204,240 |
| 35 | 01-01-1998 | Korçë | Rexhep Sterkeshi | 0 |
| 10 | 07-03-1996 | Elbasan | SHEFIKAT BYLYKBASHI | 841,320 |
| 90 | 01-01-1996 | Elbasan | Hysen Koza | |
| 228 | 01-01-1996 | Elbasan | Refat Hila | 197,184 |
| 1563 | 19-11-1996 | Korçë | | |
| 1444 | 19-08-1996 | Korçë | | |
| 150 | 12-09-1995 | Durrës | Ali Laçi | |
| 57 | 01-01-1998 | Fier | Petro Kruti | 1,659,237 |
| 54 | 01-01-1998 | Fier | Rabushe Kuka | 4,281,470 |
| 56 | 01-01-1998 | Fier | Loni Pina | 1,885,839 |
| 60 | 01-01-1998 | Fier | Reshat Pajolli | 931,856 |
| 55 | 01-01-1998 | Fier | Xhelal Leka | 1,250,066 |
| 53 | 01-01-1998 | Fier | Rakip Dervishi | |
| 51 | 01-01-1998 | Fier | Nafie Dervishi | 3,313,872 |
| 52 | 01-01-1998 | Fier | isuf korreshi | 519,173 |
| 275 | 25-06-1996 | Berat | ZYFER KOCI | 238,031 |
| 275 | 25-06-1996 | Berat | ZYFER KOCI | |
| 357 | 01-01-1996 | Gjirokastër | Mehdi Rrapo Budini | 870,045 |
| 276 | 28-06-1996 | Berat | Ali Hasanaga | 815,581 |
| | | Berat | Nehat Kalluci | |
| 1282 | 01-01-1901 | Fier | Petraq Çuni | 8,929,806 |
| 1473 | 05-11-1998 | Fier | Islam Kajlica | 3,007,032 |
| 1287 | 01-01-1901 | Fier | Zaim Lami | 6,456,965 |
| 883 | 15-05-1996 | Fier | Nikollaq Nilo | 2,620,414 |
| 1290 | 05-11-1998 | Fier | Zyber Beqaj | 1,048,081 |
| 1464 | 01-01-1998 | Fier | Ferrik Kodheli | 4,184,747 |
| 768 | 25-01-1996 | Fier | Banush Vrenozi | 1,478,512 |
| 28 | 01-01-1901 | Fier | Sali Krasniqi | 2,508,110 |
| 464 | 01-01-1901 | Fier | Ismail Krasniqi | 1,227,851 |
| 1472 | 11-09-1998 | Fier | Ferman Yzeiri | 3,664,429 |
| 622 | 13-12-1994 | Fier | Servet Balla | 2,573,789 |
| 846 | 01-01-1901 | Fier | Llambi Bitri | |
| 1063 | 28-06-1996 | Fier | Llaqi Bitri | 2,717,283 |
| 765 | 23-02-1996 | Fier | Gjylika Malaj | 1,718,304 |
| 360 | 01-01-1901 | Fier | Sokrat Vojo | 9,240,747 |
| 180 | 27-12-1994 | Fier | Isuf Xhulaj | 2,308,664 |
| 30 | 01-01-1901 | Fier | Koçi Mine | 9,750,000 |

*(vijon)*

BOTIMI

# BASHKIM SHEHU:

## Besoj në letërsinë që shkruhet në ekstazë të akullt

Fatmira Nikolli

Prej Barcelonës ku je ton prej vitesh, sh krimtari Bashkim Shehu këtë muaj ka ardhur në Tiranë. Mes angazhimeve që merr përsipër, ato të letërsisë i ka më përzemër. Rrëfimet mbi letërsinë, raporti me kujtesën, amullinë e kahershme e mjegullën që shohim përpara, shkrimtari dje u ndal te të gjitha, teksa u bë pjesë e Festivalit "Ditënetët e librit" që po mbahet në Muzeun Historik Kombëtar nga data 16 deri më 20 maj.

Në hollin e jashtëm të MHK, i njohur si Atriumi, një hapësirë e bollshme për takime letrare, shkrimtari ishte përballë gazetarit Ben Andoni dhe përkrah përkthyeses spanjolle Maria Roces Gonzales.

Andoni e nisi bisedën duke vënë në dukje se Bashkimi është i njohur për letërsinë dhe përkthimin, letërsinë e tij cilësore ndërsa Maria ka vite e angazhuar me letërsinë e tani do përkthejë përrallat klasike në spanjisht. E pyetur se si i erdhi mundësia për të përkthyer, Gonzales kujtoi se ka nisur të përkthente në Radio Tirana. "Më 1984 themeluam me tim shoq një shoqatë, sepse u kthyem në Spanjë. Ai përkthente unë kisha angazhime të tjera. Lu riktheva te përkthimi kur Ramon u sëmur rëndë dhe prej 2011-ës kur ai ndërroi jetë jam marrë vetëm me përkthimin".

Ndërsa shkrimtarin prodhimtar e të qetë që punon shumë e pa zë, siç e prezantoi Ben Andoni Shehun, u pyet se si i menaxhon punët.

"Unë nuk shkruaj ngutshëm. Shkruaj shumë ngadalë. Jo më shumë se 2 faqe në ditë. Gjej në mëngjes dy orë për të shkruar e më pas merrem me përkthim e aktivitete të ndryshme kulturore. Prej disa vitesh nuk kam punë fikse. Jam freelance. Shkruaj në mëngjes",-tha ai.

I pyetur nëse stabiliteti emocional i rëndësishëm e i nevojshëm për të shkruar, Bashkim Shehu tha se për të qetësia nuk është e nevojshme, është e domosdoshme.

"Unë kam nevojë për qetësi që të shkruaj. Ka autorë që shkruajnë nën stres e nga dhimbja. Unë besoj në të shkruarën në qetësi. Besoj në atë ekstazën e akullt siç shkruan Tomas Man".

**SHKRIMTARI DHE POLITIKA**

Por sa dhe si duhet ta përfshijë veten shkrimtari në veprimtari social-politike?

Për Shehun nuk ka formulë fikse.

"Si t'i vijë shkrimtarit. Nëse do të bëjë letërsi të angazhuar, le ta bëjë. Nuk ka asnjë detyrim si shkrimtar të bëjë a të mos bëjë. I vetmi detyrim i shkrimtarit si shkrimtar është të bëjë letërsi. Ndërsa si qytetar, sidomos po të jetë i njohur, ka detyrime ndaj publikut, sepse pritet prej tij e në këtë sens ka detyrim moral që të japë ndikimin e tij përmes emrit të tij",-tha Shehu.

> "Unë nuk shkruaj ngutshëm. Shkruaj shumë ngadalë. Jo më shumë se 2 faqe në ditë. Gjej në mëngjes dy orë për të shkruar e më pas merrem me përkthim e aktivitete të ndryshme kulturore. Prej disa vitesh nuk kam punë fikse. Jam freelance. Shkruaj në mëngjes",-tha ai.

Mandej sa e rëndësishme është Shqipëria në laboratorin krijues të Shehut si shkrimtar?

Për këtë pasi u mendua një hop ai tha se janë kujtimet që zënë vend në letërsinë e tij. Por kujtimet nuk janë patjetër gjërat konkrete të jetuara, kujtimet janë ajo lloj atmosfere e kujtimeve e mbamendjeve. "Ndihem mirë në atë botë mes imagjinatës e reales, një kujtim i vagullt. Ndërsa ngjarjet e sotme janë më pak në laboratorin krijues, por gjejmë edhe tek ato tek-tuk ndonjë perkursion".

Përkthyesja Gonzales tha se veprat e tij janë të ndryshme si në stil. "Fjalori Udhëzues është krejt ndryshe nga Angelus Novus. Shehu është përmirësuar si shkrimtar dhe admirimi im për të është shtuar. Shqipja rri mirë në gjuhën spanjolle. Kam kërkuar edhe për referencat që ka përdorur. Më është dashur të bëj një master për burgun e Burrelit. Me Fjalorin u desh të lexoja Borgesin për të kuptuar Bashkimin",-tha ajo.

I pyetur nëse arrin të shpikë teknika në laboratorin krijues tha se ka përdorur regjistra stilistikë të ndryshëm nëpër vepra.



Ben Andoni dhe Bashkim Shehu gjatë prezantimit të librit

*Shkrimtari në "Ditënetët e librit": Romani nuk ka vdekur, është kohë kulturalisht e keqe*



Kopertina e librit

"Dallimi është në personazhe. Disa i bëj të zakonshëm e disa të pazakonshëm.

Nuk më sjell vështirësi kalimi nga përkthimi në shkrimin e një vepre. Vështirësia është kalimi nga një vepër në tjetrën. Nëse kam njëherë pasi kam mbyllur një tjetër, është e sigurt se kam hedhur disa fletë në kosh plehrash, derisa kam gjetur tastierën e duhur. Domethënë më duhet pak kohë, qetësi që të kaloj në veprën tjetër", tha ai.

**MES CHAGALL E PICASO**

I pyetur se me kë ngjan mbi sa i takon mënyrës së punës si artist, Shehu tha se është mirë të përfitosh nga të tjerët.

"Po sjell dy tipa idealë: jo se jam më lartësinë e tyre, por i marr si shembull se janë të njohur të dy.

Është Chagalli i përsosur me mënyrën e vet, e Picaso që përdor disa mënyra pune. Po e krahasoj veten me Picason, vetëm si model pune. Provoj disa mënyra. Ndërsa nga shkrimtarët bashkëkohorë ndjej afrimitet me Danilo Kish e Roberto Bolano".

Për të letërsia nuk ka kufi. Bolano e Kish nuk janë larg se pas tyre është Borges që përthyhet në mënyra të ndryshme te njëri e te tjetri.

Ka dhe autorë shqiptarë që i ndjen të afërt si Migjeni, Kuteli dhe Kadare sigurisht e veç shkrimtarëve Shehu pranoi se ka mësuar shumë edhe nga përkthyes si Pirro Misha dhe Aurel Plasari.

**KRIZA E LETËRSISË**

Po ku konsiston kriza e letërsisë bashkëkohore?

Për Shehun nuk ka asgjë të pakthyeshme. "Është folur në modernitet për vdekjen e romanit, vdekjen e artit, vdekjen e Zotit si të ishte një vazhdë nekrologjish. Por asgjë nuk ka vdekur. Romani nuk ka vdekur, as arti e as letërsia. Ka rënie të letërsisë në krahasim me fillimin e viteve '20. Tani janë kulturalisht kohë të këqija",-tha ai. E megjithëkëtë dilemës nëse e penalizon një gjuhë e vogël një letërsi të madhe-Shehu tha se e penalizon në raport me përhapjen e përkthimin, por jo me cilësinë.

Duke sjellë shembullin e letërsive që kanë komunikuar në kohë e vende të ndryshme kanë pasur pikëtakime u soll në vëmendje edhe gjasa e një përqasje në kohët tona.

"Sigurisht që ka. Nuk ka më censurë dhe mënyrat e komunikimit nuk mungojnë. Letërsia jonë është në të njëjtën valë e në të njëjtën sintoni me të tjerat.

Mund të them se vepra që dua më shumë është ajo që sapo kam lënë. Është e dhimbshme që dua më pas të jetë më i mirë."

LETERSIA

# “BALLKANI NGA BALLKONI”

# Roli i letërsisë në mpakjen e keqkuptimeve ndaj tjetrit

*Puna e përkthyesit në sheshimin e disa tabuve dhe klisheve*

*Silvana Leka: Paragjykimet ndaj letërsisë bashkëkohore të fqinjëve .*

Fatmira Nikolli



Një ndalesë te roli letërsisë dhe i përkthyesve letrarë në ngushtimin e mosnjohjes dhe keqkuptimeve ndaj “Tjetrit”, aq shpesh të përmendura në kontekstin ballkanik. Po sikur të shohim nëse letërsia na bashkon dhe na bën të kuptojmë sa ngjajmë, na vetëdijëson se keqkuptohemi, se njihemi pak e njihemi keq, se ka më shumë gjëra që na afrojnë se na largojnë? Në takimin e djeshëm “Një copëz Ballkan nga Ballkoni i Botimeve POETEKA” - Ditënetët e librit”, Muzeu Historik Kombëtar, për rreth dy orë u bisedua mbi shkrimtarët e Ballkanit dhe përkthimet e tyre në gjuhën shqipe, mbi përkthyesit shqiptarë dhe rolin e tyre jo vetëm në sjelljen e letërsisë bashkëkohore në gjuhën shqipe, por edhe në përkthimin e shkrimtarëve shqiptarë në gjuhet e “vogla” të Ballkanit. E ftuara e veçantë e kësaj veprimtarie ishte prozatorja, gazetarja dhe psikologia nga Bosnje-Hercegovina, Emina Zuna. Ajo do të qëndrojë gjatë muajit maj në Tiranë, si fituese e bursës për në Rezidencën letrare, “Poeteka-Tirana in Between”, pjesë e programit “Reading Balkans, 2018” dhe që prej 6 vjetësh zhvillohet në kryeqytetin shqiptar me mbështetjen e rrjetit TRADUKI, Ministrisë së Kulturës, Creative Europe, Ambasadës gjermane dhe Ambasadës austriake.

Shkrimtari Arian Leka bashkëbisedoi me përkthyesit e spikatur të letërsisë ballkanike në gjuhën shqipe, Milena Selimi dhe Ben Andoni, rreth rrugës dhe përvojave që ata kanë pasur në përballjet e tyre me letërsinë e vendeve të Ballkanit. Një copëz Ballkan nga ballkoni i botimeve “Poeteka”, nën logon “Balkan from the balcony”, pasi shqyrtoi përvojat pozitive që janë arritur, që nga fillimet, duke trajtuar edhe problemet që hasen në sistemin e fragmentarizuar që ndeshen ku lexuesi përballet me shkrimtarët e rajonit, cilësia e përkthimeve, mungesën e këshillimit letrar, domosdoshmërinë që kjo letërsi të përfshihet në kurrikulat shkollore e sidomos në vëmendjen që duhet treguar në përgatitjen përkthyesve të rinj nga shkolla e gjuhëve të huaja. Në bashkëbisedim u përfshinë edhe përkthyeset e njohura Dorota Horodyska, përkthyesja Maria Roces Gonzales, Mimoza Hysa dhe gazetarja Violeta Murati.

**PËRSHËNDETJE, JAM FQINJI!**

Ligjëratën kryesore me titull “Paragjykimet ndaj letërsisë bashkëkohore të fqinjëve” në takimin “Ballkani nga ballkoni” e mbajti Dr. Silvana Leka (drejtore e “Botimet Poeteka”), e pjesë prej asaj ligjërate po boton “GSH” sot.

Është vërejtur nga të gjithë se panjohuria më e madhe letrare nuk vjen nga “letërsitë e largëta” mes tyre. Panjohuria apo mosdijenia në shkallë të lartë vjen mes fqinjëve. Ky fenomen i vërejtur sidomos mes kulturave kufitare nxit debatin nëse me të vërtetë letërsia dhe përkthyesit kanë ndonjë rol a mision në sheshimin e disa tabuve dhe klisheve, që mbahen ende në këmbë dhe që ekzistojnë jo vetëm mes njerëzve të thjeshtë, por edhe mes atyre që janë të përfshirë në fushën e kulturës.



Silvana Leka

Një nga stereotipat më të zhvilluara është ai i mosbesimit se nga letërsitë dhe sidomos nga letërsitë e fqinjëve, mund të priten zhvillime pozitive, hapje dhe mbi të gjitha kryevepra të reja ballkanike.

Ndeshen dy forma paragjykimi. Serbët, kroatët, maqedonasit, malazezët, boshnjakët, sllovenët apo edhe më gjerë bullgarët, rumunët apo grekët zor se besojnë se prej Shqipërisë mund të vijë kryevepra të pritshme. Deri ku e në ç’masë qëndron kjo e vërtetë? A kanë ata dijeni se çfarë po ndodh sot në arenën letrare shqiptare? A janë në kontakt me botues, me çmimet, me autoritetet që mbështesin kulturën e shkruar apo dhe me autorët vetë?

Po ashtu, edhe prej Shqipërisë vjen i njëjti mosbesim. Kryeveprat e fqinjëve janë bërë dikur dhe një herë e një kohë. Sot nuk ka të njëjtin nivel dhe të njëjtin vijim. Ato që shkruhen sot duhet të maten me kryeveprat e dikurshme dhe të ngjasojnë me llojin dhe modelin e veprave të Boris Pahor, Vladimir Bartol, Mirko Kovaæ, Ivo Andriæ, David Albahari, Meša Selimoviæ, Danilo Kiš, Luan Starova, Drago Janèar, Blaze Koneski, Odisea Elitis, Niko Kazanzaqis, Mircea Eliade, Lucian Blaga, Nikolay Haytov, Valeri Petrov etj. Ky është pak a shumë modeli i “bukurisë klasike” me të cilin ushqehet lexuesi shqiptar. Nëse nuk ngjason me këta shkrimtarë dhe nëse nuk shkruan stilistikisht si ata dhe me temat e tyre “të mëdha”, letërsia që vjen prej këtyre vendeve shpërfillet dhe nënçmohet.

Por a kanë paragjykim botuesit dhe prej tyre edhe lexuesit shqiptarë se edhe prej letërsisë së re të rajonin nuk pritet diçka e re? Po në të vërtetë çfarë po ndodh? Mund të mjaftohemi sot vetëm me modelin e “bukurisë klasike” që vjen nga Ballkani? A është i vetëmjaftueshëm “klasicizmi ballkanik” edhe për kohërat në të cilat jetojmë? A mund të mbulojë kjo letërsi klasike edhe ato që ndodhën pas shpërbërjes ish-Jugosllavisë? A janë aty luftërat e reja të fundit të shekullit XX? A janë aty rizgjimet e nacionalizmave, lufta për identitete të reja, si identiteti për gjuhë apo format e etnocentrizmit dhe urrejtjeve të Ballkanit të ri? Sigurisht që jo. Përtej vlerave të tyre të pamohueshme e të gjithëkohshme, bukuria klasike e letërsisë ballkanase e ka të pamundur t’i përgjigjet çdo ndryshimi që ka ndodhur në strukturën sociale, shpirtërore dhe kulturore të ballkanasve të shekullit të ri. Atëherë duhen kthyer sytë se çfarë ofron letërsia më e re. Por a janë ata në të njëjtën hulli, duke shkruar me mjete dhe qasje të tjera kryeveprat e tyre? Sigurisht që po. Këtë e dëshmojnë sukseset ndërkombëtare të mjaft shkrimtarëve më të rinj nga Ballkani, që po publikohen nga botues seriozë në Gjermani, Francë, Itali, Britani, Spanjë. Pra kemi hyrë në një zonë kur letërsia më e re nga rajoni ynë po konformohet, krahas traditës letrare. Por a kemi hyrë edhe ne, me editorinë shqiptare në rrjedhat e letrave moderne dhe bashkëkohësinë ballkanike?




Nëse e marrim të mirëqenë faktin se kontaktet janë zgjeruar, duhet të shtrojmë pyetjen se nga e merr informacionin lexuesi shqiptar? Kush e zotëron “të drejtën” dhe përgjegjësinë e rekomandimit letrar. Botuesit? Kritika letrare? Revistat e specializuar. Qarqet e katedrave dhe bota akademike? A e kanë kryer ata këtë?

Me gjithë disa zhvillime, duket se ende jo. Po a janë ata vetë vërtetë të informuar se çfarë ndodh, sesi po zhvillohet dhe a ndiqen me interes e pa shpërfillje zhvillimet me të fundit që po ndodhin të letërsinë ballkanike? Jo. A ka dikush dijeni se sa përkthyes të kualifikuar kemi nga gjuhët e fqinjëve? A janë këta përkthyes vetëm “marrës”, nga ata që vetëm përkthejnë nga gjuhët ballkanike drejt shqipes apo janë edhe “tejçues”, që mund të marrin përsipër edhe iniciativa më të mëdha, siç është përkthimi i veprave të autorëve shqiptarë në gjuhët e fqinjëve. Nga një statistikë e botuar vetëm dy muaj më parë, në mars të vitit 2018, vërejmë me kënaqësi disa, për të mos thënë se pjesën më të qenësishme të autorëve që u shpallën si më të mirët me librat e tyre të botuar që nga viti 2000 në hapësirën e ish-Jugosllavisë janë sjellë në shqip nga “Botimet Poeteka”.

Mes tyre janë emrat e Tomaz Salamun, Daša Drndiè, Andrej Nikolaidis, Georgi Gospodinov, Srdjan Valjareviæ, Nikola Madzirov, Faruk Šehiæ, Emir Imamoviæ Pirke, Aleksandar Hemon, Renato Baretiæ, Miljenko Jergoviæ, Abdulah Sidran, Lejla Kalamujiæ etj janë botuar nga “Poeteka”. Madje, disa prej tyre, si Daša Drndiè, Andrej Nikolaidis, Nikola Madzirov, Emir Imamoviæ Pirke, Renato Baretiæ apo Lejla Kalamujiæ kanë ardhur dhe qëndruar në Tiranë. Falë festivalit “Poeteka” apo falë rezidencës letrare “Poeteka – Tirana in Between”, që sot numëron vitin e vet të gjashtë të themelimit dhe që në sajë të bashkëpunimit me institucione të rëndësishme, si Ministria e Kulturës, Traduki, Creative Europe, Ambasada e Austrisë, Ambasada e Gjermanisë Instituti “Goethe” apo së fundi edhe Programit “Reading Balkans”, ka mundur të sjellë me qëndrim një mujor në Tiranë 35 shkrimtarë nga rajoni dhe Europa, të cilët kanë lënë mbi 400 faqe krijimtari, ditare, poezi apo vepra të nënshkruara në rezidencën e Tiranës, pranë rrugës “Dërhemi”, që tashmë ka filluar të jetë një destinacion. Sigurisht që një ndihmesë dhe një gjendje të veçantë në afrimin mes kulturave letrare të fqinjëve ka dhënë dhe vazhdon të japë “Rezidenca europiane të shkrimtarëve dhe e përkthyesve letrarë ‘Poeteka-Tirana in Between’. Në këtë gjerësi dhe valë është edhe revista “Poeteka”, partnere me “Eurozine”, e cila sapo ka botuar numrin e vet të 47 në 13 vjet qëndrueshmëri në skenë kulturore shqiptare…

Opinioni i Ditës

# BE në udhëkryq



Nga Ilir Kalemaj

*(vijon nga faqja 1)*

... me Washingtonin, e cila pas luftës tregtare, u vështirësua edhe më tepër me tërheqjen e SHBA-së nga traktati me Iranin, procesin e Brexit, ballafaqimet gjeopolitike dhe tregtare me Rusinë dhe Kinën, mosdakordësinë për shpejtësinë e zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor e kështu me radhë. Shpesh të fokusuar vetëm në këtë pjesën e fundit dhe më specifikisht duke parë thjesht dhe vetëm nahijen tonë, pra Shqipërinë dhe fatin e mbramë të hapjes së negociatave për të, ne qëllimisht harrojmë apo anashkalojnë kontekstin e zhvillimeve globale dhe europiane, dinamikat e së cilës janë mjaft të rëndësishme për të parë përtej hundës sonë, por edhe për të kuptuar më mirë fatin edhe të vendit, i cili në një botë përherë e më të ndërlidhur nuk mund të ngelet fenomen *sui generis*.

Në terma globalë, vendet e BE-së përfaqësojnë vetëm 7 përqind të popullsisë së botës, por 20 përqind të shpenzimeve për kërkim dhe zhvillim si dhe një të tretën e publikimeve shkencore të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, e medaljes, BE është mjaft më mbrapa në inovacion dhe teknologji. Fjala bie, ka tri herë më pak patenta shpikjesh se Japonia, pesë herë më pak kapital bashkë-financues për ndërmarrjet e reja se SHBA-ja apo numrin e kompanive të reja të suksesshme, si dhe më pak se gjysma e ndërmarrjeve të manifakturës së produkteve hi-tech që ka Koreja e Jugut.

Debatet mbi thellimin e BE-së sot, flamurtar i së cilave është kthyer presidenti francez Macron, synojnë të fokusojnë diskutimet dhe mundësisht vendim-marrjen mbi krijimin e një kompasi fiskal, krijimin e një Ministrie Financash të BE-së dhe koordinimin më të mirë të politikës monetare për zonën Euro. Gjithashtu synohet të krijohet një politikë mbrojtje mbikombëtare me kulmin e saj, ushtrinë e përbashkët. Është ironi ndoshta e historisë që një politikë e tillë u propozua qysh në 1955 po nga francezët (ang. European Defence Community) dhe u rrëzua po nga ta, kryesisht nën influencën e De Gaulle-it euroskeptik nga frika e këtij të fundit se kërcënonte sovranitetin e Francës. Një sovranist i bindur, De Gaulle madje tërhoqi më vonë dhe vendin e tij nga NATO, si dhe krijimin e krizës së "karriges bosh të Luksemburgut" ku tërhoqi Francën nga presidenca e Këshillit derisa me kompromisin e mëvonshëm u ra dakord për veton në rast prekje të sovranitetit. Është sërish një paradoks historik që Franca euroskeptike e De Gaullit kthehet sot në euroentuziaste të flaktë, por skeptike ndaj zgjerimit, sepse ky i fundit pengon përpjekjet federalizuese brenda 27 vendeve (pas Brexit).

Debate që synojnë thellimin kanë të bëjnë, gjithashtu, me mosprekjen e lëvizjes së lirë brenda zonës Shengen, bash ku disa shtete kishin rivendosur apo diskutuar për rivendosje të kufizimeve të tilla që lidheshin me vendet e treta për t'u mbrojtur nga rreziqet e valës së refugjatëve apo terrorizmit. Kontrollet kufitare ndërkohë janë duke u shtuar dhe kufizime shtesë për vendet joanëtare, ku përfshihet edhe Shqipëria do të hyjnë në fuqi nga 1 janari i 2020-ës. Gjithashtu, politikat e azilit, të formuluara përmes traktateve të Dublinit, në fakt, kanë rezultuar aspak efektive dhe kanë nxitur një debat të brendshëm mes vendeve anëtare për moszbatueshmërinë e tyre në praktikë.

Bashkimi Europian sot është në një udhëkryq që shënjon të ardhmen e tij të pasigurtë. Një forcë unike ekonomike, me një treg prej 500 milionë konsumatorësh, partner kryesor tregtar i SHBA-ve, Kinës, Rusisë, Afrikës e me radhë, një eksperiment i jashtëzakonshëm i triumfit mbi interesat parokiale dhe forcë emancipuese dhe liberalizuese e paprecedentë, është, gjithashtu, një mbartëse kontradiktash që asnjë sistem tjetër federal apo konfederativ nuk i ka pasur. Mes të qenit një shtet dhe një organizatë ndërkombëtare, por, në fakt, po qenë as njëra, as tjetra prej tyre, BE sot qëndron në kapërcyell të fatit të saj historik. Se cilin kah pritet të marrë, është e rëndësishme dhe për ata që presin pas dere si Shqipëria dhe fqinjët e saj ballkano-perëndimor, të cilat kanë lidhur shpresat e tyre për zhvillim ekonomik, demokratizim dhe forcim të shtetit të së drejtës pikërisht me fatin e mbramë të Bashkimit Evropian.



Intervista e Ditës

# Hahn: "Perspektivë e hapur" për Ballkanin Perëndimor



*(vijon nga faqja 1)*

... të BE, Johannes Hahn nuk mundi ta thotë në intervistë me DW.

*Deutsche Welle: Zoti Komisar, BE u ofron gjashtë shteteve ballkanike në "Deklaratën e Sofjes" një perspektivë evropiane, por jo anëtarësim. A mjafton kjo?*

Johannes Hahn: Këtu në Sofje ne përqendrohemi te "konektiviteti", pra në ato fusha, ku mund të zgjerojmë lidhjet në infrastrukturë, në sektorin e energjisë dhe në ofertat digjitale me njëri-tjetrin.

Kjo ndikon edhe në një lidhje më të ngushtë me Bashkimin Evropian. Me këtë perspektivë evropiane ne ofrojmë investime shumë konkrete në infrastrukturë.

*A nuk shkoni me këtë një hap më pas premtimeve tuaja, që i dhatë 15 vjet më parë në Selanik, pikërisht për zgjerimin?*

Jo, ne kemi strategjinë e Ballkanit Perëndimor, të cilën e kemi publikuar në shkurt. Ajo tregon qartë një perspektivë evropiane për të gjitha këto shtete. Por ende duhet bërë shumë. Ne jemi në shkëmbim të vazhdueshëm dhe në bashkëpunim me shtetet. Disa kanë ecur më shpejt se të tjera, të gjithë kanë bërë përparime. Një aspekt shumë i rëndësishëm është që këto shtete të përgatiten për një anëtarësim të ardhshëm në BE edhe në infrastrukturë. Ne po punojmë për një zonë rajonale të tregtisë së lirë, që do t'u mundësojë shteteve që të kenë marrëdhënie më të mira tregtare me njëra-tjetrën.

Synimi është që të rritet rendimenti ekonomik i të gjithë kandidatëve, që ata të bëhen më solidë dhe rezistencë dhe më të aftë për konkurrencë në Evropë.

*Shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë edhe një sërë konfliktesh për të zgjidhur me njëri-tjetrin. Le të marrim si shembull grindjes midis Serbisë dhe Kosovës për njohjen e Kosovës si shtet. Si mund të ndihmojë BE që t'i zgjidhë këto konflikte?*

Besoj se horizonti i një perspektive evropiane shkakton në rajon një lëvizje shumë të fortë në çështjet politike në rajon. Ne sapo kemi parë që ishte e mundur të zgjidhet një konflikt kufitar pas dy vjetësh e gjysmë midis Kosovës dhe Malit të Zi. Duket se do të kemi së shpejti një zgjidhje në grindjen për emrin e shtetit midis ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (FYROM) dhe anëtares së BE, Greqi. Dinamika e ka shtyrë përpara edhe dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës.

Ne kemi thënë gjithmonë qartë dhe këtë e dinë të gjithë: nuk do të pranojmë asnjë anëtar të ri, pa u zgjidhur më parë të gjitha konfliktet bilaterale. Kjo ka bërë tashmë efekt.

*Komisioni Evropian ka përmendur vitin 2025 si datë të mundshme anëtarësimi për Serbinë dhe Malin e Zi, po të ecin të gjitha sipas planit. Shtetet anëtare nuk e përmendin këtu në Sofje këtë datë. Pse jo?*

Kjo ka qenë një lloj "date orientuese". Vendimet do të merren vetëm në takimin tonë të radhës të Bashkimit Evropian në fund të qershorit. Këtu bëhet fjalë vërtet për një datë të përkohshme, e cila duhet të tregojë seriozitetin dhe besueshmërinë e të gjithë procesit. Ne ndihemi të lidhur me detyrimet tona, por tani varet nga shtetet e Ballkanit që të arrijnë përparime.

*Johannes Hahn është Komisar i Zgjerimit të BE dhe zhvillon negociatat e anëtarësimit me shtetet kandidate.*

**Intervistën e zhvilloi Bernd Riegert.**

## HOROSKOPI

### DASHI
Të shpërblyer nga Venusi në shenjën tuaj që përqafon Hënë, do të përballeni me vendosmëri dhe optimizëm pengesa të mundshme. Nëse keni dyshime në lidhje me një çështje, është e kotë të shqetësoheni, duhet të vazhdoni më tej.

### DEMI
Nëse nuk jeni të sigurt për ndjenjat tuaja, mos hyni në lojë, sepse rrezikoni të krijoni ndonjë situatë të pakëndshme, për të cilën mund të pendoheni. Përpara se t'i futeni kokë e këmbë një ndërmarrjeje, do të ishte mirë të vlerësonit të mirat dhe të këqijat.

### BINJAKET
Me Venusin, Marsin dhe Uranin që ju favorizojnë do të rinovoni disa aspekte në fushën e dashurisë, për të vendosur më shumë mirëkuptim me parterin. Me Hënën mike do të dini të ëndërroni, por mbajini sytë hapur kur vjen puna për bazën materiale!

### GAFORJA
Është koha e duhur për të ndërtuar me vendosmëri dhe durim bazat për të zhvilluar më tej projekte të ndërmarra. Jepini pra! Do të dini të shqyrtoni në mënyrë të prerë dhe me zgjuarsi çështje shumë delikate dhe të rëndësishme, që kanë të bëjnë me punën.

### LUANI
Për meritë të Saturnit dhe Uranit, në punë mund të ndërmerrni një nismë pak të sforcuar, për të shënuar rezultate të mira. Me një qiell pozitiv si i juaji, ndiheni plot me energji. Mbylleni atë që ju ka mbetur pezull.

### VIRGJERESHA
Neptuni jo i favorshëm ju bën të jeni më të ndjeshëm. Bëni kujdes, sepse jeni më të prekshëm ndaj negativitetit të personave që ju rrethojnë. Në dashuri kijini idetë e qarta dhe dilni drejt në temë, duke shmangur dyshime dhe ngurrime të kota.

### PESHORJA
Me Saturnin që ju mbështet do të vini në pah nevojën për t'u përmbushur profesionalisht, në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Uranin e keni kundra sot. Një pengesë mund t'ju shfaqet para rrugës suaj, por keni mundësi ta kaloni.

### AKREPI
Gjithçka do të shkojë për më mirë, mbi të gjitha nëse kërkoni të vepron në aktivitetin juaj, gjithmonë duke u bazuar në kriteret e paanshmërisë dhe respektit për të tjerët. Hëna është dinake dhe sot do të keni si situata pozitive, ashtu edhe tensione.

### SHIGJETARI
Për shkak të Uranit dhe Plutonit armiqësor, shmangni të ngrënit dhe të pirët jashtë mase si edhe lodhjen e tepërt. Duhet të llogaritni mirë forcat. Me Marsin kundra parashikohen disa shqetësime. Do të jeni nën trysni nga angazhime të shumta.

### BRICJAPI
Sot duhet të bëni kujdes me ata që nuk janë duke ju thënë të vërtetën. Nuk mund të bëni më sikur nuk e kuptoni, është koha për sqarime. Do të përfitoni nga një frymëzim nismëtar, që do të mbështetet nga fantazia dhe krijimtaria.

### UJORI
Me Hënën që i buzëqesh Venusit, ngjarje entuziazmuese dhe sensuale do t'ju stimulojnë jetën sentimentale. Do të dini të përçoni gëzim kudo. Një Uran i shkëlqyer do të vërë në plan të parë mendjemprehtësinë tuaj. Mësoni t'i besoni intuitës suaj.

### PESHQIT
Pas ditësh të mbushura me angazhime, po vijnë momente më të qeta. Do të ndiheni në formë, të qetë dhe në dispozicion të personit që ju qëndron në krah. Do të keni mundësinë të kaloni në veprim, duke realizuar edhe gjëra që i konsideronit shumë të vështira.



### Portieri-legjendë luan të shtunën ndeshjen e fundit si bardhezi

## Bufon: E mbylla te Juventusi, të ardhmen e vendos javës tjetër

Më në fund e vërteta ka dalë. Pas shumë spekulimesh, Xhanluixhi Bufon ka zbuluar të ardhmen e tij, duke zyrtarizuar lamtumirën ndaj futbollit të luajtur. Pas një jetë mes shtyllave të portës, me Juventusin dhe Kombëtaren italiane, në moshën 40-vjeçare Bufon ka vendosur të thotë "mjaft". Njoftimin që pritej prej javësh, portieri e dha në konferencën e paralajmëruar për mediat. "Të shtunën do të jetë ndeshja ime e fundit me Juventusin. Është meritë e tij, që megjithëse në këtë moshë, luajta deri në fund në nivele të larta. Ky ishte objektivi im. Nuk doja që në fund të karrierës të arrija si një lojtar me motor të fikur. Kjo është meritë e Juventusit dhe jam shumë krenar për atë që kam arritur", ka thënë Bufon. I njëjtë diskutimi edhe për kombëtaren, ku portieri ka hedhur poshtë mundësinë që ai të jetë pjesë në këtë periudhë të vështirë të tranzicioni për skuadrën e kaltër. "Nuk dua të jem një problem për kombëtaren. Nuk e meritoj këtë dhe as Italia nuk e meriton një gjë të tillë. Ka shumë portierë të talentuar, që duhet të dalin në skenë", ka sqaruar portieri juventin, që ka pranuar se ka në dorë shumë oferta, por pa zbuluar asgjë në lidhje me të ardhmen. Sido që të jetë ajo, asgjë nuk e zbeh karrierën spektakolare dhe të mbushur me rekorde për atë që konsiderohet si një nga portierët më të mirë në historinë e futbollit. Bufon debutoi me Parmën në Serinë A kur ishte vetëm 17 vjeç, ndërsa që nga ajo kohë regjistron 639 ndeshje në kampionat, 12 më pak se një tjetër legjendë si Paolo Maldini, por ai është më fitues. Por, askush si Bufon nuk ka luajtur më gjatë me Kombëtaren italiane me të cilën triumfoi edhe në "Botërorin 2006".

### Njëshi i klubit kuksian thumbon Halilin dhe "bekon" lidhjen me Shkumbin Qormehmetin

# Gjici: Keqardhje për Vllazninë, por jemi ekip serioz

## *Presidenti mohon tezat e një tolerimi të mundshëm*

Jeton Selimi

Në pak ditë te Kukësi ka pasur shumë zhvillime, duke filluar që nga sigurimi i vendit të dytë, shitja e Gurit, apo edhe shkarkimi i menaxherit Naim Halili. Në lidhje me këto situata ka folur presidenti i Kukësit, Safet Gjici, i cili ka sqaruar largimin e menaxherit, i cili njihej si krahu i djathtë i tij. Në një intervistë për "Report TV", Gjici është ndalur edhe te Vllaznia, për të cilën thotë se ndjen keqardhje, por në fund duhet respektuar kampionati. Shitjen e Sindrit Gurit, ai e shikon si një pikënisje të projektit të tij dhe synimi është që çdo fundsezoni të shiten 3-4 lojtarë. Sigurisht kjo nuk do të jetë aspak e lehtë, por me punë gradualisht gjërat mund të përmirësohen. Numri një i klubit verilindor ka folur në lidhje me transferimin e shkodranit, ndërkohë që ka zbuluar se ka pasur ofertë edhe nga Dinamo Zagreb dhe ekipe të Serie A. "Unë kam pasur shumë oferta edhe nga klube shumë të mëdha, si Dinamo e Zagrebit, apo ekipe të Serie A italiane, pasi siç e dini, Guri ka edhe pasaportën italiane dhe është një plus për këtë lojtar dhe për klubin. Kjo ishte edhe arsyeja që ne bëmë një transferim me shifra të tilla. Ndoshta nga Ostende do transferohet në ndonjë klub tjetër me një çmim më të madh, por unë i uroj sukses Gurit për atë që ka dhënë dhe i uroj suksese tek Ostende", ka ai thënë mes të tjerash. I pyetur në lidhje me shumën e derdhur në arkat e klubit, presidenti i Kukësit nuk ka dashur të zbulojë shifra, por tregon se zotërojnë edhe 20% të kartonit dhe madje për çdo transfertë që do të bëhet. Gjici ka treguar se ka pasur një takim me trajnerin Peter Pacult dhe se pret që ai së bashku me stafin të gjejnë lojtarët që u duhen, 4-5 të cilët të bëjnë diferencën, me synim kapjen e grupeve në Europa League apo Champions League.



ÇËSHTJA "HALILI" - "Menaxherin Halili e kam marrë jo se ka pasur ndonjë dijeni për fushën që ka mbuluar, por kam marrë si kuksian. Ka qenë krahu im i djathtë deri diku në aspektin e menaxhimit, por me thënë të drejtën më ka zhgënjyer në disa menaxhime që nuk ka pasur as autoritetin, as përvojën, as nuk ka qenë i aftë për t'i menaxhuar", thotë mes të tjerash Gjici, që më tej vijon të flasë dhe lë të kuptojë se edhe raporti i tij me Pakult nuk ka qenë i duhuri. "Nuk ka qenë marrë shumë me klubin, ka pasur kritika herë pas here edhe në takimet që unë kam bërë me stafin. Ai nuk e ka zbaruar atë që i kam thënë unë, është marrë me disa punë të tjera, që nuk kanë lidhje me klubin. Erdhi vendimi im që të vijë dikush tjetër, që të vijë dikush që e njeh më mirë tregun e lojtarëve, brenda dhe jashtë vendit. Shkumbini është një nga ata, që e tregoi veten në transfertën e parë që bëri me Gurin. Do ta kemi ne çdo lojtar që do të ketë premisa për të shkuar lart. Do rritim stafin, në futboll nuk merret 'hajt se ky është kuksian dhe ta marrin në menaxhim'. Duhet parë nëse bën apo nuk bën për punën. Ka ardhur koha që ne t'u japim prioritet edhe stafeve. Ne kemi marrë 'timonierin' e ekipit, që është trajneri Pakult, një trajner me përvojë, korrekt dhe me disiplinë. Ai do patjetër edhe stafin që të bashkëpunojnë ashtu siç ka linjën e vet të korrektësisë dhe disiplinës. Ndoshta Naimi nuk iu përgjigj kësaj disipline e kërkese llogarie dhe për rrjedhojë morën edhe vendimin për ta larguar nga klubi", përfundoi Gjici.

### MESFUSHORI FIRMOSI ME STEUAN

## Prezantohet Qaka: Dua të fitoj shumë trofe

Kamer Qaka është prezantuar zyrtarisht si një futbollist i Steaua Bukureshtit, pasi firmosi një kontratë 5-vjeçare me gjigantët rumunë. 23-vjeçari ka folur për herë të parë si një mesfushor i Steaus, ku shprehet i lumtur që ka firmosur me një klub të tillë, duke treguar se mezi po pret debutimin me kuqeblutë e Bukureshtit. "Jam shumë i lumtur që kam nënshkruar me klubin më të madh në Rumani. Unë shpresoj që të kem progres të mirë dhe të festoj me shokët e skuadrës së re sa më shumë trofe të jetë e mundur. Mezi po pres të filloj stërvitjen dhe të luaj ndeshjen time të parë me fanellën kuqeblu", ishin fjalët e para të Qakës. Kamer Qaka u ble për rreth 400 mijë euro nga Steaua, por Politeknika Iasi ka 25 për qind të kartonit të futbollistit në rast shitjeje. Nga kontrata me Steauan, Qaka do të përfitojë një pagë progresive, e cila në termat financiarë do të vijë në rritje vit pas viti.

### SINDRIT GURI KALON PROVAT MJEKËSORE TEK OSTENDE

**Sulmuesi shkodran Sindrit Guri, që u transferua nga skuadra e Kukësit te belgët e Ostendes, ka mbërritur dje te skuadra e re, ku kreu me sukses edhe testet mjekësore. Sipas asaj që raporton faqja zyrtare e Ostendes, sulmuesi shkodran ditën e sotme u shoqërua nga menaxheri i tij Shkumbin Qorrmemeti, ndërsa nesër do të prezantohet dhe do të japë intervistën e tij të parë për mediat si futbollist i Ostendes.**



## Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Immanuel filozof.
4. Parashtesë për këtej.
8. Argento aktore.
11. Gjysmë erotik.
13. Janë memece pa kufij.
15. Rastet pa set.
16. Në mes të dhomës.
18. Rrapo pa çifte.
19. Gardner aktore.
20. Charlie Mingus.
21. Janë pjesë të antenës.
23. Eshtë e tregut në kapitalizëm.
24. Eshtë lojtari underi 21.
26. Janë njëvendëshe në Formula 1.
28. Qarkullon vetëm në shqipëri.
30. Ishin komandantët si Çerçiz Topulli.
32. Kishte 100 porta.
35. Në krye të aktorëve.
36. Gjysma e slitës.
38. Inicialet e Reitman.
39. Nganjëherë nuk e vlem qiranë.
43. Një ishull si Bikini.
44. Nisin nga kreu.
45. Një satelit i Uranit.
46. Janë kapo.
48. Shahu i fundit.
49. Janë klasike me tutu.
51. U printe hunëve.
52. Në fund djathtas.
53. Instrumenti i Ravi Shankar.

VERTIKAL

1. Një së larti bëhet me stilin fosbury.
2. Kaçaturian kompozitor.
3. Kush  nuk di mbytetë.
5. Inicialet e Harris aktor.
6. Një tabu islamike.
7. Ka satelit Ariel
8. Dy asa.
9. Kështu janë mbrojtjet e palëvizshme.
10. Mund të skadojë.
12. Eshtë edhe ajo zanore.
14. Ishte futbollit i Holandës.
17. Ishin bakantet.
21. Janë garat me gregarë.
22. Një njëvjecar.
23. Tekat pa kufij.
25. Një ekip i Kazanit.
27. Fillojnë aksionin.
29. Eshtë hidrokarbur.
31. Gruaja e Ben Hur.
33. Skuadër greke.
34. Barack në shtëpinë e bardhë.
37. Capirossi i MotoGP.
40. Nuk i tregohen babait.
41. Mund të jete fetar.
42. Jessica aktore.
43.Marsi i akejve.
46. Tri të parat në klasifikim.
47. Gjysmë tatimi.
50. Mbyllin fushata.

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Eshtë hokatari.
8. Loja me full.
13. Kaas këngëtare.
14. Përdoret kundër malaries
15. Këndohet në opera.
16. Pak formalitete.
17. Eshtë legjenda.
18. Të fundit konak.
19. I mbjell... katastrofa.
24. I bëjnë të luajturit.
25. Fillojnë mpirjen.
27. Janë trupa qiellorë.
28. Qendër në kaos.
29. Preferojnë yjet e hënën.
30. Tri të parat në atletikë.
31. Beton pa kufij.
32. Ente Autonome Tiranë.
33. Një metër në kufij.
34. Një stacion... anijesh.
36. Eshtë alfabeti ynë
39. Një pjesë e mungesave.
41. Haan që trajner i yni.
42. Një britmë në arenë.
43. Mund të jetë unik.
45. Eshtë bota jashtë ëndrrës.
47. Eshtë sundim shtypës.
49. Totale pa zë.
50. Bukuroshja e Notre Dame de Paris.

VERTIKAL

1. Catherine aktore.
2. Një vijë e lakuar.
3. Tatim pa kufij.
4. Lidhet në... fyt.
5. Inicialet e Camus.
6. Në kokë të xixëllonjës.
7. Fillojnë hapur.
8. Kishin flamur të zi.
9. Ndezur në aparaturë
10. U shkra nga Kipling.
11. Janë mistere për t'u zgjidhur.
12. Rastet pa set.
14. Ai ekzekutiv tani është bashki.
16. Eshtë edkumi në palestër.
20. Grandi aktore.
21. Eshtë gjarpër.
22. Një pëlhurë sintetikë.
23. I bëjnë testet me një set.
24. Një momument... për kujtim.
26. Atdheu i Papa Ëojtyla-s.
27. Mund të jenë me katër kohë.
29. Një ushtarak me... numër.
30. Emri i Salacrou.
35. Telefoni në kartëvizitë.
37. Numri i oktetit.
38. Kukulla e Ibsen.
40. Thyhet me dy kafshata.
44. Rajone Autonome Lokale.
46. Ekstreme në esktreme.
48. Mbyllin një manastir.



## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 4 | | | | | | | |
| 2 | 3 | | 1 | | | | 4 | |
| | 9 | 6 | 2 | | | | 7 | |
| 8 | | | | 6 | | | | 4 |
| | | 9 | | 1 | | 7 | 5 | |
| | | | | 5 | | 6 | | 3 |
| 3 | 8 | | | | 9 | | | |
| | | 5 | 7 | 3 | | | | |
| | 2 | | | 4 | | | | |

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | 4 | 5 | 3 | 1 | 2 | 9 | 6 | 7 |
| 7 | 2 | 6 | 8 | 4 | 9 | 1 | 3 | 5 |
| 9 | 1 | 3 | 5 | 7 | 6 | 8 | 2 | 4 |
| 2 | 3 | 4 | 6 | 5 | 8 | 7 | 9 | 1 |
| 5 | 6 | 7 | 1 | 9 | 3 | 2 | 4 | 8 |
| 1 | 8 | 9 | 4 | 2 | 7 | 3 | 5 | 6 |
| 6 | 5 | 8 | 9 | 3 | 1 | 4 | 7 | 2 |
| 3 | 7 | 1 | 2 | 6 | 4 | 5 | 8 | 9 |
| 4 | 9 | 2 | 7 | 8 | 5 | 6 | 1 | 3 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9





## Argëtim filozofik

- Të gjithë ankohemi për kujtesë të pamjaftueshme, por asnjë deri më sot nuk është ankuar për mungesë arsyetimit të shëndoshë. (Laforushko)
- Njeriu me të vërtetë i fortë, i pohon dobësitë e veta. (Balzak)
- Vështirësitë kultivojnë te njeriu aftësi të domosdoshme për kapërcimin e tyre. (Filips)
- Ka njerëz, të cilët nuk lajthisin kurrë sepse mendja e tyre nuk prodhon asnjëherë mendime të arsyeshme. {Gete}

## KRIPTOSKEME



## KRIPTOSKEME
*Përgjigja e numrit të djeshëm*



## Thënie të mençura

- Disa vese po të përdoren mirë, shkëlqejnë më shumë se virtyti
- La Rochefoucauld Shkrimtar (1613-1680)
- Ç'është koprracia? Është të jetosh në varfëri nga frika se mos bëhesh i varfër
Jeta është përsosje pa fund. Të quash veten të përsosur, do të thotë…të vrasësh veten.

Mos iu drejto me ton të ashpër ndokujt . Atyre që do ju drejtohesh kështu mund të të përgjigjen në të njëjten mënyrë : plagët janë të dhimbshme ; njëra pas tjetrës do bien mbi ty .Duke mbrojtur veten ke mbrojtur tjerët ; duke mbrojtur tjerët ke mbrojtur veten .

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

